REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I FINANCËS

DISERTACION

MENAXHIMI I RISKUT TË KREDISË BANKARE PËR SEKTORIN E SME-VE NË SHQIPËRI

Në kërkim të gradës shkencore "Doktor i Shkencave"

Disertante:
Msc. Evis Kumi

Udhëheqës shkencor:
Prof. Dr. Halit Xhafa

Tiranë, Maj 2014

© **Copyright** Evis Kumi, 2014
Përmbajtja e këtij punimi është totalisht autentike. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

DEKLARATË AUTENTICITETI

AUTOR: Evis Kumi

Në kuptim e zbatim të përcaktimeve të sqaruara në VKM nr. 593, dt. 18.8.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 864, dt.5.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e programeve të studimeve të doktoraturës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotesojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor" të ndryshuar, si dhe në urdhërin 'Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, nr. 105, dt 23.3.2012 "Për miratimin e rregullores për 'Etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botues"':

Deklaroj me përgjegjësi të plotë personale që punimi i paraqitur në kërkim të marrjes së gradës shkencore "Doktor" është plotësisht autentik. Çdo material i marrë nga burime të treta është referuar sipas rregullave.

Evis Kumi
Maj 2014

Falenderime

Realizimi i këtij punimi u bë i mundur në sajë të ndihmës së vazhdueshme nga disa kolegë, të cilëve i kushtoj mirënjohje dhe falenderim jashtëzakonisht të madh.

Dëshiroj të falenderoj në radhë të parë udhëheqësin tim shkencor, **Prof. Dr. Halit Xhafa**, i cili nuk e humbi kurrë besimin tek unë, për konsultimet e vazhdueshme në këtë proçes të gjatë tre vjecar studimi dhe kërkimi, për idetë dhe këshillat e vyera që me ka dhënë për përgatitjen e këtij punimi.

Falenderoj gjithashtu me respekt gjithë profesorët dhe pedagogët e Departamentit të Financës të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës, për inkurajimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, si dhe gjithë miqtë e të njohurit e mi që janë përfshirë për të dhënë ndihmën e tyre.

Familja ime meriton një falenderim të veçante që ka sakrifikuar së bashku me mua, dhe më ka qëndruar pranë gjatë gjithë kësaj periudhe.

ABSTRAKT

Për shkak të riskut të kredisë në rritje, veçanërisht për sektorin e SME-ve, ky studim ndërton një model të matjes së probabilitetit për sukses ose dështim, duke përdorur metodën e regresionit logjistik. Studimet e bazuara në të dhënat e SME-ve janë të rralla dhe ky studim mund të jetë një ndihmë në matjen e riskut të kredisë për këtë sektor, në një treg në zhvillim siç është ekonomia shqiptare. Kjo është për shkak se SME-të luajnë rol të rëndësishëm në ekonominë tonë dhe pothuajse në të gjitha ekonomitë në botë.

Gjatë vitit 2013, cilësia e portofolit të kredisë ka vazhduar progresin e saj në rënie, ku kreditë me probleme ndaj totalit të kredive bruto u rritën, dhe raportet e fundit tregojnë një nivel të kredive me probleme thuajse deri në 25% në fillim të vitit 2014. Cilësia e kredisë është përkeqësuar si për bizneset, ashtu dhe për individët, për kreditë në monedhën vendase e në valutë. Në kuadër të përpjekjeve për të shmangur humbjet e mundshme nga risku i kredisë, ky model përpiqet të japë një kontribut në parashikimin e probabilitetit që një SME të hasë në vështirësi financiare gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë.

Për të analizuar variablat e zgjedhura me anë të metodës së regresionit logjistik, u përdor programi SPSS. U ndërtuan dy modele, i pari përfshin vetëm raporte financiare, ndërsa në modelin e dytë u shtuan edhe të dhëna cilësore, duke e rritur kështu me 11% cilësinë e modelit. Institucionet financiare mund të përfitojnë nga ky punim për të zhvilluar modelet e tyre duke ndjekur proçesin siç tregohet në këtë studim.

Fjalët kyç: Parashikimi financiar, risku i falimentimit, vlerësimi i riskut, kreditim bankar, modeli logjistik, raportet financiare.

Klasifikimi Jel: C350, G320, G210

ABSTRACT

Due to bankruptcy risk especially for SMEs, it is developed a credit risk model by using logistic regression methods. The studies based on SME data are rare and this study might be a help in the measurement of credit risk for SMEs in an emerging market such as Albanian one. This is because the SMEs play important role in our economy and almost in all the economies in the world.

During 2013, the quality of the loan portfolio continued its downward progress and the latest rapports show a more increased level of NPLs up to nearly 25% in the beginning of 2014. Credit quality is deteriorated for both businesses and individuals so as to loans in local and foreign currency. In the context of facing potential losses from this risk we are trying to build a model to predict the possibility for a sme to have financial distress during the period of loan repayment.

The SPSS program is used to analyze the selected variables for the logistic model. It is necessary to note that the independent variables used consisted in financial and non financial data. The implication in the model of the qualitative data increased the predictive power of the model with 11%. Financial institutions can also benefit in developing their own models by following the process as shown in this study.

Keywords: *distress prediction, corporate default, risk assessment, bank lending, logit model, financial ratios.*

Jel classification: *C350, G320, G210*

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE…… ix

LISTA E TABELAVE……. x

LISTA E GRAFIKËVE……... xi

LISTA E EKUACIONEVE……..... xii

LISTA E FIGURAVE

Hyrje

i. Sfondi i studimit..... 1

ii. Objektivat e studimit..... 3

iii. Hipotezat e studimit..... 4

iv. Kufizimet e studimit..... 5

v. Organizimi i studimit..... 7

KAPITULLI 1 - RISHIKIMI I LITERATURËS

1.1 Risku i kredisë për SME-të dhe menaxhimi i tij..... 10

1.2 Përbërësit e riskut të kredisë..... 11

1.3 Modelet e vlerësimit të riskut të kredive..... 15

1.3.1 Modelet Heuristike..... 15

1.3.2 Modelet cilësore..... 16

1.3.3 Format Hibride..... 17

1.4 Modelet e parashikimit të perfomancës…….. 17

1.5 Analiza e raporteve financiare…….…… 20

1.6 Modelet e vlerësimit me pikë (Credit Scoring Models)…… 21

1.7 Teknikat e menaxhimit të riskut 22

1.8 Disa nga modelet e riskut të kredisë të zbatuara në botë për sektorin e SME-ve..... 23

1.9 Analiza diskriminuese..... 25
1.10 Manipulimi i fitimeve…….…… 27
1.11 Identifikimi i shkaqeve të dështimit të SME-ve……..…… 28
1.12 Modeli Altman Z Score……..…..……. 29
1.12.1 Një rishikim i mëtejshëm i modelit Altman
për SME-të…….…… 31
1.12.2 Modeli i regresionit logjistik dhe avantazhet
e tij në matjen e performancës së SME-ve…… 33

KAPITULLI II - KLIMA E SEKTORIT TË SME-VE NË SHQIPËRI……..…… 37

2.1 Karakteristikat dhe rëndësia ekonomike e SME-ve
në Shqipëri dhe botë..... 39
2.2 Ndikimet e zhvillimeve ekonomiko-politike në
aktivitetin e biznesit të vogël e të mesëm shqiptar..... 42
2.3 Reforma e pronës..... 43
2.4 Mbrojtja e investitorëve..... 44
2.5 Proçesi i kredimarrjes nga ana e SME-ve..... 46
2.6 Trajtimi fiskal i SME-ve 47
2.7 Importet dhe eksportet – Tregtia e jashtme..... 48
2.8 Marrëdhëniet kontraktuale..... 49
2.9 Falimentimi i SME-ve..... 49
2.10 Infrastruktura rrugore..... 51
2.11 Remitancat dhe ndikimi tek aktiviteti i SME-ve..... 51
2.12 Investimet e huaja direkte..... 52
2.13 Borxhi publik..... 53
2.14 Risku si shoqërues i SME-ve në aktivitetin e tyre ekonomik..... 54

KAPITULLI III - ZHVILLIMI I SISTEMIT BANKAR NË SHQIPËRI DHE PROBLEMATIKAT E TIJ NË LIDHJE ME FINANCIMIN E SME-VE..... 59

3.1 Aktiviteti kreditues për sektorin e SME-ve dhe ekonominë
në tërësi..... 61
3.2 Risqet ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar..... 65
3.2.1 Risku i tregut..... 65

3.2.2 Risku i likuiditetit……..……. 66
3.2.3 Risku i kredisë……..……. 67
3.3 Ecuria e riskut të kredisë për SME-të dhe ekonominë në tërësi…… 67
3.4 Analizë e situatës aktuale të kredive me probleme për sektorin e SME-ve…….. 72
3.5 Ecuria e kredidhënies ndaj biznesit në rajonin e Euro-zonës……. 73
3.6 Kuadri ligjor në lidhje me riskun e kredisë në sistemin bankar……. 76
3.7 Teknikat e zbutjes se riskut të kredisë ……79
3.8 Përkufizimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme..... 81

KAPITULLI IV - MODELI I PARASHIKIMIT TË PERFORMANCËS PËR SEKTORIN E SME-VE NË SHLYERJEN E KREDISË BANKARE.……83

4.1 Të dhënat dhe metodologjia…… 84
4.1.1 Të dhënat..... 84
4.2.2 Hipotezat..... 88
4.2.3 Metodologjia..... 90
4.3 Rezultatet empirike..... 90
4.3.1 Modeli 1..... 92
4.3.2 Modeli 2..... 98

KAPITULLI V – PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME……105

5.1 Arritjet dhe gjetjet e studimit..... 105
5.2 Rekomandime..... 110
5.3 Mundësi studimi për të ardhmen..... 112

SHTOJCA 1 - TABELAT E TË DHËNAVE DHE LLOGARITJEVE TË PËRDORURA NË REGRESIONIN LOGJISTIK……..114
SHTOJCA 2 – PYETESORI PER ANALISTET E KREDIVE TE BANKA-VE TE NIVELIT TE DYTE……. 128
REFERENCAT……. 130

LISTA E SHKURTIMEVE

SME	SMALL MEDIUM ENTERPRISE, NDËRMARRJET E VOGLA E TË MESME
PBB	PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO
NPL	NON PROFIT LOANS, KREDITË ME PROBLEME
BSH	BANKA E SHQIPËRISË
FMN	FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR
RR	RENDITJE E RISKUT, (RISK RATING)
EL	HUMBJA E PRITSHME, (EXPECTED LOSS)
PD	PROBABILITETI I DËSHTIMIT, (PROBABILITY OF DEFAULT)
LGD	HUMBJA NË RAST DËSHTIMI, (LOSS GIVEN DEFAULT).
BB	BANKA BOTËRORE
RRS	RISK RATING SYSTEM
MDA	ANALIZA DISKRIMINUESE ME SHUMË VARIABLA, MULTI DISCRIMINANT ANALYSIS
SPSS	STATISTICAL PROGRAM FOR SOCIAL STUDIES
IHD	INVESTIMET E HUAJA DIREKTE
ECB	EUROPEAN CENTRAL BANK
SBA	SMALL BUSINESS ADMINISTRATION
NAICS	NORTH AMERICAN INDUSTRY CLASSIFICATION SYSTEM

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Modeli Argenti "Rezultati A"

Tabela 2: Paraqitja skematike e tipeve të risqeve

Tabela 3. Tabela e faktorëve që ndikojnë në metodën probabilistike Beneish

Tabela 4. Lehtësimi i pagesës së taksave në Shqipëri

Tabela5. Faktorët e jashtëm të riskut të biznesit

Tabela 6. Faktorët e brendshëm të riskut të biznesit

Tabela 7. Tabela e raporteve financiare

Table 8. Tabela e të dhënave cilësore

Tabela 9. Tabela e të dhënave statistikore deskriptive

Tabela 10. Rezultati i testit MWW

Tabela 11: Tabela Omnibus Test për koeficentët e Modelit 1

Tabela 12: Përmbledhja e Modelit 1

Tabela 13: Testi Hosmer dhe Lemoshow

Tabela 14. Tabela e detajuar testit Hosmer and Lemeshow

Tabela 15. Rezultatet e Modelit 1

Tabela 16. Tabela Omnibus Test për koeficentët e Modelit 2

Tabela 17. Përmbledhja e Modelit 2

Tabela 18. Testi Hosmer dhe Lemeshow

Tabela 19. Tabela e testit Hosmer dhe Lemeshow për Modelin 2

Tabela 20. Tabela e variablave në ekuacion për Modelin 2

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Renditja e ekonomisë Shqiptare në krahasim me ato të Evropës
Grafiku 2. SME-të sipas qarqeve 2010 në %
Grafiku 3. Shpërndarja gjeografike e SME-ve të marra në studim
Grafiku 4. Renditja e shteteve në lidhje me indeksin e mbrojtjes së investitorëve
Grafiku 5. Renditja e shteteve në lidhje me lehtësinë e kredidhënies
Grafiku 6. Renditja e shteteve në lidhje me lehtësinë e zgjidhjes së falimentimit
Grafiku 7. Remitancat dhe investimet e huaja direkte në milionë Euro 2002-2013.
Grafiku 8. Ecuria e stokut te borxhit, popullsise dhe borxhit për fryme (në %)
Grafiku 9. Ndryshimet në standartet e zbatuara në kreditë për bizneset në total, sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe qëllimit të përdorimit të kredisë (Balanca neto, përqindja e bankave që kanë lëhtësuar standardet)
Grafiku 10. Ndryshimi i kushteve për miratimin e kredive të bizneseve (Balanca neto, përqindje neto e bankave që janë shprehur për lehtësimin e kushteve.)
Grafiku 11. Ecuria e kërkesës së bizneseve për kredi, sipas madhësisë së biznesit dhe qëllimit të përdorimit të kredisë (balanca neto, përqindje neto e bankave që janë shprehur për rritje të kërkesës)
Grafiku 12. Ecuria e klasave të portofolit të kredisë me probleme, në përqindje
Grafiku 13. Rritja vjetore e kredisë për biznesin dhe individët sipas qëllimit të përdorimit, në milionë lekë.
Grafiku 14. Ecuria e kredisë për bizneset dhe sektorët me kontributin në rritje.
Grafiku 15. Struktura e portofolit të kredisë për ekonominë vendase
Grafiku 16. Kreditë me probleme në Euro-zonë
Grafiku17: SME të suksesshme dhe me probleme sipas zonave gjeografike

LISTA E EKUACIONEVE

Ekuacioni 1. Modeli i probabilitetit Benish

Ekuacioni 2. Modeli Altman Z Score për kompanitë e listuara në bursë

Ekuacioni 3. Modeli Altman Z-score për kompanitë private

Ekuacioni 4. Modeli Altman për tregjet emergjente

Ekuacioni 5. Logaritmi i mundësive për dy kategoritë e variablit të varur

Ekuacioni 6. Ekuacioni i shpërndarjes Chi-Katror

Ekuacioni 7. Raporti R^2 në rastin Cox & Snell

Ekuacioni 8. Forma e axhustuar R^2 i Nagelkerke

Ekuacioni 9. Koefiçienti i llogaritur nga vlerat e pritura

Ekuacioni 10. Modeli 1 i regresionit logjistik

Ekuacioni 11. Modeli 2 i regresionit logjistik

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Paraqitja grafike e sfondit të studimit

Hyrje

i. Sfondi i studimit

Kohët e fundit, sektori bankar po forcon rregullat dhe po vendos kufizime në kredidhënie. Në të njëjtën kohë, bankat kanë forcuar kontrollin e tyre të brendshëm, sidomos në forcimin e menaxhimit të riskut të kredisë. Problemi i kredive të këqija ndikon negativisht në zhvillimin e ekonomisë në Shqipëri si dhe sjell përkeqësimin e efiçiencës së sistemit bankar.

Ky studim vlerëson financimin bankar të sektorit të SME-ve, duke e identifikuar këtë sektor si një mundësi për zhvillimin potencial ekonomik të Shqipërisë. Megjithatë, ky sektor i nënshtrohet kufizimit nga një numër faktorësh, për të cilët flitet gjerësisht në brendësi të materialit. Sektori i prodhimit dhe i shërbimit, që përfshin ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, njihet për potencialin e madh në gjenerimin e punësimit e krijimin e mirëqënies në çdo ekonomi. Tashmë në Shqipëri, ky sektor po fiton terren në terma të kontributit në PBB dhe në punësim fitimprurës. Si për vendet në zhvillim ashtu dhe për ato të zhvilluara, firmat e vogla dhe të mesme luajnë rol të rëndësishëm në proçesin e industrializimit dhe rritjen ekonomike. Përveç rritjes së të ardhurave për frymë dhe prodhimit, SME-të krijojnë mundësi punësimi dhe përmirësojnë ekuilibrin ekonomik të rajonit.

Megjithatë, roli nxitës i SME-ve pavarësisht zhvillimit të tyre është i kufizuar me një financim të pamjaftueshëm dhe menaxhim të dobët. Mjedisi i pafavorshëm makro ekonomik ka qenë gjithashtu një nga pengesat kryesore, të cilat shumë herë inkurajojnë institucionet financiare të shmangin riskun në financimin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Ngurrimi nga ana e institucioneve financiare për fondet e SME-ve mund të shpjegohet me kapitalin e pamjaftueshëm të bankave dhe asimetrinë informative, që shpesh ekziston ndërmjet SME-ve dhe institucioneve të kreditimit.

Sistemet financiare në të gjithë botën, luajnë rol themelor në zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë sidomos në ndërmjetësimin midis njësive me tepricë dhe atyre me defiçit të ekonomisë. Efektiviteti dhe efikasiteti në kryerjen e këtyre roleve, varet kryesisht nga niveli i zhvillimit të sistemit financiar. Për të siguruar qëndrueshmërinë e tij,

sektori financiar duket të jetë më i rregulluar dhe i kontrolluar nga qeveria dhe agjencitë e saj.

Në përgjithësi, faza e zhvillimit dhe efikasiteti i sistemit financiar ndryshon në varësi të kohës dhe shtetit. Sistemet financiare më të zhvilluara dhe më të sofistikuara kanë tendencë të jenë të lidhura me ekonomitë e maturuara, ndërsa sistemet financiare jo të zhvilluara, shfaqen në ekonomitë në zhvillim. Sistemi financiar si një proçes, i përshtatet ndryshimeve në ekonominë reale, po ashtu edhe bankat si pjesë e këtij proçesi ndikohen për kryerjen e tre funksioneve kryesore të tyre:

- të transformojnë depozitat afatshkurtra të mbajtura nga familjarët, në burime likuide të gjeneruara nga firmat;
- të monitorojnë debitorët potencialë, si dhe ata aktualë kundrejt depozitorëve;
- të lehtësojnë transaksionet ndërmjet agjenteve duke siguruar shërbime me pagesë.

Nga ana tjetër, bankat kërkojnë nga bizneset që të përmirësojnë cilësinë e menaxhimit të brendshëm të tyre si dhe të raportimit të informacionit financiar (Chen dhe Jaggi 2000; Eng dhe Mak 2003). Një gjë e tillë do të ketë impakt edhe në shmangien e asimetrisë informative, në lehtësimin e monitorimit e menaxhimit dhe në zvogëlimin e mundësisëë së ndodhjes së konflikteve të agjencisë, ndërmjet pronarëve dhe manaxherëve (Gompers, Ishii dhe Metrick 2003; Baiman dhe Verrecchia 1996; Botosan 1997; Core et al . 1999). Si rezultat i kësaj, kompanitë avantazhohen nga një nivel më i lartë i menaxhimit, si dhe do të kenë një cilësi më të lartë në vendim-marrje, duke kontribuar në parandalimin e krizave të mundshme financiare për bizneset (Johnson, Boone, Breach, dhe Friedman 2000). Një analizë e mirë financiare do vërë më shumë informacion cilësor në dispozicion të titullarëve të SME-ve për natyrën dhe koston e borxhit që kontraktohet me institucionin bankar, duke sjellë kështu në reduktimin e riskut të dështimit.

Pra, një nivel i mirë i menaxhimit të kompanive, u siguron atyre mundësinë për kreditime bankare me vlera më të larta dhe me kosto më të ulëta. (Lang and Lundholm 2000; Core, Holthausen, and Larcker 1999). SME-të tentojnë të kenë akses në financimin e kapitalit, dhe gjithashtu të negociojnë koston e tij. Një mungesë në studimet empirike në këtë sektor, është një arsye që më ka motivuar të zhvilloj një

kërkim shkencor në analizën e performancës së kompanive që i përkasin nivelit të SME-ve, pasi një analizë e probabilitetit për sukses apo dështim, është në ndihmë si të institucioneve kredidhënëse pra të bankave, ashtu edhe të kompanive që marrin përsipër një angazhim të tillë kontraktual disa vjecar.

Figura 1. Paraqitja grafike e sfondit të studimit



Burimi: Autori

ii Objektivat e studimit

Qëllimi i punimit është të studiojë faktorët e riskut për kreditë e vëna në dispozicion të ndërmarrjeve të vogla e të mesme në Shqipëri, me qëllim njohjen, klasifikimin e kategorive të riskut ndaj të cilave janë të ekspozuara, si dhe ndërtimin e një modeli që do te vijë në ndihmë të analizës financiare për të parashikuar rezultatet gjatë kohës së shlyerjes nga ana e SME-ve të kredisë bankare. Ky studim i vjen në ndihmë si analistit të kredisë në sektorin bankar, ashtu edhe menaxhimit të brendshëm në një biznes.

Përllogaritja e treguesve financiarë dhe analiza e atyre jo financiarë të kompanive shërben për bankën si një sinjal parashikues për përfitueshmërinë e kredive të dhëna.

Në bazë të kërkimeve në studimet paraardhëse si dhe nga analiza e realizuar, do të përpiqemi të krijojmë lidhjen e shkak – pasojë për problematikat aktuale.

Për të arritur qëllimin e kësaj teze doktorature, do të prezantohen këto çështje si objektiva për t'u diskutuar dhe studiuar:

- tipet e risqeve, ku ndërmjet tyre, një rëndësi të veçantë merr risku i kredisë;
- vështirësitë në menaxhimin e riskut të kredisë në tregun bankar shqiptar;
- efektiviteti i praktikave të menaxhimit të riskut bazuar në modelet e parashikimit të performancës të aplikuara nga bankat;
- shkaqet kryesore që shkaktojne kredi të këqija në bankat shqiptare;
- masat që janë marrë për t'u përballur me NPL-të dhe efektiviteti i tyre;
- vështirësitë dhe kufizimet që hasin SME-të për të siguruar fondet të cilat ndonjëherë janë të papërballueshme prej tyre;
- faktorët që ndikojnë në politikën shtrënguese në financimin e SME-ve nga bankat;
- si mund të përdoren raportet financiare të marra nga pasqyrat financiare të kompanive për të parashikuar performancën gjatë shlyerjes së kredisë.

iii Hipotezat e studimit

Hipoteza H1: Ka dallime të rëndësishme midis vlerave të raporteve financiare të një SME-je të suksesshme dhe asaj me probleme.

Hipoteza H2: Për një SME të kredituar nga bankat, modeli i parashikimit të performancës që përfshin raportet STR3, REN2, AKT4, është një model që ka kapacitet vlerësimi të rëndësishëm statistikisht.

Vërtetimi i hipotezës së dytë lidhet me vërtetimin e tre nënhipotezave:

> ***H2a****: Raporti i strukturës që mat aftësinë e një kompanie të shlyejë këstet mujore të kredisë së marrë, i cili matet nga raporti fitime operative mbi detyrimet totale, është një raport statistikisht i rëndësishëm për parashikimin e performancës.*

***H2b**: Raporti "Kthimi nga aktivet", i cili shprehet si raport i fitimit neto mbi aktivet totale, është një raport statistikisht i rëndësishëm për parashikimin e performancës.*

***H2c**: Raporti i qarkullimit të klientëve brenda një periudhe prej një viti kontabël, është një raport statistikisht i rëndësishëm për parashikimin e performancës.*

Hipoteza H3: Për një SME të kredituar nga bankat, një model parashikimi performance që përfshin raportet financiare STR3, RENT2, AKT4, dhe të dhënat jo financiare Z dhe V, ka kapacitet vlerësimi të rëndësishëm statistikisht.

Vërtetimi i kësaj hipoteze, lidhet me vërtetimin e këtyre nënhipotezave:

***H3a**: Performanca e një kompanie ndikohet pozitivisht nga rritja e viteve të jetës së ushtrimit të aktivitetit të biznesit.*

***H3b**: Performanca e një kompanie ka ndikime pozitive nga fakti nëse kompania operon në zonën më të zhvilluar ekonomikisht që i përket rajonit Tiranë-Durrës, në krahasim me zonat e shtrira jashtë këtij rajoni.*

Hipoteza H4: Për një SME të kredituar nga bankat, një model parashikimi që bazohet jo vetëm në raporte financiare, por edhe në të dhëna jo financiare, ka një kapacitet parashikimi më të madh se një model që bazohet vetëm në raporte financiare.

iv Kufizimet e studimit

Përveç arritjeve dhe kontributeve të këtij studimi, është për t'u theksuar se ai kufizohet nga disa faktorë.

- Ështe e qartë se ky studim është bazuar në raportet financiare të përftuara nga bilancet e SME-ve, të cilat në shumë raste, kanë përmbajtje jo cilësore. Për të patur më tepër besueshmëri në të dhënat që janë përdorur, si dhe për të kufizuar manipulimin e shifrave nga drejtuesit e kompanive, është bërë përzgjedhja apo filtrimi që në studim të përfshihen vetëm pasqyra financiare të audituara nga ekspertë kontabël. Në rastin e

pasqyrave financiare të dorëzuara në bankë si pjesë e dosjes së paraqitur për të kërkuar një kredi afatgjatë apo një overdraft, mund të tentohet nga ana e kompanive që shifrat e fitimit neto të deklarohen më të larta, pra të paraqitet situata financiare më e mirë nga sa mund të jetë në realitet. Kjo për arsye se kompania duhet të paraqitet në sportelet e bankës në gjendje të mirë financiare për të paguar këstet e kredisë, e cila është paraqitur për aprovim. Për këtë arsye nga ana e oficerëve të kredisë këkohen përvec bilancit fiskal, edhe të dhëna të tjera si shënimet e arkës, shënimet e furnizimeve, inventarit si dhe bilance faktike nëse bizneset i kanë.

Përfshirja në këtë studim e të dhënave cilësore, redukton gabimet nga gjykimet bazuar vetëm në raportet financiare, të cilat kanë një strukturë shumë të ngurtë, pra nuk janë mjaftueshëm fleksibël në gjykimin që i bëhet fenomeneve. Të dhënat cilësore të përfshira në studim janë mosha e biznesit dhe vendodhja gjeografike ku zhvillohet aktiviteti. Ndërkohë që analistët e kredisë marrin në konsideratë dhe të dhënat e tjera si psh. madhësinë e aktiveve fikse, numrin e bankave me të cilat operon kompania, numrin e punonjësve të kompanisë, palët e lidhura etj. Përfshirja e këtyre faktorëve në një model parashikimi mund të jetë subjekt i studimeve të mëtejshme në këtë fushë.

- Një kufizim i dytë qëndron në numrin e firmave të përfshira në studim. Në studim janë analizuar të dhëna nga 119 bilance, që i përkasin periudhës 2008-2011, nga të cilat 57 bilance i përkasin firmave të suksesshme dhe 62 bilance që i përkasin firmave që janë konsideruar me probleme. Është e kuptueshme që sa më i madh të jetë numri i të dhënave të përfshira në një studim, aq më shumë rritet shkalla e parashikueshmërisë së modelit. Në këtë studim, të dhënat janë mbledhur me anë të pyetësorëve të shpërndarë në bankat e nivleit të dytë, si dhe nëpërmjet kontakteve personale dhe me anë të telefonit. Shtrirja gjeografike përfshin kompani që operojnë në 9 qytete të Shqipërise si: Tiranë, Durrës, Korcë, Kavajë, Gjirokastër, Sarandë, Vlorë, Fier, Elbasan. Këto biznese operojnë në fushën e tregtisë, shërbimeve, prodhimit, në sektorë si: fason, turizem, arsim, transport, shëndetësi,

profesione të lira, etj. Megjithatë, fusha të reja studimi si nga pikëpamja gjeografike ashtu edhe sektoriale apo e industrisë mund të jenë subjekt i studimeve të ardhshme.

- Gjithashtu regresioni logjistik nuk është i thjeshtë për t'u aplikuar dhe interpretuar. Për këtë gjë, ka ardhur në ndihmë më së miri programi kompjuterik SPSS, ndërsa për interpretimin na ndihmon literatura e gjerë në këtë fushë. Studimi merr në konsideratë 15 raporte financiare, dhe 3 të dhëna cilësore, më të rëndësishmet që përmend literatura, të përftuara nga 119 bilance, duke krijuar kështu një total prej 1911 vlera, që shërbejnë si database të hedhur në SPSS për ndërtimin e modelit të parashikimit të performancës, bazuar në të dhëna financiare, me dhe pa të dhëna cilësore. Përzgjedhja e teknikës së regresionit logjistik, është bërë duke e konsideruar si metodën më të përshtatshme për të studiuar performancën e kompanive që kreditohen nga bankat, krahasuar me teknikën MDA (multi discriminant analysis) (Lo 1985) dhe metodën Logit (Zmijewski 1984)

Kështu, duke shpresuar dhe besuar në një studim të thellë të literaturës si dhe duke u mbështetur në lehtësië teknologjike, në këtë studim është bërë një përpjekje për të patur sukses në eliminimin ose të paktën minimizimin e aspekteve që limitojnë rezultatet e tij, duke arritur kështu për herë të parë të prezantohet një model parashikimi performance për SME-të që kreditohen nga bankat, duke u mbështetur në raportet financiare dhe të dhënat cilësore.

v Organizimi i studimit

Ky punim disertacioni është ndërtuar në pesë kapituj.

Në kapitullin e parë të disertacionit paraqitet një rishikim i literaturës mbi riskun e kredisë për SME-të , mënyrën dhe instrumentet për menaxhimin e tij. Duke u bazuar në Marrëveshjen e Basel II, përmenden përbërësit e riskut të kredisë. Pjesë e vlerësimit të riskut të kredisë është renditja e kredimarrësve nga kompanitë e specializuara në këtë fushë, duke patur si qëllim parashikimin e vlerës së humbjes në rast dështimi të kredimarrësit. Në vazhdim të kapitullit të parë flitet për modelet e

vlerësimit të riskut të kredive, nga ana cilësore dhe ajo sasiore, duke përmendur këtu modelet cilësore, heuristike dhe format hibride. Modelet e parashikimit të performancës ndahen në financiare dhe cilësore dhe vëmendja fokusohet në modelet më të përdorura sot në botë dhe në Shqipëri. Në praktikat e bizneseve dhe në botën akademike, janë përdorur në shumë disiplina të ndryshme, si analiza diskriminuese ashtu edhe analiza e regresionit logjistik, ku rishikohet literatura në lidhje me avantazhet dhe disavantazhet e secilit model.

Në kapitullin e dytë përshkruhet klima e biznesit në ekonominë tonë, për t'u përqëndruar në vazhdim, tek sektori i SME-ve. Duke u bazuar në publikime dhe vlerësime të institucioneve vendase dhe të huaja, bëhet një analizë e plotë e mjedisit ekonomik dhe politik, si dhe përmenden faktorët e këtij mjedisi që ndikojnë në aktivitetin e ndërmarrjeve. Disa nga faktorët janë: reforma e pronës, mbrojtja e investitorëve, proçesi i kredimarrjes së SME-ve, trajtimi fiskal i SME-ve, importet dhe eksportet, falimentimi i SME-ve, infrastruktura rrugore, remitancat, investimet e huaja direkte, etj. Në këtë kuadër studiohen faktorët nga aspekti i zhvillimit të tyre historik dhe aktual. Në këtë kapitull gjithashtu trajtohen karakteristikat e SME-ve, rëndësia e tyre për ekonominë tonë, risku që i shoqëron ato në aktivitetin e tyre ekonomik.

Në kapitullin e tretë përshkruhet situata dhe zhvillimet e sistemit bankar në Shqipëri, problematikat që janë hasur më parë dhe që ndeshen sot, në lidhje me financimin e SME-ve. Këtu lexuesi informohet për aktivitetin kreditues për këtë sektor ndërmarrjesh nga bankat e nivelit të dytë, duke u ndalur tek risqet me të cilat përballet sektori bankar në proçesin e financimit të SME-ve. Theksi vihet mbi riskun e kredisë si përbërësi kryesor i riskut të përgjithshëm, dhe brenda këtij kuadri, analizohet situata e kredive me probleme. Më pas trajtohen kuadri ligjor, pra aktet rregullative të miratuara. Tërësia e tyre përbën kuadrin rregullativ të mbikëqyrjes, nëpërmjet të cilit kufizohet risku që ndërmarrin bankat gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, ku do të ndalemi tek teknikat për zbutjen e riskut të kredisë.

Në kapitullin e katërt përshkruhet baza e të dhënave, si dhe ndërtimi i modelit të parashikimit të performancës së SME-ve gjatë financimit bankar të tyre. Më parë shpjegohet përkufizimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme në bazë të legjislacionit tonë, pastaj filtrohen të dhënat që përputhen me këtë ndarje. Të dhënat janë marrë nga

ndërmarrje që operojnë në nëntë qytete, i përkasin sektorëve të ndryshëm (shërbime, tregti, prodhim), kanë kohëzgjatje të ndryshme të aktivitetit të tyre, dhe që i kemi klasifikuar si të suksesshme dhe me probleme duke u nisur nga raporti i autonomisë së financimit me kapitalin e vet. Ngrihen katër hipoteza në lidhje me raportet financiare dhe të dhënat jo financiare të përzgjedhura për t'u përfshirë në model.

Në kapitullin e pestë dhe të fundit përshkruhen arritjet dhe gjetjet e studimit, thellohemi në rezultatet e analizës, dhe bëjmë interpretimet përkatëse. Duke u nisur nga përfundimet e analizës, si dhe nga studimi i situatës aktuale të aktivitetit kreditues për SME-të, rendisim disa rekomandime në lidhje me menaxhimin e riskut të kredisë. Një sërë mundësish ekzistojnë në të ardhmen për të vazhduar kërkimet në çështje që lidhen me ato që janë diskutuar në këtë punim disertacioni, apo rreth atyre problematikave të cilat vetëm sa janë përmendur. Ndërkohë që analistët e kredisë marrin në konsideratë dhe të dhënat e tjera si psh. madhësinë e aktiveve fikse, numrin e bankave me të cilat operon kompania, numrin e punonjësve të kompanisë, palët e lidhura, etj. Përfshirja e këtyre faktorëve në një model parashikimi mund të jetë subjekt i studimeve të mëtejshme në këtë fushë.

KAPITULLI I - RISHIKIMI I LITERATURËS

1.1 Risku i kredisë për SME-të dhe menaxhimi i tij

Një funksion kyç i bankës është ndërmjetësimi financiar, duke pranuar depozita nga ata që kanë tepricë fondesh dhe duke i kredituar bizneseve dhe/ose individëve fondet e kërkuara. Ndërmarrja e riskut është një element i brendshëm i veprimtarisë bankare, por risku i tepërt dhe menaxhimi i dobët i tij, mund të çojë në humbje, duke rrezikuar kështu sigurinë e një banke. Duke patur parasysh që bankat luajnë një rol të tillë të rëndësishëm, dhe duke qenë kyç për stabilitetin kombëtar dhe ndërkombëtar financiar, ato duhet të operojnë në mënyre të sigurtë dhe të shëndoshë, dhe të mbajnë kapital dhe rezerva të mjaftueshme për të përballuar risqet që ndërmarrin gjatë ushtrimit të biznesit të tyre.

Qëllimi i këtij kreu është trajtimi i riskut të kredisë, si risku kryesor me të cilin përballet sektori bankar, në funksion të parimeve bazë për njohjen, vlerësimin dhe menaxhimin e tij, në kuadrin e rregullave të vendosura nga Komiteti i Baselit dhe të masave të marra nga Banka e Shqipërisë.

Përgjegjësia kryesore për të siguruar që një bankë disponon strategji, politika, proçese dhe teknologji të menaxhimit të riskut, për të matur, monitoruar dhe kontrolluar në mënyrë të përshtatshme ekspozimet ndaj risqeve që merr përsipër, bie mbi këshillin drejtues dhe drejtuesit e lartë të bankës. Ndërsa mbikëqyrësit i ndihmojnë këto institucione në administrimin sa më efektiv të risqeve që ato marrin përsipër, si dhe në vlerësimin nëse rezervat që këto institucione krijojnë për përballimin e të gjithë risqeve dhe veçanërisht të riskut të kredisë, janë të mjaftueshme për të siguruar një veprimtari të qëndrueshme dhe të shëndoshë financiare, në kuadër të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe të mbështetjes së rritjes ekonomike të vendit.

Risku i kredisë është mundësia që huamarrësi ose kundërpala e një banke në një kontratë/marrëveshje, të mos plotësojë pjesërisht ose plotësisht detyrimet e tij/saj (principal/kryegjë, interes dhe komisione) në kohën e duhur, në përputhje me kushtet e rëna dakord në marrëveshjen/kontratën e tyre. Ose ndryshe, mund të thuhet se ky risk ka të bëjë me pasigurinë në mundësinë e një kundërpale për të plotësuar detyrimet e saj. Për faktin se ekzistojnë lloje të shumta kundërpalësh, nga individet tek organet

qeveritare, si dhe shumë lloje detyrimesh, nga huatë për makina tek transaksionet derivative, risku i kredisë merr shumë forma dhe bankat i menaxhojnë në mënyra të ndryshme. Ky risk është risku më i rëndësishëm që përballon një bankë, duke patur parasysh që kreditë përbëjnë pjesën më të madhe të aktiveve të një banke. Risku i kredisë gjendet në të gjitha veprimtaritë bankare, për të cilat fitimi varet nga pagesa apo jo e borxhit nga huamarësi ose kundërpala në kontratë. Ky risk shfaqet çdo herë që fondet e bankës investohen apo angazhohen duke u reflektuar në bilanc ose në zërat jashtëbilanci. Risku i kredisë mund të rezultojë edhe nga standarde kredidhënie të dobta ose mosekzistenca e tyre, menaxhim i dobët i portofolit të kredive, kushte ekonomike të dobësuara, dhe një sërë shkaqesh të tjera.

Për përballimin e riskut të kredisë për një veprimtari të qëndrueshme e të shëndoshë, bankat duhet të krijojnë rezeva të mjaftueshme financiare. Kështu, për përballimin e humbjeve të paparashikuara të riskut të kredisë, banka llogarit dhe mban një kapital të mjaftueshëm në varësi të madhësisë së riskut që banka merr përsipër, duke plotësuar kërkesat e Bankës Qëndrore, në rastin tonë kërkesat e Bankës së Shqipërisë, për llogaritjen dhe ruajtjen e nivelit të tij. Për këtë qëllim, bankat e sektorit tonë bankar, bazohen në rregulloren e Bankës së Shqipërisë, Nr. 58, date 05.05 1999, e ndryshuar "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit". Kjo rregullore përcakton koefiçientët për ponderimin e aktiveve dhe zërave jashtëbilanci të bankës, në varësi të shkallës së riskut të kredisë.

Bazuar në këtë rregullore, bankat duhet të mbajnë kapital të mjaftueshëm në vartësi të riskut të aktiveve dhe angazhimeve të saj financiare. Mjaftueshmërinë e këtij kapitali, mbikqyrësit e vlerësojnë bazuar në treguesin e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit për përballimin e humbjeve të pritura ose ndryshe të parashikuara nga risku i kredisë, bankat Ilogarisin dhe mbajnë provigjonet për humbjet nga risku i kredisë, bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë nr 52, datë 14.07.2004, e ndryshuar "Për administrimin e riskut të kredisë".

1.2 Përbërësit e riskut të kredisë

Basel II identifikon tre komponentë kryesorë të riskut të kredisë. Në vlerësimin e riskut të kredisë nga një kundërpalë e vetme, një bankë duhet të konsiderojë tre çështje:

1. *Probabilitetin e dështimit,* i cili i përgjigjet pyetjes se sa është mundësia që një kundërpalë do të dështojë në shlyerjen e detyrimeve të saj gjatë gjithë kohëzgjatjes së detyrimit, ose për një vit. E llogaritur për një periudhë njëvjecare, kjo mund të quhet edhe frekuencë e dështimit të pritur.

2. *Ekspozimin e kredisë*, i cili në rastin e një dështimi, na jep se cila është vlera e mbetur e detyrimit kur dështimi ndodh.

3. *Normën e mbulimit*, në rastin e një dështimi, llogaritet se ç'pjesë e ekspozimit mund të rikuperohet/mbulohet nëpërmjet procedurave të falimentimit, ekzekutimit të kolateralit etj.

Ndërsa, termi cilësi e kredisë i referohet aftësisë së kunderpalës për të përmbushur këtë detyrim. Kjo përfshin probabilitetin e dështimit në shlyerjen e një detyrimi si dhe normën përkatëse të mbulimit. Është e njohur që çdo risk ka dy elementë: ekspozimin dhe pasigurinë. Për riskun e kredisë ekspozimi i kredisë ose ndryshe shuma e mbetur e kredisë, përfaqëson të parin dhe cilësia e kredisë përfaqëson të dytin.

Në vitet e fundit, humbjet në aktivitetin e kredidhënies bankare për koorporata të tilla si Enron në Shtetet e Bashkuara, së bashku me Swissair në Evropë si dhe dështimi në borxhet qeveritare në Greqi, kanë patur një ndikim shumë të madh në opinionin publik mbarë botëror.

Si kundërpërgjigje të këtyre ngjarjeve, gjithashtu dhe të faktorëve të tjerë si zhvillimet e reja në bazën ligjore për mjaftueshmërinë e kapitalit, ka rezultuar një rritje të fokusit të institucioneve financiare në menaxhimin e riskut të kredisë, veçanërisht matjen e riskut të kredisë.

Pjesë e vlerësimit të riskut të një kredie, është renditja (ranking) e çdo kredimarrësi në krahasim me një grup kredimarrësish, si dhe një produkt të caktuar në krahasim me një grup produktesh të kredive të ofruara nga institucioni bankar. Një sistem vlerësimi risku, RR hartohet në mënyrë të tillë që të evidentojë riskun e humbjes në një linjë kredie. Një sistem i mirë i vlerësimit të riskut të kredisë duhet të ofrojë një seri hapash të dizenjuara dhe të strukturuara më së miri për vlerësimin e sipërpërmendur duke u bazuar në dokumentacionin e duhur. Qëllimi është të vlerësohet humbja e pritshme, e cila është prodhimi i shumës së ekspozuar, me

probabilitetin e dështimit, për një kredimarrës, duke supozuar një humbje në rast dështimi.

Një metodologji tipike e matjes së riskut, i cakton çdo detyruesi një normë që identifikon probabilitetin e pritshëm të dështimit, sipas të cilit kredimarrësi ose një grup kredimarrësish i shlyejnë bankës detyrimet e tyre rregullisht gjatë kohëzgjatjes së kredisë. Me fjalë të tjera, matja e riskut na jep anën sasiore të cilësisë së kredisë së dhënë apo të një portofoli kredish. Nëse renditja e riskut aplikohet në mënyrë të saktë dhe konsistente, atëhere arrihet një kuptim i plotë i riskut të kredisë

Renditja e kredisë individuale, kryhet për një koorporatë, për një SME, për një individ apo edhe për një vend. Renditja e kreditit llogaritet nga historia financiare, aktivet aktuale, si dhe përbërja e pasiveve. Në mënyrë tipike, një vlerësim i kredisë tregon probabilitetin që një subjekt të jetë në gjendje të paguajë një kredi. Megjithatë, në vitet e fundit, RR gjithashtu përdoren për të llogaritur primet e sigurimit, si dhe për të përcaktuar shumat e mundshme për kredidhënie. Vlerësimi i kreditit të një korporate është një tregues financiar për investitorët potencialë të letrave me vlerë të borxhit të tilla si obligacionet. Këto janë caktuar nga agjenci të posaçme për klasifikimin e kredive të tilla si Standard & Poor, Moody ose FitchRatings. Renditja e kredive për qeveritë tregon nivelin e riskut në investimin e titujve qeveritarë të vendeve të ndryshme, dhe përdoret nga investitorët që kerkojnë të investojnë jashtë vendit të tyre. Ky klasifikim bazohet në riskun politik. Vendet me risk më të ulët kanë nivel pikësh më të lartë.

Një sistem i renditjes së riskut gjithashtu krijon mundësinë për llogaritjen e kapitalit të përdorur në modelet e çmimit, si dhe ndihmon në llogaritjen e rezervës së kredive. Një sistem renditje risku mund të përdoret në matjen e riskut në koorporatat e mëdha, sektorët e tregtisë, por nuk mund të mbulojë të gjithë sektorët. Probabiliteti i dështimit, për çdo gradë renditje përfaqëson përqindjen mesatare të dështimit të kredimarrësit në këtë klasifikim, gjatë periudhës kohore të një viti. Për një kompani, probabiliteti që dështimi të ndodhë gjatë periudhës së dhënë, karakterizohet nga risku i dështimit. Nga pikëpamja ekonomike, dështimi përcaktohet atëherë kur vlera e aktiveve të kredimarrësit bie nën vlerën e borxhit.

Disa teori konsiderojnë mundësinë që një firmë të migrojë nga një klasë risku në një tjetër. Migrimet janë përkeqësime të situatës ekonomike, të cilat përkthehen respektivisht në probabilitet dështimi më të lartë ose më të ulët.

Kompani me renditje të lartë, tentojnë të manaxhojnë kreditë e marra më mirë se ato kompani që janë në klasifikimet e ulëta si dhe kanë më pak mundësi për dështim. Risku i kredisë paraqet tendenca rritjeje me rritjen e kohës së maturimit, sa më e gjatë kohëzgjatja e kredisë, aq më e madhe mundësia e falimentit. Një maturim më i shkurtër, rrit fleksibilitetin e kreditorit për të limituar humbjet e ardhëshme. Kjo mund të arrihet duke modifikuar termat dhe kushtet e kredisë. Këto humbje zakonisht janë të shprehura në përqindje të EAD, dhe varen ndërmjet të tjerash nga tipi e shuma e kolateralit, tipi i kredimarrësit, mënyra e përdorimit të aktiveve, vështirësitë legale, risku që lidhet me shtetin ku kryhet aktiviteti etj.

Është e rëndësishme të përmenden garancitë në kufizimin e riskut të kredisë. Basel II cilëson si garanci kryesore:

- Kolaterale të cilat janë aktive që i konfiskohen kredimarrësit në rast falimentimi;
- Persona të tretë si garantorë;
- Kushtet të cilat janë klauzola kontraktuale të tilla si raporti i mbulimit me kolateral, apo obligime legale që të mos ndryshohet aktiviteti operativ, apo të mos rritet ekspozimi i subjektit ndaj sistemit bankar pa njoftim paraprak të bankës, etj. Shkelja e këtyre kushteve sjell në një pagesë të menjëhershme të shumave të paravendosura në kontraten si gjoba për shkeljen e kushteve.

Kolateralet shërbejnë për të limituar humbjet e kredidhënësit në rastet e dështimit si dhe motivimin për të marrë përsipër riskun nga ana e kredimarrësit. Një kredimarrës ngurron të heqë dorë nga një kolateral që vlen më tepër se kredia e marrë.Nga ana tjeter, personat që paraqiten si garantorë, nuk arrijnë të limitojnë prirjen ndaj riskut për huadhënënsin. Megjithatë, ekzistenca e garantorëve, do të zvogëlojë probabilitetin e dështimit, pasi në rast se dështimi ndodh, kjo do të thotë se

kanë falimentuar si kredimarrësi kryesor ashtu dhe garantori. Në këtë rast kemi të bëjmë me dështim të dyfishtë.

Përpara se një bankë të marrë vendimin për aprovimin e kredisë, ajo duhet të ketë në dorë informacione në lidhje me aftësinë e kredimarrësit për të shlyer kredinë dhe të vlerësojë në mënyrë individuale faktorët e riskut. Duke vepruar kështu, banka vlerëson sasinë e riskut të kredisë që ajo merr në rast se kredia aprovohet. Për këtë arsye, analiza e kredisë është një pjesë kritike e menaxhimit të riskut të kredisë që kryhet ex ante, dhe rezultatet e kësaj analize të kredisë shërbejnë si bazë për interesin që banka aplikon për këtë kredi.

1.3 Modelet e vlerësimit të riskut të kredive

Kriteret për analizën e kredisë përfshijnë dy tipe të dhënash: cilësore dhe sasiore, ku ndër këto të fundit vendin kryesor e zënë të dhënat financiare. Analiza e kredisë gjithmonë përfshin kombinimin e tyre, për arsye se ka shumë faktorë që ndikojnë të ndërthurur me njëri tjetrin. Kriteret në të cilat bazohet gjykimi për aprovimin e një kredie, ndryshojnë në varësi të llojit të kredimarrësit.

Krijimi i një baze të plotë dhe cilësore të dhënash si dhe metoda e përzgjedhur për përpunimin e tyre dhe arritjen në një vlerësim kredie, kanë një ndikim të madh në cilësinë e një sistemi klasifikimi.

Në këtë kapitull prezantohen modele të ndryshme të vlerësimit të kredive që përdoren sot nga bankat, duke patur në vëmendje mënyrën se si aplikohet në përgjithësi, si dhe zbatimi i tyre në praktikë. Këto modele rrallëherë përdoren të vetme, pasi në përgjithësi i ndeshim të aplikuara në kombinim me njëra tjetrën.

Përdorimi kryesor i këtyre modeleve shërben për të klasifikuar kredimarrësit, por edhe për klasifikimin e transaksioneve.

1.3.1 Modelet Heuristike

Modelet Heuristike bazohen në gjykimet mbi eksperiencat e kaluara, si psh. eksperienca subjektive dhe vëzhgimet praktike, marrëdheniet ndërmjet bizneseve, teoritë e biznesit në lidhje me disa aspekte specifike.

Në vlerësimin e kredisë, këto modele përbëjnë një përpjekje për të përdorur eksperiencën në proçesin e aprovimit ose jo të praktikës së një kredie. Kështu, cilësia e modeleve Heurisike varet nga saktësia e gjykimit të eksperiencave të specialisteve ose analistëve të kredisë. Pra, në mënyrë Heuristike gjykohen jo vetëm faktorët e rëndësishëm për vlerësimin e kredisë, por edhe ndikimi dhe pesha që zënë në proçesin në tërësi është gjithashtu e bazuar në eksperiencën subjektive. Në zhvillimet e këtyre modeleve Heuristike, faktorët që ndikojnë në vlerësimin e kredisë, nuk i nënshtrohen ndonjë vlerësimi statistikor. Në praktikë modelet Heurisitke janë të grupuara dhe përdoren nga drejtuesit e sistemeve të vlerësimit.

1.3.2 Modelet cilësore

Në sistemet cilësore, informacioni i nevojshëm për vlerësim gjithashtu kategorizohet në bazë të eksperiencës së ekspertëve. Megjithatë, në dallim nga pyetësorët klasikë, sistemet cilësorë nuk vendosin një numër të caktuar pikësh për çdo faktor specifik. Informacioni individual ndahet në kategori, ku secila prej tyre duhet të vlerësohet në terma cilësore nga shërbimi i klientit, duke përdorur një shkallëzim të caktuar. Kjo është e mundur me ndihmën e sistemit të shkallëzuar ose vlerave të zakonshme (psh, “mire”, “mesatare”, “keq”). Vlerësimet individuale, kombinohen dhe japin një rezultat për vlerësimin e kredisë. Këto vlerësime individuale përsëri vlerësohen dhe i jepet rëndësia e duhur nisur nga eksperienca subjektive.

Me qëllim që të sigurohet që të gjithë përdoruesit të kenë të njëjtën shkallë njohjeje të mënyrës së vlerësimit, një sistem cilësor duhet të shoqërohet nga një manual përdorimi. Të tillë manualë përmbajnë përshkrime verbale, për çdo kategori informacioni, të rëndësishme për vendimin e kredidhënies, për çdo kategori në shkallën e klasifikimeve, në mënyrë që të shpjegojnë kërkesat që duhet të plotësojë një kredimarrës.

1.3.3 Format Hibride

Në praktikë modelet e mësipërme rrallë herë përdoren në formën e tyre të pastër, më shpesh modelet Heuristike përdoren në kombimim me një nga dy tipet e modeleve statistikore ose kauzale, gjë që përmirëson analizën e kredisë sepse metoda të ndryshme plotësojnë njëra tjetrën. Për shembull, avantazhet e modeleve statistikore

qëndrojnë në objektivitetin dhe perfomancën më të lartë në krahasim me modelet Heuristike. Megjithatë, modelet statistikore mund të marrin në konsideratë vetëm një pjesë të faktorëve. Pa përfshirjen e njohurive të ekspertit në formën e moduleve heuristike, mund të kemi humbje në informacione të rëndësishme në raste të veçanta. Për më tepër, jo të gjitha modelet statistikore janë në gjendje të proçesojnë direkt informacionin cilësor, (si psh rasti i analizës diskriminuese), ose ato kërkojnë një sasi të madhe të dhënash me qëllim që të funksionojnë si duhet. (psh regresioni logjistik), këto të dhëna janë zakonisht të pakta ose mungojnë nëpër banka. Me qëllim që të kemi një pamje të plotë të gjendjes së kredimarrësit, në raste të tilla, është me vend përdorimi i të dhënave cilësore duke zbatuar si shtesë analize edhe modelet Heuristike. Ky komponent Heuristik, përfshin ekspertët e analizës së kredisë shumë më tepër në proçesin e klasifikimit, se sa vlerësimi automatik i kreditit (rasti i perdorimit të programeve kompiuterike).

1.4 Modelet e parashikimit të perfomancës

Ekzistojnë dy lloje kryesore të modeleve për parashikimin e performancës:

- **Modelet e parashikimit financiar**

Ndër modelet e parashikimit financiar, modeli më tipik është "Parashikuesi i falimentimit Altman", që përfaqëson një teknikë analize bazuar në shumën e pesë raporteve financiare (të shprehura në shifra dhjetore), të cilat janë llogaritur nga informacioni financiar që përfshihet në pasqyrat financiare vjetore të një kompanie dhe që njihet si rezultati Z.

Teknikat e pikëzimit si ajo e krijuar nga Altman, përdorin një përfundim të analizës së raportit klasik të njohur si analiza diskriminuese e shumëfishtë (MDA). MDA thjesht merr dy "popullsi", koorporatat e dështuara dhe ato jo të dështuara dhe bën krahasime ndërmjet dy grupeve të "popullsisë".

- **Modelet e parashikimit jo-financiar**

Më i përmenduri në literaturë ndër modelet e parashikimit jo-financiar, është "Modeli i rezultatit A" nga autori John Argenti, i cili bazohet kryesisht mbi variablat cilësore duke theksuar nevojën për njohjen e një klienti nga afër pasi në rastin e një

falimentimi të mundshëm ekzistojnë simptoma të dallueshme që duhet të analizohen. Tabela 4 paraqet simptomat, të cilat konsiderohen si të dëmshme për shëndetin e firmës, së bashku me faktorët relativë. Kompania ideale do të kishte rezultatin 0, ndërsa kur rezultati kalon vlerën 25 firma paraqet mundësi dështimi. Zona gri është ndërmjet 18 dhe 25, e kjo do të thotë që menaxhimi i kompanisë duhet të ndërmarrë masat e duhura korrigjuese.

Tabela 1: Modeli Argenti "Rezultati A"

Defektet	
	<u>Në menaxhim</u>
8	Drejtuesi Ekzekutiv është autokrat
4	Drejtuesi Ekzekutiv është gjithashtu Kryetar Bordi
2	Bord pasiv
2	Bord i pabalancuar, shumë lloje financash
2	Drejtor finance i dobët
1	Menaxhim i dobët
	<u>Në kontabilitet</u>
3	Nuk ka buxhete apo kontrolle buxhetore (për vlerësimin e variablave, etj.)
3	Nuk ka plane për rrjedhjen e parasë, ose ato nuk janë të përditësuara.
3	Nuk ka sistem kostosh. Kosto dhe kontributi i çdo produkti është i panjohur.
15	Përgjigje e varfër kundrejt ndryshimit, produkt i dalë mode, fabrikë e vjetruar, drejtorë të vjetër dhe marketing jashtë mode.
Defektet në total	**43**
	<u>Gabime</u>
15	Borxh i lartë, firmës mund t'i krijohen probleme për arsye të fatit të keq.
15	Mbitregtimi. Kompania po zgjerohet më shpejt sesa financimi i saj. Baza e kapitalit është shumë e vogël ose e pabalancuar për madhësinë dhe llojin e biznesit.
15	Projekti i madh ka shkuar keq. Çdo detyrim të paplotësuar nga kompania, nëse diçka shkon keq.
Gabimet në total	**45**

	Simptoma
4	Tregues financiar, si rezultati Z, që shfaqen afër dështimit
4	Kontabilitet kreativ. Drejtuesi Ekzekutiv është i pari që do të dallojë shenjat e dështimit dhe, në përpjekje për ta fshehur atë nga kreditorët dhe bankat, "fshehja" e llogarive, për shembull, mbivlerësimi i aksioneve, përdorimi i amortizimit më të ulët, etj. Vëzhguesit e aftë mund t'i vërejnë këto gjëra
3	Shenja jo-financiare, si zyra të parregullta, paga të ngrira, moral i ulët dhe thashetheme.

Simptomat në total 12

Rezultati total

Burimi: J. Argenti.(1997) "Parashikimi i falimentimit të kompanive kohë më parë nuk mjafton: Kontabiliteti[1]

Disa nga variablat e këtij modeli janë me natyrë konfidenciale, por disa banka, informacionin janë në gjendje ta përdorin për arsye të marrëdhënieve të tyre me klientët. Në këtë mënyrë, modeli nuk mund të përdoret nga investitorët e aksioneve apo kompanitë për të kërkuar furnitorë tregtarë.

Modeli është thuajse subjektiv në aspektin që ai mbështetet në mendimin praktik më shumë sesa në një model të pastër sasior siç janë vlerësimet Altman. Në të kundërt, modeli bazohet mbi një sërë faktorësh të gjykimit të drejtë të cilët janë krijuar për identifikim dhe analizën pasuese. Modeli ka një fokus praktik duke marrë në konsideratë faktin se shumë kompani të dështuara aktualisht nuk i kanë vlerësuar llogaritë e tyre në 2 – 3 vitet para falimentimit dhe se drejtorët kishin tendencën të largoheshin nga kompanitë që po falimentonin.

Mbrojtësit e këtyre metodave pretendojnë se kanë aftësi të parashikojnë falimentin deri në 5 vjet para se të ndodhë. Megjithatë, nuk është e sigurt nëse

[1] Titulli në origjinal: "Company Failure Long Range Prediction is Not Enough: Accountancy", Andrew Fight, "Menaxhimi i riskut të kredisë", fq 230

ekziston një marrëdhënie e qartë shkak-pasojë ose nëse lidhjet ndërmjet rezultatit dhe performancës janë me natyrë të ngjashme. Të dyja teknikat kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Për shembull, Altmani beson në integritetin e pasqyrave financiare. Modeli i Argentit është plotesisht subjektiv dhe kjo gjë bën që ai të etiketohet si "jo sasior" ose "jo shkencor".

1.5 Analiza e raporteve financiare

Analiza e raporteve përfshin llogaritje dhe krahasime të raporteve që merren nga pasqyrat financiare të kompanisë aplikuese për kredinë. Në shumicën e rasteve, analiza kredisë bazuar në pasqyrat financiare përqëndrohet në një krahasim të hyrjes së parasë në kompani dhe daljes ose kërkesës për para. Analiza e riskut duke përdorur të dhëna të pasqyrave financiare kryesisht shqyrton:

- riskun afatshkurtër të likuiditetit, që i referohet aftësisë për të gjeneruar të holla në dispozicion të nevojave të kapitalit punues dhe kërkesat e shlyerjes së shpenzimeve lidhur me kreditë afatshkurtra;
- riskun afatgjatë ose aftësinë paguese afatgjatë, aftësinë për të gjeneruar të holla brenda kompanisë si rezultati i aktivitetit operativ për të kënaqur kapacitetin prodhues dhe nevojat e shlyerjes së borxhit.

Fusha e financave identifikon dy lloje të risqeve: riskun e kredisë, pra aftësinë e një firme për të bërë pagesat e interesit dhe kryegjësë; risku i falimentimit, pra mundësia që një firmë të likuidohet.

Analiza e raporteve përfshin llogaritjen dhe krahasimin e raporteve në vlerat e tyre historike, trendi i zhvillimit të këtyre raporteve shërben për të kryer parashikime për gjendjen financiare të kompanisë. Raportet kryesore që përdoren për këtë qëllim janë: raportet e kthimit, raportet e qarkullimit, raportet e likuiditetit, raportet e strukturës. Këto raporte fokusohen në fitimet e një firme dhe janë faktori kyç në një analizë kredie. Raportet përdoren për të krahasuar dhe analizuar performancën financiare që raporton firma në pasqyrat financiare .

Tabela 2: Paraqitja skematike e tipeve të risqeve

Aktiviteti	Aftësia për të gjeneruar para	Nevoja për të përdorur paranë	Analiza e raporteve financiare
Operacionet	Përfitueshmëria e mallrave dhe shërbimeve të kryera	Kërkesat për kapital punues →	Risk afatshkurtër i likuiditetit
Investimet	Shitja e investimeve dhe pajisjeve aktuale	Kërkesat për kapacitet prodhues	Risk afatgjatë i likuiditetit
Financimet	Kapaciteti i huamarrjes	Kërkesat për pagesën e kredive	

Burimi: Autori

1.6 Modelet e vlerësimit me pikë (Credit Scoring Models)

Thuajse të gjithë modelet e vlerësimit me pikë bazohen në variabla të ngjashëm, duke përfshirë kombinime treguesish mbi performancën financiare, si dhe një numër të vogël variablash shtesë që tentojnë të zbulojnë aspekte të elementeve cilësore në proçesin e analizës së kreditit. Nga praktika, raportohet se elementet e ashtuquajtur cilësorë, që përfshijnë gjykime dhe arsyetime nga ana e analistit të kredisë, zënë thuajse 30-50% të peshës në treguesit për vlerësimin e një praktike kredidhënie .

Për huatë, për individë ose biznese të vogla, cilësia e kredisë vlerësohet nëpërmjet proçesit të pikëve të kredisë "credit scoring". Para dhënies së një kredie, një bankë

merr informacion rreth palës që kërkon huanë. Në rastin e një personi fizik, ky informacion mund të përfshijë të ardhurat vjetore, borxhet ekzistuese, nëse zotëron një shtëpi apo e ka me qira etj. Një formulë standarte zbatohet mbi informacionin, për të prodhuar një numër, i cili quhet "credit score ". Bazuar në këtë numër pikësh banka vendos nëse do ta japë ose jo kredinë. Ky proçes është mjaft i standartizuar, pasi përfaqëson thjesht një zbatim formule. Shumë lloje të riskut të kredisë, që shoqërojnë kundërpalët e mëdha, janë të komplikuara, unike ose të një natyre të tillë që duhen vlerësuar në një mënyrë më pak sasiore. Termi “analizë kredie”, përdoret për të përshkruar çdo proçes për vlerësimin e cilësisë së kredisë së një kundërpale. Ndërkohë që ky term mund të përfshijë "credit scoring", ai i referohet më tepër proçesit që përfshin gjykimin e ekspertëve rreth informacionit të kundërpalës. Kjo mund të përfshijë bilancin, pasqyrën e fitim humbjes, tendencat e fundit të industrisë, mjedisin ekonomik aktual etj. Bazuar mbi këtë analizë, çdo kundërpale i përcaktohet një "credit rating", e cila mund të përdoret në vendimmarrjen për kredinë.

1.7 Teknikat e menaxhimit të riskut

Për koorporatat janë aplikuar teknika të menaxhimit të riskut me qëllim që të arrihet të vlerësohet dhe matet risku nga ana sasiore. Këto teknika janë fokusuar kryesisht në parashikimin e probabilitetit për dështim të kompanive të listuara në bursë. Pjesa më e madhe e kërkimeve në këtë fushë, është kryer fillimisht nga Altman (Altman 1968). Studimet më të hershme datojnë në vitet 1960, por efekti dhe zbatueshmëria praktike për vendet në zhvillim filloi të shfaqet në vitet 1990. Në këto studime të hershme për të parashikuar probabilitetin e dështimit të kompanive të mëdha të listuara në bursë, autorët përfshinin percaktimin e raporteve të duhur financiarë që do të masnin më mirë këtë probabilitet. Për këtë qëllim u përdorën analizat me shumë diskriminantë ose modelet logit dhe probit. Modelet “Neural network” u përdorën për të lejuar lidhjet jo lineare midis variablave[2]. Këto modele u

[2] Altman, E.I., G. Marco, F. Varetto, (1994), “Corporate Distress Diagnosis: Comparisons using Linear Discriminant Analysis and Neural Networks (the Italian Experience)”, Journal of Banking and Finance, Vol. 18 n. 3, pp. 505-529.

kritikuan më vonë për mungesë baze teorike, dhe dështuan në gjetjen e një modeli më të mirë se sa modelet lineare[3]. Modele të tjera të përdorura, u bazuan në analizën e pemës së vendim marrjes si dhe në analizën diskriminuese Bayesian. Në këto studime të cilat u bazuan në raportet financiare, raportet u llogaritën në një kohë të paracaktuar, përpara se të ndodhte falimentimi, zakonisht kjo kohë ishte 1 vit kontabël, prandaj dhe këto modele janë konsideruar si modele statike. Në studimet e kryera nga Stein dhe Ziegler[4], ata fokusohen në të dhëna të tjera të kompanive, jo thjesht në ato të marra nga kontabiliteti, si psh. në impaktin e sjelljes manaxheriale në një kompani. Për fat të keq, në këto studime u ndie mungesa e një numri të mjaftueshëm kompanish të falimentuara që mund të plotësonin kushtet për t'u bërë pjesë e këtyre kërkimeve.

Kërkimet e mëvonshme për probabilitetin e falimentimit të koorporatave, përfshin aplikimin e modeleve që bazohen në riskun me kalimin e kohës, në vend të modeleve statike. Shumaway (2001)[5] argumenton se çështja e modeleve statike të kombinuara me modele që përfshijnë të dhëna të shumë periudhave, na çon në përfundime dhe vlerësime të cilat janë të njëanëshme, jokonsistente, dhe joefiçente, për këtë arsye ai propozoi të përdoren modele që bazohen në riskun e kohës. Risitë e mëvonshme në modelimin e riskut përfshijnë informacionin e kombinuar nga tregu dhe nga kontabiliteti.[6]

1.8 Disa nga modelet riskut të kredisë të zbatuara në botë për sektorin e SME-ve

[3]Altman , Saunders (1998), "Credit risk measurement: Developments over the last 20 years", Journal of Banking & Finance 21, 1721±1742

[4] Stein and Ziegler, (1984), "The prognosis and surveillance of risks from commercial credit borrowers", Journal of Banking and Finance, pp. 249–268.

[5]Shumaway, (2001), Forecasting Bankruptcy More Accurately:A Simple Hazard Model, Journal of Business, 74, 101-124

[6]Hillegeist, Keating, Cram, Lundstedt (2004)," Assessing the probability of bankruptcy Review of Accounting Studies."

Altman dhe Sabato (2007)[7] aplikuan për herë të parë një model parashikimi të vështirësive financiare në mënyre specifike për sektorin e biznesit të vogël e të mesëm në **USA**, bazuar në raportet financiare të nxjerra nga kontabiliteti. Ata arritën në përfundimin se bankat duhet të aplikojnë jo vetem procedura të ndryshme për këtë sektor krahasuar me atë të biznesit të madh, por edhe një sistem pikëzimi dhe rankimi, të zbatueshëm specifikisht për portofolin e SME-ve. Mungesa e informacionit cilësor rreth kompanive, paraqet një kufizim që i detyron bankat të përjashtojnë një pjesë të mirë të kompanive qe nuk i kanë këto të dhëna.

Në praktikë, ndërtimi i një modeli menaxhimi risku për sektorin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme veshtirësohet për shkak të mungesës së të dhënave. Sigurisht, të dhënat e tregut të kapitaleve nuk vlejnë për kompanitë e palistuara në bursë. Gjithashtu një pjesë e madhe e të dhënave që normalisht mblidhen nga koorporatat, janë të paaplikueshme për firmat me përmasa të vogla.

Si rrjedhojë e të dhënave të pakta për shumë kompani jo të listuara në bursë, në rastin e një studimi të kryer për sektorin e Sme-ve në **Norvegji,** studim ky i kryer nga Hol (2007), u arrit në përfundimin se përftohet një model më i mirë parashikimi nëse merren parasysh të dhëna makro ekonomike. Studime të mëvonshme janë kryer nga Peel & Peel (1989) në **Britaninë e Madhe**, vlerësimi u bë me një model multi logit, ku për kompanitë e përzgjedhura një faktor i rëndësishëm për modelimin e menaxhimit të riskut të kredive ishte afati kohor i përfshirë në raportimin financiar. Fantazzini e Figini (2008) përdorën një metodë jo parametrike vlerësimi dhe e krahasuan perfomancën e modelit me metodën standarte logit. Studimet më të fundit kanë theksuar rëndësinë e përfshirjes së variablave cilësore si psh: vitet e jetës së biznesit, tipi i biznesit, sektori industrial etj. Këto elemente cilësorë janë kombinuar me raporte financiare për të dhënë një parashikim më të mirë. Megjithatë, këto studime nuk u fokusuan plotësisht në klientët e segmentit të SME-ve, si dhe një masë e vogël e të dhënave cilësore është analizuar dhe përdorur për qëllime të ndërtimit të modelit të parashikimit të vështirësive financiare.

[7] Altman dhe Sabato (2007), "The value of qualitative information in SMEs risk management"

Ndërkohë në **Shqipëri** një studim të plotë mbi falimentimin, si dhe mbi aspektet juridike dhe ekonomike të tij, është pregatitur nga Dr. Rezarta Perri,[8] ku paraqitet ndërtimi i një modeli të falimentimit për ndërmarrjet me kapital shtetëror, të plotë apo të pjesshëm. Metodologjia e përdorur është analiza diskriminuese nëpërmjet variablave të matur nga pasqyrat financiare të publikuara të shoqërive. Baza e të dhënave përbëhet nga njësi ekonomike me kapital shtetëror të plotë apo të pjesshëm, që kanë operuar në periudhat 1999-2001.

Ky punim, për herë të parë në tregun shqiptar, propozon një studim që fokusohet në matjen e probabilitetit që një kompani e cila përfshihet në sektorin e biznesit të vogël e të mesëm, të kalojë në vështirësi financiare gjatë përiudhës së shlyerjes së kredisë bankare.

1.9 Analiza diskriminuese

Metoda MDA është përdorur në shumë disiplina të ndryshme, që prej aplikimit të parë në vitin 1930. Gjatë asaj periudhe MDA u përdor kryesisht në shkencat e sjelljes dhe shkencat biologjike. Pas viteve 1960, kjo teknikë u përhap gjerësisht në prakikat e bizneseve si dhe në botën akademike.[9] MDA është një teknikë statistikore që përdoret për të parashikuar një vëzhgim në një nga disa grupimet e kryera a priori në varësi të karakteristikave individuale. Ajo është përdorur kryesisht për të klasifikuar dhe për të parashikuar probleme, ku variabli i ndërvarur paraqitet në formë kualitative, për shembull mashkull apo femër, i falimentuar ose jo falimentuar, kështu hapi i parë është që të krijohen klasifikime të qarta të grupeve. Numri i grupeve origjinale mund të jetë dy ose më shumë. Disa analistë i referohen analizës diskriminuese si "shumëfishe ose multiple" vetëm kur numri i tejkalon dy grupe. Pasi krijohen grupet, mblidhen të dhënat për grupet e krijuara. MDA, në formën e vet më të thjeshtuar tenton të ndërtojë një kombinim linear të këtyre karakteristikave që diskriminon ose dallon më së miri grupet midis njëri tjetrit. Nëse një kompani psh, ka karakteristika (raporte financiare) që mund të

[8] Perri R. (2008), "Falimentimi si fenomen i pashmangshëm i tregut (nga këndvështrimi i analizës)".

[9] Altman, Avery, Eisenbeis dhe Sinkey (1981)

jenë të matshme për gjithë kompanitë e të njëjtit gurp, atëherë Teknika MDA përcakton një numër të caktuar koefiçientësh diskriminues.

Teknika MDA paraqet si avantazh faktin se merr në konsideratë gjithë profilin e karakteristikave të përbashkëta të firmave më të rëndësishme, si dhe ndërveprimin e këtyre karakteristikave. Një studim me një variabël, nga ana tjetër, mund të marrë në konsideratë matjet e përdorura për një grup të caktuar një nga një.

Një avantazh tjetër i kësaj metode është se redukton punën e analistit, pasi nga një numër variablash të ndryshëm, ku G është numri i grupeve që janë krijuar fillimisht, arrihet në një numër me G-1 dimensione. Klasifikimi i firmave me karakteristika të ngjashme dhe analiza e parashikimeve, konsiston në ndarjen në dy grupe: të falimentuara dhe jo të falimentuara. Pra, nga kjo rrjedh që analiza shndërrohet në formën e saj më të thjeshtë që është me një dimension. Funksioni diskriminues, i formës Z=V1X1+V2X2...+VnXn, transformohet në vlera të një variabli individual diskriminues, ose ndryshe vlera Z, e cila përdoret për të klasifikuar kompanitë, ku:

V1, V2, ... Vn = koefiçientët diskriminues

X1, X2, ... Xn = variabla të pavarur.

Kur përdoret një listë e caktuar e raporteve financiare për të vlerësuar mundësinë e një kompanie për falimentim, ka arsye për të menduar dhe besuar se disa matje do të kenë shkallë më të lartë korelimi (lidhje) me njëra tjetrën. Në këtë aspekt, është e rëndësishme të bëhet përzgjedhja e mirë e raporteve të duhura.

Pozitiv konsiderohet fakti se arrihet në një model me një numër relativisht të vogël të matjeve të selektuara, të cilat na japin një sasi të madhe informacioni. Ky informacion, mund të tregojë shumë qartë ndryshimet midis grupeve, si dhe çfarë është më e rëndësishmja, cili nga këto ndryshime është më thelbësori.

Teknika MDA analizon njëkohësisht të gjithë variablat diskriminues, ndryshe nga teknika e analizës me anë të raporteve financiare që i analizon individualisht këta variabla. Ashtu si kanë evoluar metodat lineare të programuara për teknikat e buxhetimit të kapitalit, teknika MDA në krahasim me teknikat tradicionale të raporteve, ka avantazhin të riformulojë problemin në mënyre korrekte. Më

specifikisht, kombinimet e raporteve mund të analizohen së bashku, në mënyrë që të evitohen gabimet në klasifikimet e grupimeve të vërejtura në studimet e mëparshme me teknikat tradicionale.

1.10 Manipulimi I fitimeve

Beneish zhvilloi një model probabiliteti për të identifikuar karakteristikat financiare të firmave që kanë gjasa të përfshihen në shifra të manipuluara për deklarimin e fitimeve të tyre.

Ekuacioni 1. Modeli i probabilitetit Benish

$$y = -4.840 + 0.920*(DSRI) + 0.528*(GMI) + 0.404*(AQI) + 0.892*(SGI) + 0.115*(DEPI) - 0.172*(SAI) - 0.327*(LVGI) + 4.670*(TATA)$$

Probit konverton vlerën Y në një vlerë probabiliteti duke përdorur një distribucion standart, me anë të komandes NORMSDIST në Excel, kur aplikohet një vlerë e caktuar e Y. Tetë faktorët e përdorur nga Benish, dhe arsyetimi për përfshirjen e tyre paraqiten në tabelën 3.

Tabela 3. Tabela e faktorëve që ndikojnë në metodën probabilistike Beneish

Index	Shpjegimet
Shitjet ditore në indeksin e llogarive të arkëtueshme (Days Sales in Receivables Index, DSRI)	Një rritje e madhe në llogaritë e arkëtueshme si përqindje mbi shitjet, mund të tregojë një mbivleresim në deklarimin e tyre, me qëllim deklarimin e fitimeve më të larta.
Indeksi i marzhit bruto (Gross Margin Index ,GMI)	Kompanitë me përfitueshmëri më të dobët kanë më shumë mundësi të përfshihen në manipulim shifrash.
Indeksi i cilësisë së aktiveve (Asset Quality Index, AQI)	Një vlerë e lartë në këtë indeks tregon përpjekje për të ndryshuar kostot.

Indeksi i rritjes së shitjeve (Sales Growth Index, SGI)	Nevoja për financim nga jashtë me kosto të ulëta, mund të motivojë manipulim të shitjeve.
Indeksi i amortizimit (Depreciation Index, DEPI)	Duke ngadalësuar raportin e zhvlerësimit, arrihet në deklarim të fitimeve më të larta.
Indeksi i shitjeve dhe shpenzimeve adminsitrative (Selling and Administrative Expense Index, SAI)	≥ 1 tregon shpenzime marketingu në rritje, e për pasojë pritet një fryrje e shifrës së shitjeve.
Indeksi i levës financiare (Leverage Index, LVGI)	Një rritje në raportin e borxhit mund të ketë si pasojë shkeljen e kushteve të kredive.
Totali i llogarive të arkëtueshme mbi totalin e aktiveve (Total Accruals to Total Assets, TATA)	Tregon volumin e fitimeve që rezultojnë nga llogaritë me pagesa të mëvonshme se sa nga shitjet në para.

Burimi: Beneish 1997[10]

1.11 Identifikimi i shkaqeve të dështimit të SME-ve

Studime të ndryshme në industri që analizojnë shkaqet e dështimit të biznesit kanë identifikuar pesë arsye kryesore. Në çdo rast, është e qartë se nuk është një, por kombinimi i disa faktorëvë që çojnë në shkatërrimin e kompanisë. Pesë arsyet kryesore sipas rendit të rëndësisë paraqiten si vijon:

[10] Beneish, M.D. 1997. "Detecting GAAP Violation: Implications for assessing earnings management among firms with extreme financial performance." Journal of Accounting and Public Policy 16(3): 271-309. Beneish, M.D. 1999. "Incentives and Penalties Related to Earnings Overstatements That Violate GAAP." The Accounting Review (4):425-457.

- rënia ciklike e kërkesës;
- niveli i dobët i menaxhimit të lartë;
- mungesa e një kontrolli financiar të centralizuar;
- strategjia e papërshtatshme e shkrirjes;
- produkti/strategjia e tregut e papërshtatshme.

Katër nga këto shkaqe janë të lidhura me menaxhimin, megjithatë, ciklimi ekonomik ka ndikimin e tij mbi të gjitha kompanitë në një kohë të caktuar. Kjo është arsyeja pse parashikimi i rënieve ekonomike merr rëndësi të veçantë, me qëllim që kompania të jetë në gjendje të marrë masat e duhura për të mbrojtur mirë kreditë përpara se të shfaqen këto probleme. Kontratat e kredisë janë një mjet që i mundëson bankave të fuqizojnë pozicionet e tyre negociuese me klientët e mëdhenj. Kontratat e kredisë në përgjithësi përfshijnë raportet dhe kushtet financiare mbi detyrimet dypalëshe, por në mënyrë të veçantë marrëveshja e kredisë mund të detyrojë huamarrësin të paraqesë të dhëna që bankat të mund të monitorojnë librat e blerjeve dhe aktivitetin e llogarive bankare të klientit me qëllim që të përcaktohet nëse një kompani po përballet me ulje të kërkesës për produktet e saj.

1.12 Modeli Altman Z Score

Gjatë dekadës së fundit, shumë nga bankat më të mëdha të botës kanë zhvilluar sisteme të sofistikuara në përpjekje për të krijuar një model për të parashikuar riskun e kredisë që përfshin aspekte të rëndësishme të kredidhënies. Modele të tilla përdoren për të ndihmuar bankat në vlerësimin e riskut në proçesin e kredidhënies duke bërë klasifikimin e binzeseve sipas kriterit gjeografik dhe produkteve, në baza cilësore dhe sasiore. Modelet “Credit Scoring” përdorin të dhëna të vëzhguara nga huamarrësit e përzgjedhur për të llogaritur mundësinë e dështimit apo për fitimit. Një model i njohur i tipit Credit Score është Altman Z Score. Formula për të parashikuar falimentimin e E. Altman (1968)[11] është një formulë me shumë variabla dhe përfaqëson një diagnozë të fuqishme për matjen e gjendjes financiare të

[11] Altman E. (1968), “Financial ratios, discriminant analysis and the predicion of corporate bankruptcy”, The Journal of Finance, Vol. XXIII, No.4.

kompanisë duke parashikuar mundësinë që një kompani të hyjë në fazë falimentimi brenda një viti ose dy, me një saktësi të provuar rreth 75-80%.

Modeli është zhvilluar nga autori më shumë se 30 vjet më parë dhe ende sot është nga modelet më të rëndësishme. Struktura financiare dhe raportet e kompanive të ndryshme variojnë në mënyrë të dukshme nga një shtet apo industri në një tjetër. Për rrjedhojë, përdorimi i këtyre teknikave duhet të marrë në konsideratë këta faktorë, kur të interpretohet. Megjithëse tentohet të rregullohet modeli, me qëllim që të jetë në përputhje me kushtet e veçanta të një shteti të dhënë, kjo mund të ndikojë në saktësinë e parashikimit të modelit.

Raporte të përgjithësuara për llogaritjen e "rezultateve Z" mund të merren nga burime informacioni të tilla si të dhënat financiare të përmbledhura nga institucione të prestigjioze për kompanitë dhe industritë, duke ofruar në këtë mënyrë, një bazë krahasimi për analistin. Përveç parashikimit të falimentimit të kompanisë, teknika të tilla të vlërësimit të kreditit mund të ofrojnë menjëherë informacion efektiv nëse gjendja financiare e përgjithshme e kompanisë po përmirësohet apo përkeqësohet dhe, rrjedhimisht, ku të drejtohet kërkesa.Vlera kryesore e shtuar në modelin e Alman-it nuk janë raportet, por koefiçientët e ponderuar të përdorur. Këta koefiçientë mund të ndryshojnë nga një industri në një tjetër dhe nga një shtet në tjetrin, si dhe nga periudha së cilës i referohet studimi.

Një version më i avancuar i kësaj metode është adaptuar nga një kompani e quajtur Rapide Ratings. Kjo kompani ka përdorur metodën e analizës së raporteve financiare dhe e ka kombinuar atë me vlerësimin e kreditit sipas një metodologjie të pastër mekanike, që gjeneron një vlerësim bazuar vetëm në modelin statistikor të shifrave. Ndërkohë që kjo shmang mosfunksionimet subjektive në një epokë të dhënash kontabël të korruptuara, është e drejtë të vihet në dyshim saktësia dhe lidhja e këtyre modeleve.

Theksi bie mbi modelin Altman Z Score, i cili është shndërruar në një model tipik për vlerësimin e probabilitetit të dështimit. Altman përzgjodhi një listë me 22 variabla (raporte) që klasifikohen në pesë kategori raportesh standarte. Formula e modelit Altman Z Score merr formën e ekuacionit 2:

Ekuacioni2. Modeli Altman Z Score për kompanitë e listuara në bursë

Z = 1.2X1 + 1.4X2 + 3.3X3 + 0.6X4 + 1,0X5

ku

X1 = Kapitali qarkullues / Aktive totale bruto

X2 = Fitime të pashpërndara / Aktive totale bruto

X3 = Fitime para tatimeve dhe interesave (EBIT)/ Aktive totale bruto

X4 = Vlera e tregut e aktiveve / Vlera kontabël e borxhit

X5 = Shitje / Aktive totale bruto

Sa më e lartë është vlera e Z, aq më i ulët është risku i kredimarrësit të përzgjedhur.

Sipas klasifikimit të modelit Altman Z Score, çdo firmë me rezultat formule Z më pak se 1,81 duhet të konsiderohet si në një zonë me risk të lartë falimentimi, midis 1,81-2,99 rezultati konsiderohet në zonën me risk të papërcaktuar (Zone of ignorace), dhe për vlera të Z më të mëdha se 2,99 paraqitet një risk i ulët i dështimit.

1.12.1 Një rishikim i mëtejshëm i modelit Altman për SME-të

Ekspertët bënë një rivlerësim të modelit, duke arritur në vlera të reja të koefiçientëve, të variablave X, pikëve në total të llogaritura nga zbatimi i modelit, si dhe të klasifikimit që i ndante firmat në të suksesshme apo në riskoze**.**

Ekuacioni3. Modeli Altman Z-score për kompanitë private jo të listuara në bursë

$Z' = 0.717X_1 + 0.847X_2 + 3.107X_3 + 0.420X_4 + 0.998X_5$

Ku:

X1 = Kapitali qarkullues / Aktive totale bruto

X2 = Fitime të pashpërndara / Aktive totale bruto

X3 = Fitime para tatimeve dhe interesave (EBIT)/ Aktive totale bruto

X4 = Vlera e tregut e aktiveve / Vlera kontabël e borxhit

X5 = Shitje / Aktive totale bruto

Sipas klasifikimit të modelit Altman Z' Score, çdo firmë me rezultat formule Z' më pak se 1.23 duhet të konsiderohet si në një zonë me risk të lartë falimentimi, midis 1.23-2.9 rezultati konsiderohet në zonën me risk të papërcaktuar (Zone of ignorace), dhe për vlera të Z më të mëdha se 2.9 paraqitet një risk i ulët i dështimit.

Modeli i rishikuar i Altman Z score për firmat private është kryesisht i besueshëm, por krahasuar me modelin origjinal, paraqet pasaktësi të parëndësishme. Kjo për shkak të mungesës së bazës së të dhënave, pasi nuk është testuar mjaftueshëm në bazë të gjerë firmash si në gjendje të mirë, ashtu edhe në vështirësi financiare.

Një tjetër rishikim që i është bërë modelit Altman është adaptimi i modelit për firmat joprodhuese si dhe për tregjet në zhvillim.

Një modifikimi i mëtejshëm i modelit Z-Score, u bë duke analizuar karakteristikat dhe saktësinë e modelit pa elementin X_5 – shitjet / aktivet totale.[12] Ekspertët e bënë këtë me qëllim që të minimizohet efekti i një ndikimi të mundshëm të industrisë, që ndodh kur përfshihet një tregues që bazohet tek raporti i qarkullimit të aktiveve. Në vazhdim, ky model është përdorur për të vlerësuar gjendjen financiare te kompanitë jo amerikane. Në mënyrë të vecantë, autorë si Altman, Hartzell dhe Peck (1995-1997) kanë aplikuar këtë formë të përshtatur të modelit Z-score të quajtur "Z", për të vlerësuar në mënyrë të vecantë kompanitë në tregjet në zhvillim, veçanërisht kompanitë meksikane që kanë emetuar eurobonds në monedhën dollar amerikan. Në rastin e treguesit X4 u përdor vlera e librit për aktivet. Rezultatet e arritura janë identike si modeli me 5 variabla (Z'-Score).

[12] Altman E., (2005), "An emerging market credit scoring system for corporates", Emerging markets review 6 (2005) 311-323.

Kështu, modeli Z" Score është:

Ekuacioni 4. Modeli Altman për tregjet emergjente

$$Z'' = 6.56\ X1 + 3.26\ X2 + 6.72\ X3 + 1.05\ X4$$

Sipas klasifikimit të modelit Altman Z" Score, çdo firmë me rezultat formule Z" më pak se 1.1 duhet të konsiderohet si në një zonë me risk të lartë falimentimi, midis 1.1-2.6 rezultati konsiderohet në zonën me risk të papërcaktuar (Zone of ignorace), dhe për vlera të Z" më të mëdha se 2,6 paraqitet një risk i ulët i dështimit.

Ndër përparësitë e metodës së zhvilluar nga Altman mbështetur mbi metodat MDA përmendim:

- mbështetja jo në një por në disa raporte financiare;
- parashikimi i koefiçentëve të rëndësisë, të përshtatshëm për kombinimin e variablave të veçantë;
- thjeshtësia për t'u zbatuar, pasi fillimisht është zhvilluar modeli fillestar.

Të metat e metodës Altman Z-score, të thekësuara nga kritikët, janë:

- diskriminimi bëhet vetëm ndërmjet tre llojeve të kredimarrësve, me risk falimentimi të lartë, mesatar dhe të ulët;
- nuk ka arsye të dukshme ekonomike të presim që vlerat e peshave në modelin Z-Score apo në modelet e tjera të vlerësimit me pikë, të jenë konstante në periudha gjatë periudhave studimore;

Problemi është se këto modele lënë jashtë përfshirjes faktorë të rëndësishëm por të vështirë për t'u kuantifikuar e për t'u shprehur në terma sasiorë, (si psh faktorët makro ekonomikë) që mund të luajnë një rol vendimtar në vendimet e falimentimit.

1.12.2 Modeli i regresionit logjistik dhe avantazhet e tij në matjen e performancës së SME-ve

Literatura në lidhje me metodologjitë e parashikimit të dështimit është thelbësore për një studim të kësaj fushe. Shumë atutorë në këto 40 vitet e fundit kanë ekzaminuar alternativa të ndryshme të parashikimit të bizneseve të mëdha, të

vogla e të mesme. Për shumë vite, teknika MDA ishte përzgjedhur si teknikë statistikore për t'u aplikuar në modelet e parashikimit të performancës për SME-të. Ajo është përdorur nga shumë autorë[13], të cilët në shumicën e këtyre studimeve të tyre theksonin se shumë shpesh nuk respektoheshin dy supozime bazë të teknikës MDA:

- variablat e pavarur të përfshirë në model janë të shpërndarë në mënyrë normale;
- matricat e dispersionit të grupit janë të njëjta përmes grupeve "kompani me probleme" dhe "kompani të suksesshme".[14]

Për më tepër në modelin MDA, koefiçientët e standartizuar nuk mund të interpretohen si pjerrësi e kurbës së ekuacionit të regresionit, dhe kështu nuk tregojnë rëndësinë e variablave të ndryshëm. Duke marrë në konsideratë këto probleme lidhurme teknikën MDA, Ohlson (1980)[15], për herë të parë, aplikoi modelin e regresionit logjistik për studimin e parashikimit të performancës.

Një avantazh praktik nga përdorimi i metodologjisë së regresionit logjistik është se nuk kërkohet të bazohemi në supozime strikte si metoda MDA si dhe lejon të punojmë me popullatë me numra të ndryshëm ndërmarrjesh, pra jo domosdoshmërisht të jetë i njëjti numër si për firmat me probleme, ashtu dhe për ato të suksesshme..

Metoda ekonometrike e analizës së regresionit logjistik, në studimet e fundit është përzgjedhur pikërisht për të mënjanuar problematikat që shoqërojnë analizën diskriminuese me shumë varialba (MDA). Analiza MDA ka qenë shumë popullore

[13] (Deakin (1972), Edmister (1972), Blum (1974), Eisenbeis (1977), Taffler and Tisshaw (1977), Altman et al. (1977), Micha (1984), Gombola et al. (1987), Lussier (1995).

[14] (Barens (1982), Karels and Prakash (1987)).

[15] Ohlson J., (1080), "Financial Ratios and the Probabilistic Prediction of Bankruptcy", Journal of Accounting Research, Vol. 18, No. 1, pp. 109-131

nga analistët, duke përdorur vektorët e parashikimit. Problemi themelor i parashikimit, mund të reduktohet thjesht në deklarimin e mëposhtëm: meqënëse një firmë i takon një popullate të specifikuar më parë, cili është probabiliteti që firma të falimentojë brenda një periudhe të paracaktuar? Asnjë supozim nuk duhet bërë përsa i përket probabiliteteve të falimentimit, si dhe distribucionit të faktorëve parashikues. Domethënia statistikore e faktorëve të përdorur për parashikimin përftohet nga teoria bazuar në një popullatë me numër të madh. Për të qenë të sigurtë, si në çdo analizë parametrike, një model duhet specifikuar, por mund të ketë gjithmonë vend për një specifikim të gabuar, dhe gjithashtu është e mundur të testohet për keqspecifikimet.

Nga një këndvështrim statistikor, regresioni logjistik duket se përshtatet mirë me karakteristikat e problemit të parashikimit, ku variabli i varur merr vlera binare. (psh sukses apo dështim) dhe me grupet që janë formuar në mënyrë diskrete, jo të mbivendosura si dhe të identifikueshme. Modeli i regresionit logjistik na jep një rezultat me vlerë midis 0 dhe 1, vlerë kjo që përfaqëson probabilitetin e dështimit për një firmë.

Zmijewski (1984) ka qenë i pari që ka praktikuar analizën probit për të parashikuar dështimin, por deri tani analiza loigit ka dhënë rezultate më të mira në këtë fushë. Së fundmi, koefiçentët e vlerësuar mund të interpretohen në mënyrë të veçantë, si rëndësia ose domethënia e secilit nga variablat e pavarur, në shpjegimin e probabilitetit të dështimit.[16] Pas studimit të Ohlson (1980), shumica e studiuesve të literaturës akademike[17], kanë përdour modelin logjistik për të parashikuar performancën.

Pavarësisht diferencave teorike midis dy metodave, MDA dhe Logit, (Lo, 1985) studimet tregojnë se rezultatet empirike janë thuajse të njëjta në këndvështrimin e klasifikimit. Në fakt, pas një analize të kujdesshme të natyrës së problemeve dhe të

[16] Zmijewski, M.E. (1984), "Methodological issues related to the estimation of financial distress prediction models", Journal of Accounting Research, 22, Supplement, 59-82.

[17] (Zavgren 1983), Gentry et al. (1985), Keasey dhe Watson (1987), Aziz et al.(1988), Platt dhe Platt (1990), Ooge et al. (1995), Mossman et al. (1998), Beccheti dhe Sierra (2002)

qëllimit të këtij studimi, u përzgjodh të ndiqet metoda e regresionit logjistik si teknika më e përshtatshme statistikore për të parashikuar performancën e SME-ve që i janë drejtuar sektorit bankar për financim.

KAPITULLI II - KLIMA E SEKTORIT TË SME-VE NË SHQIPËRI

Çështjet ekonomike janë të rëndësishme për të gjithë shqiptarët, të cilët janë të ndërgjegjshëm për këto probleme të mëdha me të cilat është ndeshur ekonomia jonë dhe si rezultat i presioneve nga jashtë, nga kriza financiare në Eurozonë dhe në Bashkimin Evropian, apo nga situata kritike e partnerëve tanë kryesore ekonomikë dhe tregtarë, siç janë Greqia dhe Italia.

Ekonomia shqiptare karakterizohet nga një nivel i ulët kreditimi i shkaktuar nga:

- rënia e kërkesës për kredi;
- shtrëngimi i kritereve për kredidhënie;
- rritja e ulët ekonomike;
- konsumi i ulët i produkteve;
- mungesa e shfrytëzimit të kapaciteteve ekonomike e prodhuese.

Norma bazë e interesit të Lekut, për periudhën Mars 2014 është në nivelet më të ulëta historike prej 2.7%.

Problemi i korrupsionit, sjellja arbitrare e tatimeve, zvarritja pafund e rimbursimit, problemi i lejeve të ndërtimit sidomos përsa i përket bregdetit, janë çështje që merren në konsideratë për një vlerësim të klimës së biznesit në Shqipëri. Shpejtësia në plotësimin e kërkesave të biznesit vendas e të huaj për investime, do të jetë përcaktuese për zhvillimin ekonomik të vendit. Problemet më urgjente lidhen me zbatimin e ligjeve, zhvillimin e infrastrukturës, furnizimin me energji elektrike, përmirësimin e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, largimin dhe trajtimin e mbetjeve si dhe investimet në arsimin profesional, marrjen e kredisë, mbrojtjen e investitorëve, pagimin e taksave, zbatimin e kontratave dhe zgjidhjen e paaftësisë paguese. Përmirësimi në sektorin e arsimit profesional mundëson vende pune për persona që kanë kualifikim të ulët. Faktorët që kanë ulur vlerësimet për vendin tonë si destinacion investimesh janë faktori i korrupsionit dhe kriminalitetit, si dhe paparashikueshmëria e politikave fiskale.

Grafiku 1. Renditja e ekonomisë Shqiptare në krahasim me ato të Evropës



Burimi: Doing business Albania, 2014[18]

Të dhënat makro-ekonomike për vitin 2013 tregojnë se Kina është shndërruar në partnerin e tretë tregtar në vendin tonë, ndërkohë që shkëmbimet tregtare me bashkimin evropian kanë rënë. Kështu, partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia me 40,7% të shkëmbimeve tregtare, Greqia me 6,9% të totalit, Kina me 6,4% dhe Turqia me 5,7% të totalit të tregtisë. Ndërsa shkëmbimet tregtare me Bashkimin Evropian kanë zbritur në 66.6% të tregtisë nga rreth 68% që kanë qenë më përpara.

Përsa i përket bilancit tregtar të vendit ai është përkeqësuar në 2014. Në muajin shkurt, defiçiti tregtar arriti në 19 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 7.2% kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe rritje 10% kundrejt muajit të mëparshëm. Kjo për shkak të volumit më të madh të rritjes së importeve kundrejt eksporteve. Kështu në shkurt eksportet arritën vlerën e 20 miliardë lekë me rritje

[18] World Bank, (2014), "Doing business 2014, comparing business regulations for domestic firms in 189 economies", 11th edition.

27.8% kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, ndërsa importet vlerësohen në 39 miliardë lekë me rritje 17% kundrejt shkurtit të vitit të kaluar.

Në vitin 2013, eksportet u udhëhoqën nga grupi i "mineraleve, lëndëve djegëse dhe energjisë", në muajt e parë të 2014-s janë tekstilet e këpucët ato që po kryesojnë rritjen, ndërkohë që ecuri e mirë shënohet dhe për shitjet jashtë vendit të produkteve ushqimore, apo lëndës së drurit dhe letrës, megjithëse pesha e tyre në raport me totalin mbetet shumë e ulët.

2.1 Karakteristikat dhe rëndësia ekonomike e SME-ve në Shqipëri dhe botë.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të) përbëjnë motorin e ekonomisë Evropiane dhe Shqiptare. Ato janë një burim i rëndësishëm punësimi, sipërmarrjeje dhe inovacioni duke u bërë kështu nxitëset kryesore të konkurrencës dhe të punësimit.Përkufizimi i SME-ve[19], I cili hyri në fuqi më 1 janar 2005, përbën një lëvizje cilësore drejt një klime më të mirë biznesi për SME-të dhe ka si qëllim promovimin e sipërmarrjes, investimit dhe rritjes ekonomike.

Në kuadrin e 25 shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, rreth 23 milion SME kanë krijuar rreth 75 milion vende pune dhe përfaqësojnë 99% të të gjitha sipërmarrjeve. Megjithëse të shumta në numër, kjo kategori biznesesh përballet me vështirësitë e tregut. SME-të shpesh kanë vështirësi në sigurimin e kapitalit ose kreditit, sidomos në fazën e fillimit të operimit në treg. Burimet e tyre të kufizuara mund të reduktojnë gjithashtu përafrimin me teknologjitë e reja dhe inovacionet. Kështu që, mbështetja e SME-ve është një nga hapat e domosdoshëm për rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomiko-social.

Në Shqipëri, deri vonë nuk ka pasur një përcaktim të qartë mbi mikrondërmarrjet. Madje, ndryshe nga shumë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore të cilat kishin një aktivitet të qëndrueshëm të sektorit privat, në Shqipëri para viteve '90 nuk ekzistonte

[19] Përkufizimi kombëtar i SME-ve jepet në ligjin Nr. 10042, datë 22.12.2008, "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin Nr. 8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar", fletore zyrtare 199, datë 14.01.2009.

asnjë shenjë e këtij sektori sepse ishte i ndaluar me ligj. Lindja dhe zhvillimi i sektorit privat në Shqipëri ndodhi me shembjen e sistemit të ekonomisë së centralizuar dhe me hapjen e dyerve ndaj ekonomisë së tregut. Në këtë periudhë zhvillim të veçantë patën ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme, të cilat në historinë njëzetvjeçare të tranzicionit ekonomik që ka përjetuar vendi ynë, kanë luajtur një rol vendimtar në zhvillimin ekonomik të vendit.

Numri i përgjithshëm i kompanive private që operonin në vitin 2012 ishte 80.722, shifër kjo 2.9% më e lartë krahasuar me një vit më parë. Ndërmarrjet aktive në sektorin e tregtisë përbënin 46.8% të të gjithë aktivitetit ekonomik, ndërsa ndërmarrjet me 1-4 të punësuar ishin ato që mbizotëronin me 91%.

Zhvillimi i sektorit të SME-ve është konsideruar si instrumenti më efiçient për ekonomitë në tranzicion, i cili gjeneron rritje ekonomike të qëndrueshme, punësim dhe reduktim të varfërisë. Rëndësia strategjike e tij është e njohur gjerësisht. Sektori i tregtisë (përfshirë tregtinë e automjeteve, me shumicë dhe tregtinë me pakicë) gjatë 2012 ka kontribuar me 48.9% në realizimin e xhiros totale të të gjitha ndërmarrjeve së bashku. Ky sektor ka angazhuar 27.6% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve. Në sektorin e tregtisë investimet janë vetëm 16% e vlerës së përgjithshme të investimeve të bëra në të gjitha aktivitetet ekonomike.

Grafiku 2. SME-të sipas qarqeve 2013



Burimi: Instat, Regjistri statistikor i ndërmarrjeve 2013.

Nga këndvështrimi sektorial, sistemi i SME-ve përbëhet 84.42% nga ofrues shërbimesh (tregti, hotele, bare, restorante, transport dhe telekomunikacion, shërbime të tjera) dhe vetëm 15.18% nga prodhues (bujqësi, peshkim, industri, ndërtim). Ndërmarrjet private kanë filluar të themelohen pas vitit 1990, ndërkaq rritje të theksuar në themelimin e SME-ve shënohet në vitet 2005-2009. Pas kësaj periudhe, themelimi i tyre fillon të shënojë rënie të ndjeshme[20]. Pjesa që zënë mikrondërmarrjet në totalin e ndërmarrjeve është rreth 96,2%, duke qenë më e madhe se mesatarja e Bashkimit Evropian (92%).

Qarku i Tiranës, Shqipëria qëndrore dhe zonat bregdetare karakterizohen nga një prani e madhe e SME-ve. Rreth 50.35% e ndërmarrjeve gjenden në korridorin Tiranë-Durrës, që po zhvillohet si një zonë e rëndësishme ekonomike. Zona të tjera me një prani të lartë të SME-ve janë rrethet e Fierit, Vlorës, Korçës, ku vepron 24.62% e ndërmarrjeve.

Grafiku 3. Shpërndarja gjeografike e SME-ve të marra në studim



Burimi: Autori

Në literaturat ekonomike të shteteve të zhvilluara veçohen disa faktorë të kontributit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në ekonominë e tregut.

[20] Studim i World Bank,"Doing business in 2012".

Këta faktorë janë si më poshtë:

- Fleksibiliteti, ka të bëjë me përshtatjen e aktivitetit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme në varësi të ndryshimeve të kushteve të tregut dhe të adoptimit të shpejtë me këto ndryshime. SME-të njihen për aftësinë e tyre për të ndryshuar rezultatin më shpejt dhe pa pasoja të mëdha, kjo në varësi të ndryshimeve të mjedisit ku ato operojnë.
- Gjenerimi i punëve të reja. SME-të kontribuojnë në rritjen e punësimit në vend në një masë më të madhe se sa nivlet e tjera të biznesit. Gjithashtu në vendet në zhvillim, siç është edhe Shqipëria, SME-të në një periudhë afatgjatë mund të sigurojnë pjesën më të madhe të punësimit.
- SME-të përbëjnë bazën e ekonomisë. Sektori i SME-ve ka një kontribut të patjetërsueshëm në proçesin e zhvillimit ekonomik të një vendi. SME-të janë motori i ekonomisë, burim i rëndësishëm punësimi dhe një faktor i rëndësishëm për rritjen industriale. Ato janë faktor kyç i krijimit të shpirtit sipërmarrës dhe novacioneve, duke u shndërruar kështu në një element të rëndësishëm të konkurrencës dhe të zhvillimit ekonomik lokal.

2.2 Ndikimet e zhvillimeve ekonomiko-politike në aktivitetin e biznesit të vogël e të mesëm shqiptar.

Zgjedhjet e 23 qershorit 2014, nxorën fitues, me një diferencë të madhe, koalicionin e udhëhequr nga Partia Socialiste; koalicioni i ri qeverisës tani ka 84 votat e nevojshme për të kaluar legjislacion me shumicë të cilësuar prej tri të pestash. Kalimi i pushtetit që pasoi zgjedhjet, ishte relativisht i qetë. Qeveria e re mori detyrën më 15 shtator, me një axhendë ambicioze. Megjithëkëtë, Shqipëria po përballet me sfida të konsiderueshme, të cilat duhen trajtuar në një mënyrë të pjekur dhe gjithëpërfshirëse. Prezenca dhe bashkësia ndërkombëtare më gjerë kanë vijuar t'u theksojnë të gjitha palëve nevojën për t'u angazhuar plotësisht në institucionet demokratike të vendit. Klasa politike shqiptare duhet të përqafojë një stil të freskët politik për të përballuar sfidat thelbësore dhe për të përmbushur aspiratat e qytetarëve të saj.

Viti 2012 ka qenë një kohë zhvillimesh domethënëse në Shqipëri. Në fund të nëntorit, Shqipëria festoi 100 vjet pavarësi. Festimet ishin, gjithsesi, një çast i rrallë bashkues. Përparimi në axhendën e reformave ngeci, ndërsa armiqësia dhe polarizimi politik u rritën vazhdimisht me afrimin e zgjedhjeve parlamentare të 23 qershorit. Miratimi, në maj 2013, i dy ligjeve me shumicë të cilësuar, konkretisht i ligjit për Gjykatën e Lartë dhe atij për nëpunësin civil, si dhe i rregullores së Kuvendit, përmes bashkimit të votave të shumicës qeverisëse dhe opozitës, ishte një përjashtim për t'u shënuar.

Kjo klimë politike kontribuoi në vendimin për dhënien e statusit kandidat Shqipërisë, me mirëkuptimin që Shqipëria të vazhdojë të marrë masa në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Një dialog konstruktiv dhe i qëndrueshëm mes qeverisë dhe opozitës për reformat përkatëse do të jetë jetësor për përparim, sikurse edhe angazhimi konstruktiv në bashkëpunimin rajonal. Identifikohen pesë fusha përparësie kyçe, të cilat Shqipëria duhet t'i përmbushë për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit, konkretisht:

- të vijojë reformën në administratën publike;
- të forcojë pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore;
- të bëjë përpjekje të mëtejshme të vendosura në luftën kundër korrupsionit, përfshirë drejt vendosjes së një bilanci solid;
- të bëjë përpjekje të mëtejshme të vendosura në luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë drejt vendosjes së një bilanci solid;
- dhe të forcojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë të romëve, dhe politikat kundër diskriminimit, si dhe të zbatojë të drejtën e pronës.

2.3 Reforma e pronës

Reforma e pronës mbetet për Shqipërinë një çështje thelbësore, nga e cila kushtëzohet zhvillimi në fusha të tjera. Mungesa e një kuadri të qëndrueshëm politikash ka sjellë një pasiguri ligjore sa u përket të drejtave të pronarëve, shtimit të ndërtimeve të paligjshme dhe zhvillimit të parregulluar të tregut të pronave të paluajtshme, me pasoja negative për gëzimin e papenguar të së drejtës së pronës dhe

zhvillimin ekonomik të vendit. Reforma e pronës ka ngecur në pjesën më të madhe të vitit 2012. Qeveria e re e ka shpallur zgjidhjen e situatës me pronat si një nga përparësitë e saj kryesore dhe është zotuar që do të ndjekë një qasje të konsoliduar. Konsensusi kombëtar dhe qëndrueshmëria e kuadrit institucional dhe ligjor janë të domosdoshëm për suksesin e kësaj reforme. Në luftën kundër korrupsionit, me gjithë angazhimin e qeverive të njëpasnjëshme dhe reformën ligjore përgjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, perceptimi i korrupsionit në terren është rritur. Gjatë vitit të shkuar u vërejt përgjithësisht një përparim i kufizuar në çështjet kundër korrupsionit. Në një hap për t'u përshëndetur, Kuvendi miratoi, në shtator 2012, një paketë ndryshimesh kushtetuese që kufizon imunitetin e përgjithshëm nga ndjekja penale të deputetëve, gjyqtarëve dhe zyrtarëve të tjerë të lartë.

Megjithëse ndryshimet e miratuara nga Kuvendi shmangën një pengesë të madhe për hetimin e rasteve të supozuara të korrupsionit, procedurat hetimore ende kërkojnë qartësim. Sfida mbetet për t'i shndërruar angazhimet në zbatim efektiv, me nivelin e duhur të transparencës dhe llogaridhënies dhe një bilanc bindës, përfshirë proçedime të nivelit të lartë.

Organet shtetërore që merren me korrupsionin nuk janë ende plotësisht të mbrojtura nga presioni politik dhe vuajnë nga kufizimi i burimeve njerëzore dhe financiare. Autoritetet kombëtare që të zhvillojnë një kuadër institucional më efektiv për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin dhe pastrimin e parave. Ka pasur përmirësime në komunikimin dhe bashkëpunimin mes institucioneve qendrore, si dhe një shtim të numrit të rasteve të denoncuara në prokurori, megjithëse rezultatet mbeten për t'u parë. Në bashkëpunim me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP) dhe Institutin e Trajnimit të Administratës Publike, mbi 200 zyrtarë publikë dhe të zgjedhur vendorë u trajnuan për etikën, konfliktin e interesit dhe antikorrupsionin për të siguruar një zbatim efektiv të masave dhe mekanizmave kundër korrupsionit.

2.4 Mbrojtja e investitorëve

Mbrojtja e investitorëve ka rëndesi për aftësinë e kompanive për të siguruar kapitalin e nevojshëm që të rriten, të diversifikohen, të realizojne inovacione dhe të

konkurrojnë. Në qoftë se ligjet nuk mbrojnë edhe aksionerët që janë në minoritet, investitorët mund të ngurrojnë për të investuar fonde për kompanitë nëpërmjet blerjes së aksioneve, përveç nëse ata bëhen aksionerët kontrollues ose aksionerë kryesorë. Rregulloret efektive përcaktojnë saktësisht transaksionet e palëve të ndërlidhura dhe vendosin standarde të hollësishme të përgjegjësisë brenda kompanive.

Të mbrosh investitorët do të thotë të matësh fuqinë e aksionerëve në minorancë për t'u mbrojtur kundër përdorimit të aseteve të korporatës nga ana e drejtorëve për përfitime personale. Dallohen 3 pika kyçe në mbrojtjen e investitorëve:

- transparenca e transaksioneve të palëve të lidhura (shkalla e indeksit të publikimit);
- besnikëria e drejtuesve (shkalla e indeksit të besnikërise së drejtuesve);
- lehtësia e sigurimit të informacionit gjatë ushtrimit të aktivitetit ekonomik.

Grafiku 4. Renditja e shteteve në lidhje me indeksin e mbrojtjes së investitorëve



Burimi: Doing business Albania 2014

Globalisht, Shqipëria vlerësohet me një vlerë prej 14 pikësh në renditjen prej 189 pikësh, përsa i përket indeksit të mbrojtjes së investitorëve. Një renditje me vlerë më e lartë tregon se rregullat e një ekonomie të caktuar ofrojnë mbrojtjen më të fortë për investitorët e atij vendi.

2.5 Proçesi i kredimarrjes nga ana e SME-ve

Dy tipe kuadri ligjor mund të lehtësojnë qasjen në proçesin e kredidhënies dhe të përmirësojnë shpërndarjen më të mirë të saj:

- sistemi i informacionit të kredive;
- sistemi i informacionit të kolateraleve e ligjeve të falimentimit.

Sistemet e informacionit të kreditit garantojnë të drejtën e huadhënësve për të parë historinë financiare huamarrësve potencialë (pozitiv ose negativ), e domosdoshme kjo që palët të mund të vlerësojnë riskun e kredisë. Ligjet për sigurimin e informacionit mbi kolateralin, i lehtësojnë bizneseve përdorimin e pasurive të tyre, sidomos të pasurisë së luajtshme, si garanci për të gjeneruar kapital. Vihet re se, sa më të forta të jenë ligjet që sigurojnë informacion mbi kolateralin, aq me i madh do të jete raporti i kredisë për biznesin privat kundrejt PBB-së.

Grafiku 5. Renditja e shteteve në lidhje me lehtësinë e kredidhënies



Burimi: Doing business Albania 2014

Në grafikun 5, vlera më të larta përfaqësojnë më tepër informacion dhe të drejta më të forta ligjore për mbrojtjen e kredidhënësit dhe kredimarrësit Globalisht Shqipëria vlerësohet me 13 pikë, në një radhitje botërore prej 189 pikësh, në lidhje me lehtësinë e kredidhënies.

2.6 Trajtimi fiskal i SME-ve

Tatimet janë thelbësore në zhvillimin e një ekonomie dhe përbëjnë themelet e financimit të shërbimeve dhe lehtësive publike, infrastrukturës dhe çdo aktiviteti të rëndësishëm për një ekonomi që funksionon siç duhet. Por niveli i normave tatimore duhet të zgjidhet me kujdes, dhe kompleksiteti i panevojshëm në rregullat tatimore duhet shmangur. Në vendet ku pagesa e taksave është më e vështirë dhe e kushtueshme, një pjesë e madhe e aktivitetit ekonomik përfundon në sektorin informal, ku bizneset nuk paguajnë asnjë taksë. Për një SME, kemi parasysh këtu taksat dhe kontributet e detyrueshme që duhen paguar në një vit të caktuar, si dhe barrën administrative nga pagesa e taksave dhe kontributeve. Globalisht, Shqipëria renditet e 146-a nga numri total prej 189 ekonomi te marra në studim për lehtësinë e pagimit të taksave. Renditja në lehtësinë e pagimit të taksave është bazuar në: numrin e pagesave vjetore, kohën dhe normën totale tatimore.

Në mbarë botën janë krijuar mundësitë për të kryer më shpejt dhe më lehtë pagesën e taksave nga ana e bizneseve. Kjo është arrtiur duke konsoliduar informacionin, duke ulur frekuencën e pagesave ose duke ofruar deklarimin dhe pagesën elektronike. Ndryshimet kanë sjellë rezultate konkrete, pasi në disa ekonomi thjeshtimi në sistemin e pagesave të taksave dhe reduktimi i normave të tyre, kanë sjellë rritje të të ardhurave tatimore[21].

[21] Fondi Monetar Ndërkombëtar, "Raporti i Stabilitetit financiar global", tetor 2013.

Tabela 4. Lehtësimi i pagesës së taksave në Shqipëri

VITI	**REFORMA**
2009	Reduktimi i tatimit mbi fitimin nga 20% në 10% efektive prej 01.01.2008
2010	Asnjë reformë nuk është ndërmarrë
2011	Me miratimin e disa ligjeve, proçedura e pagesës së taksave në Shqipëri u bë më e lehtë dhe më pak e kushtueshme, u reduktua shuma e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe u aplikua pagesa dhe deklarimi elektronik.
2012	Asnjë reformë nuk është ndërmarrë.
2013	Shqipëria lehtësoi pagesën e taksave duke shkrirë taksën e automjeteve dhe inkurajoi deklarimin dhe pagesën elektronike të taksave.
2014	Shqipëria vijoi lehtësimin në pagesën e taksave duke lejuar pagesën e taksës së biznesit të madh katër herë në vit.

Burimi: Doing business Albania 2013

2.7 Importet dhe eksportet – Tregtia e jashtme

Në botën e sotme të globalizuar, është gjithnjë e më e rëndësishme për biznesin që shkëmbimet ekonomike midis bizneseve të bëhen më të lehta. Kërkesat e tepërta të dokumentacioneve, procedura të ngarkuara doganore, operacionet joefikase në porte dhe infrastruktura e papërshtatshme, të gjitha çojnë në shpenzime shtesë, vonesa si dhe ulje të potencialit ekonomik të tregtisë. Hulumtimet tregojnë se eksportuesit në vendet në zhvillim fitojnë më shumë nga një rënie 10 % në shpenzimet e tyre të eksportit, se sa nga reduktime të ngjashme të çmimeve të produkteve të tyre në tregjet botërore. Treguesit mbulojnë kërkesat procedurale siç janë kërkesat dhe procedurat e dokumentacionit në dogana dhe agjencitë e tjera rregullatore: dokumente, koha dhe kosto për eksportin dhe importin.

Në ekonomitë përtej kufijve, qeveritë kanë bërë më të shpejtë dhe më të lehtë procedurat doganore gjatë viteve. Janë futur mjetet për të lehtësuar tregtinë, duke shpenzuar për implementimin e sistemeve elektronike të të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit. Këto ndryshime ndihmojnë në përmirësimin e mjedisit tregtar dhe në rritjen e konkurrencës ndërkombëtare të firmave. Në Shqipëri, në vitin 2010, u vu në zbatim sistemi botëror ASYCUDA si dhe u investua në blerjen e pajisjeve për skanim dokumentacionesh, fakt ky që solli uljen e kohës së procedurave doganore në vendin tonë. Prej asaj kohe, ende nuk është ndërmarrë ndonjë hap i rëndësishëm për përmirësimin e parametrave në lidhje me kohën, koston dhe dokumentat e nevojshme për procedurat doganore.

2.8 Marrëdhëniet kontraktuale

Gjykatat janë thelbësore për sipërmarrësit për shkak se këto insitucione interpretojnë rregullat e tregut dhe realizojnë mbrojtjen e të drejtave ekonomike. Gjykatat efikase dhe transparente motivojnë marrëdhënie të reja biznesi, sepse bizneset e dinë se mund të mbështeten në gjykatat në qoftë se një klient i ri apo ekzistues nuk paguan. Gjykimet e shpejta janë thelbësore për bizneset, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla, të cilat mund të gjenden para vështirësive të mungesës së likuiditetit, ndërsa presin një kohë të gjatë rezultatin e një mosmarrëveshje gjyqësore.

Efikasiteti i sistemit gjyqësor në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare para gjykatave vendore matet mbi bazën e të dhënave në lidhje me kohën, koston dhe kompleksitetin procedural të zgjidhjes së një padie.

2.9 Falimentimi i SME-ve

Procedura të shpejta dhe pa kosto të larta në lidhje me falimentimin do të sjellin

një kthim të shpejtë të detyrimeve ndaj kreditorëve. Duke përmirësuar pritshmëritë e kreditorëve dhe debitorëve në lidhje me rezultatin e procedurave të falimentimit, sistemet ligjore të falimentimit që funksionojnë mirë, mund të lehtësojnë qasjen në financa, për të shpëtuar bizneset më të qëndrueshme dhe në këtë mënyrë të përmirësojë rritjen dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë në përgjithësi.

Koha e shpejtë, kosto e ulët dhe vazhdimi i bizneseve të qëndrueshme karakterizojnë ekonomitë me performancë të lartë. Globalisht, Shqipëria renditet me 62 pikë, krahasuar me renditjen e 189 pikëve që i takojnë vendeve më të zhvilluara në lidhje me lehtësinë e zgjidhjes së falimentimit.

Grafiku 6. Renditja e shteteve në lidhje me lehtësinë e zgjidhjes së falimentimit



Burimi: Doing business Albania 2014

Një kuadër ligjor i mirë-balancuar i falimentimit dallon kompanitë që janë në gjendje të vështirë financiare, por ekonomikisht të qëndrueshme, nga kompanitë joefikase që duhen likuiduar. Por ka raste që në disa sisteme ligjore të falimentimit, edhe bizneset e qëndrueshme janë likuiduar. Në shumë vende kjo proçedurë ka filluar të ndryshojë, pasi shumë nga reformat e fundit të ligjeve të falimentimit kanë për qëllim të ndihmojnë bizneset e qëndrueshme të mbijetojnë.

Gjate vitit 2010, Ligji i ri falimentimit në Shqipëri ka prezantuar afate kohore ligjore për procedurat e falimentimit, kualifikimet profesionale të specifikuara për administratorët e falimentimit, dhe ka vendosur krijimin e një institucioni të quajtur "Agjencia e Mbikëqyrjes" për rregullimin e profesionit të administratorëve të

falimentimit. Po ashtu, për bizneset e vogla e të mesme, është prezantuar një procedurë e thjeshtëzuar e falimentimit.

2.10 Infrastruktura rrugore

Në Shqipëri është bërë përparim i rëndësishëm në rindërtimin e rrjeteve rrugore edhe pse sektori kërkon investime të mëtejshme. Pritet të vazhdojë ky procçes investimi në infrastrukturën kyçe për të dhënë një ndikim pozitiv në ekonomi. Operatorët privatë janë të përfshirë në Porto Romano dhe në Vlorë, të cilat janë zhvilluar si terminale të importit të karburantit. Ofrimi i shërbimeve efikase komunale (transportit, të mbeturinave dhe ujit) varet nga reforma të rëndësishme, duke përfshirë rritjen e tarifave, komercializimin dhe kuadrin rregullator të përkatës. Së fundi , autoritetet e qytetit Tiranës po merren me planifikimin e investimeve në rrjetin rrugor primar, për të përmirësuar qarkullimin dhe të qetësojnë trafikun e ngjeshur në qendër të qytetit.

Gjatë dekadës së fundit Shqipëria ka qenë një prej ekonomive me rritjen më të shpejtë në Evropë, duke gëzuar norma reale rritjeje vjetore prej 6%, shoqëruar nga reduktimi i shpejtë i varfërisë. Ndërmjet viteve 2002 dhe 2008, varfëria në vend u përgjysmua (në rreth 12.4%) dhe varfëria ekstreme tashmë prek më pak se 2% të popullsisë. Nga viti 2007 në vitin 2012, ekonomia shqiptare u rrit me 22%, ndërkohë që eksportet u dyfishuan në periudhën 2009-2011.

2.11 Remitancat dhe ndikimi tek aktiviteti i SME-ve

Remitancat janë një faktor shumë i rëndësishëm i të ardhurave familiare, të cilat përveç shpenzimit për konsum, kanë shkuar dhe për investime në sektorin e SME-ve. Remitancat kanë rënë edhe më tej gjatë vitit 2013 për shkak të zhvillimeve të fundit në shtetet e rajonit të eruozonës. Për këtë arsye, konsumi dhe investimet private kanë pësuar rënie.

Remitancat janë flukse hyrëse dhe dalëse pa kundërshpërblim për/nga jashtë vendit. Në rastin e vlerave hyrëse kemi të bëjmë kryesisht me dërgesa të emigrantëve drejt Shqipërisë. Në rastin e flukseve dalëse janë para që shtetas të huaj, të cilët kanë

punuar në Republikën e Shqipërisë, kanë transferuar drejt shteteve ku ata janë rezidentë të përhershëm.

Vendet kryesore nga ku e kanë origjinën dërgesat e emigrantëve shqiptarë janë Greqia, Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Maqedonia, Gjermania dhe Kanadaja. Këto gjashtë vende kanë peshën kryesore të remitancave me Shqipërinë duke qenë se përbëjnë 98% të totalit. Vendet e tjera përbëjnë një përqindje shumë të ulët, vetëm 2% të totalit.

Greqia dhe Italia janë dy vende kryesore ku shtetas shqiptarë kanë emigruar dhe punojnë e jetojnë. Greqia është vendi me vlerat më të larta të remitancave hyrëse. Vlera e dërgesave shënon afro 300 milionë Euro dhe përbën 47% të totalit. Pas Greqisë vlerën më të lartë të dërgesave të emigrantëve drejt Shqipërisë e shënon Italia me afro 248 milionë Euro dërgesa.

2.12 Investimet e huaja direkte

Investimet e huaja direkte dhe remitancat janë tregues të flukseve hyrëse të bilancit të pagesave dhe janë dy tregues të rëndësishëm për rritjen e ekonomive kombëtare. Investimet e huaja direkte, përfshijnë investimet e individëve dhe institucioneve të huaja në ekonominë vendase, nëse investimi e bën investitorin pronar të më shumë se 10% të kapitalit të një ndërmarrje.

Në një hark më të gjatë kohor prej dhjetë vitesh 2002-2013, raporti i këtyre dy vlerave paraqitet tepër interesant. Në vitin 2010 remitancat shënojnë 690 milion euro ndërsa IHD janë në vlerën 789 milion euro, dhe ky është viti i parë kur remitancat bien nën vlerën e investimeve të huaja direkte. Diferenca është zvogëluar në vitet pasardhëse 2010-2013. Në fund të vitit 2013, investimet e huaja direkte shënuan vlerën maksimale të 10 viteve të fundit, duke arritur në 923 milionë euro. Rritja shënon një kthesë pozitive për IHD pas rënies së vazhdueshme në vitet e fundit.

Rritja e shpejtë e investimeve gjatë 2013 ka ardhur si pasojë e disa privatizimeve të realizuara në pjesën e parë të vitit, ku dominon blerja e dy hidrocentraleve nga kompania turke e përpunimit të hekurit, Kurum. Fatura e këtij privatizimi shënonte 110 milionë euro. Nga ana tjetër, dërgesat e emigrantëve ose remitancat kanë zbritur

me shpejtësi. Gjatë 2013-ës, remitancat u ulën në 500 milionë euro, duke shënuar vlerën më të ulët të 10-viteve të fundit. Kjo konfirmon rënien e kontributit të

dërgesave të emigrantëve në ekonominë vendase, në kushtet kur kriza ekonomike në Evropë, ka ulur ndjeshëm të ardhurat e tyre[22].

Grafiku 7. Remitancat dhe investimet e huaja direkte në milionë Euro 2002-2013.



Burimi: Open Data Albania

2.13 Borxhi publik

Duke analizuar ndryshimet në këtë tregues për periudhën 2010-2013, vërejmë se borxhi është rritur nga viti në vit. Rritjet më të mëdha kanë qenë në dy vitet e fundit: në vitin 2013 dhe parashikimi për vitin 2014. Për vitin 2013, borxhi për frymë arrin në 326,999 lekë ose 11.6 % më e lartë se në vitin 2012. Në vitin 2014, ky borxh pritet të arrijë vlerën prej 370,224 lekë, e cila është 13.22 % më e lartë se një vit më parë. Borxhi për frymë llogaritet duke pjesëtuar shumën totale të borxhit të papaguar në një vit të veçantë me popullsinë e regjistruar në atë vit. Me fjalë të tjera, kjo tregon mesatarisht se ç'pjesë të borxhit publik duhet të paguajë çdo qytetar shqiptar.

[22] Open Data Albania, Remitancat dhe investimet e huaja 2002-2013.

Ndryshimet në borxh për frymë janë të prekur nga borxhi dhe numri i popullsisë. Ekspertët thonë se është pikërisht rritja e borxhit, faktori dominues që shpjegon rritjen e borxhit për frymë nga një vit në tjetrin. Megjithatë, tkurrja e popullsisë ka çuar edhe në një rritje të borxhit për frymë, por ndikimi i tij ka qenë shumë më i vogël se rritja e borxhit.

Grafiku 8 .Ecuria e stokut te borxhit, popullsise dhe borxhit për fryme (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Instat

Totali i borxhit për vitin 2014 parashikohet të rritet me rreth 120,4 miliardë lekë krahasuar me 2013, ndërsa në 2012-2013 rritja e borxhit ishte 83,7 miliardë lekë. Përveç huamarrjes për të mbështetur buxhetin, këtë vit, pagesa e borxheve ndaj bizneseve që kanë kryer punë në sektorin e infrastrukturës në vlerë 35 miliardë lek, pati ndikimin e saj në rritjen e borxhit.

2.14 Risku si shoqërues i SME-ve në aktivitetin e tyre ekonomik

Për të gjitha tipet e bizneseve, është e nevojshme të kuptohen risqet me të cilat duhet të përballet aktiviteti, sidomos kur kanë vendosur të arrijnë objektiva të caktuara apo një nivel të kërkuar fitimi. Njësitë ekonomike apo organizatat duhet të kuptojnë dhe të njohin nivelin e përgjithshem të riskut që shoqëron aktivitetin dhe të njohin apo t'i japin prioritet risqve më dominuese, duke ideuar dhe politikat e

kontrollit. Rezultatet e një menaxhimi të mirë të riskut, do të reflektohen në përmirësim të efiçiencës operacionale, në një gjendje më të mirë financiare të kompanisë, në përmirësimin e efikasitetit të taktikave dhe strategjive të kompanisë.

Menaxhimi i riskut është një proçes gjithmonë e më i rëndësishëm për mbarëvajtjen e biznesit, gjë që rrit shqetësimin e investitorëve për çështjen dhe analizën e riskut. Risku mund të jetë çelësi në marrjen e vendimeve strategjike, mund të jetë shkaku fillestar i humbjes së besimit. Një analizë e gjerë e riskut përfshin impaktin e të gjitha llojeve të riskut në të gjitha proçeset operacionale, proçeset e investimit, produkteve e shërbimeve, etj. Më poshtë bëhet një prezantim nga ana teorike e tërësisë së risqeve veçanërisht riskut të kredisë, ndikimin që ka mbi aftësinë e rritjes ekonomike, duke trajtuar aspektin e sfidave në fushën e menaxhimit të tij.

Trajtimi i riskut në mënyrën e duhur nga ana e drejtuesve, mund të sjellë përfitime për aktivitetin, që në teori quhen "upside risk", ose mundësia për të fituar. Vetë termi risk shihet me ngjyrim negativ dhe zakonisht me këtë term nënkuptohet ana negative e riskut, ai që njihet si "downside risk", e thënë shkurt "mundësia për të humbur". Kriza e 2007-ës vuri në pah rëndësinë e menaxhimit të duhur të riskut, një koncept ky që po bëhet gjithmonë e më i diskutuar edhe në vendin tonë.

Teoria ekonomike njeh për riskun përkufizime dhe trajtime të ndryshme, në varësi të situatës, këndvështrimit dhe objektivave. Risku ka lidhje me pasigurinë, me mundësinë për të humbur, por edhe për të fituar, apo thjesht me devijimin nga rezultati i pritur. Për një biznes, risku paraqet mundësinë e ndodhjes së ngjarjeve që shkaktojnë luhatje dhe mosrealizim të objektivave. Krizat ekonomike dhe financiare janë tregues i qartë i ndryshimeve të mëdha që pësojnë vlerat dhe parametrat financiare të ekonomive të bizneseve, duke e bërë më kompleks dhe evidentimin nga ana kontabël të këtyre vlerave.

Faktorët e riskut për një biznes mund të jenë faktorë të ambientit të biznesit (të jashtëm) ose faktorë të vetë biznesit, pasi çdo biznes i nënshtrohet risqeve që vijnë si pasojë e ekonomisë ku ai operon, sistemit ekonomik dhe financiar, kulturës dhe ligjeve të vendit, etj. Gjithashtu çdo biznes ka karakteristikat e tij, unike dhe specifike, që përveçse i shtojnë vlerë biznesit, ulin ose rrisin ekspozimin ndaj riskut. Biznesi

shqiptar paraqet karakteristika të një biznesi dinamik, përgjithësisht fleksibël, të fokusuar kryesisht ndaj shërbimeve (80%) dhe të organizuar në mikrondërmarrje ose ndërmarrje të vogla (99%). Ato angazhojne pak kapital, duke qenë kështu fleksibël ndaj ndryshimeve.

Në praktikën e përditshme të punës në biznese, kryhen zgjedhje që përmbajnë risk, madje edhe koncepti i iniciativës ekonomike nuk mund të kuptohet pa riskun. Fitimi i kërkuar nga investimi është në varësi të drejtëpërdrejtë të riskut. Risqet që prekin dhe tronditin vlerën e pasurisë së një aktiviteti, janë të shumtë në numër dhe me intensitet të ndryshueshëm.

Faktorët e riskut për një biznes mund të jenë të ambientit të jashtëm ose makroekonomik, apo faktorë që lidhen me vetë aktivitetin dhe operacionet e brendshme të biznesit. Kompanitë i nënshtrohen risqeve që vijnë si pasojë e ekonomisë së vendit ku operojnë, pra sistemit ekonomik, financiar, kulturës dhe ligjeve të vendit ku kryen aktivitetin. Përveç këtyre faktorëve të jashtëm, çdo biznes ka karakteristikat e tij të veçanta që mund ta rrisin ekspozimin përballë riskut.

Tabela5. Faktorët e jashtëm të riskut të biznesit



Burimi: Autori

Konkurenca e pandershme, informaliteti, evazioni fiskal e arbitrariteti në tatim taksa, janë disa faktorë jashtë ambientit të biznesit që rrisin riskun e të bërit biznes në Shqipëri. Krizat ekonomike kanë shkaktuar një rënie të remitancave, për pasojë fuqia blerëse ka rënë ndjeshëm, gjë që shkakton ekspozim më të lartë ndaj riskut, sidomos në ekonominë tonë ku pjesa dominuese e bizneseve operojnë në fushën e shërbimeve.

Reçesioni tenton të ekspozojë dobësitë e një kompanie. Në këtë mënyrë, pozicioni jo i favorshëm konkurues, prodhimet e dobëta, problemet në kontrollin e cilësisë, kontrollet e dobëta financiare apo nivelet e dobëta të kapitalit dhe likuiditetit mund ta rendisin kompaninë si lehtësisht të prekshme nga një reçesion. Biznesi shqiptar është i dominuar nga firmat e vogla, të cilat karakterizohen nga fleksibiliteti dhe dinamika në marrjen e vendimeve, por që në pergjithësi priren drejt fitimeve të menjëherëshme, duke ndikuar negativisht në perspektivën e tyre.

Tabela 6. Faktorët e brendshëm të riskut të biznesit



Burimi: Autori

Zbatimi i ligjeve, mungesa apo boshllëqe në lidhje me ligjet fiskale, mungesa e një gjykate të llogarive, ndryshimet e shpeshta në normat ligjore, etj, të gjitha këto përbëjnë faktorë risku për bizneset që operojnë në Shqipëri. Jemi të gjithë të vetëdijshëm për ambjentin politik shumë të polarizuar, gjë që favorizon shumë klientelizmin politik. Normat e interesit, kurset e këmbimit, forcimi i kushteve të kredidhënies nga bankat etj, janë risqe që lidhen kryesisht me parametrat

makrofinanciarë të ekonomisë, të cilat ndikojnë në secilin biznes në varësi të llojit të aktivitetit.

Strategjia e një biznesi e cila përfshin zhvillimin e produkteve për rekrutimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, mund të jetë burim i risqeve nëse nuk ndërtohet siç duhet. Tërësia e proçeseve operacionale që kryhen në një biznes, kërkon përfshirjen e burimeve njerëzore, sistemeve informative, teknologjisë së nevojshme për prodhimin e produkteve, mjete financiare, etj.

Rastet e gabimeve, mashtrimeve, sabotimeve, aksidenteve, difekteve, paaftësive në punë, e shumë të tjera si këto, rrisin ekspozimin ndaj riskut me burim nga ambjenti i brendshëm operacional. Nëse flasim për riskun e dështimit apo të falimentimit, një nga arsyet kryesore është ajo e mungesës së likuiditetit që lidhet me aspektin financiar të riskut. Ndërkohë që rritet kërkesa e bizneseve për likuiditet, bankat forcojnë kushtet e kredidhënies dhe proçeset e menaxhimit të riskut të kredisë.

KAPITULLI III - ZHVILLIMI I SISTEMIT BANKAR NË SHQIPËRI DHE PROBLEMATIKAT E TIJ NË LIDHJE ME FINANCIMIN E SME-VE

Aktualisht në Shqipëri funksionojnë tre nivele zyrtare për financimin e bizneseve: mikrokrediti, fondet e investimeve për SME-të, huatë bankare. Ndërsa disa vite më parë ishin vetëm pak banka private tregtare që kishin degë jashtë Tiranës, kjo situatë është përmirësuar ndjeshëm. Shumica e bankave që operojnë aktualisht në Shqipëri tani kanë degë në disa qendra të rëndësishme urbane dhe proçesi i zgjerimit të tyre po vazhdon. Sot bankat tregtare sigurojnë pjesën dërrmuese të fondeve për bizneset në Shqipëri. Vetë bankat po mundohen të profilizohen duke zënë secila prej tyre pjesën e vet të tregut dhe disa prej tyre preferojnë kreditimin e bizneseve të vogla e të mesme (SME) apo ato të sapolindura, në financimin për zgjerim të aktivitetit të tyre.

Në fund të muajit qershor 2013, bankat e sektorit bankar shqiptar ndaheshin sipas madhësisë së aktivitetit të tyre në:

- banka të Grupit 1 (secila nga 0-2% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Veneto Banka, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka e Parë e Investimeve, Banka e Kreditit të Shqipërisë;
- banka të Grupit 2 (secila nga 2-7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Procredit, Banka Credit Agricole, Banka Kombëtare e Greqisë, Banka Societe Generale - Albania, Banka Alfa – Shqipëri, Banka Union;
- banka të Grupit 3 (secila mbi 7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Intesa Sanpaolo – Shqipëri, Banka Credins, Banka Tirana.

Në fund të muajit qershor 2013, sipas origjinës së kapitalit, bankat e sektorit bankar shqiptar grupoheshin si në vijim:

- me kapital të huaj: Banka Raiffeisen (Austri); Banka Intesa Sanpaolo – Shqipëri, Veneto Banka (Itali); Banka Alfa-Shqipëri, Banka Tirana, Banka Kombëtare e Greqisë (Greqi); Banka Kombëtare Tregtare (Turqi); Banka Societe Generale, Banka Credit Agricole (Francë); Banka Procredit (Gjermani); Banka e Parë e Investimeve (Bullgari); Banka Ndërkombëtare

Tregtare (Malajzi); Banka e Bashkuar e Shqipërisë (Arabi Saudite); Banka e Kredititit të Shqipërisë (Kuvait);

- me kapital shqiptar: Banka Credins, Banka Union.

Në fund të muajit qershor 2013, shtrirje të rrjetit të degëve jashtë vendit evidenton Bankën Kombëtare Tregtare me degët e krijuara në Kosovë.

Sipas rregullores "Për administrimin e riskut të kredisë" bankat klasifikojnë kreditë e tyre në pesë kategori: kredi standarte, kredi në ndjekje, kredi nënstandarte, kredi të dyshimta dhe kredi të humbura.

Kreditë e klasifikuara në grupin e parë dhe të dytë përbëjnë grupin e kredive cilësore. Kreditë e klasifikuara në grupin e tretë, të katërt dhe të pestë përbëjnë grupin e "kredive me probleme".

Kreditimi është thelbësor për ekonominë e një vendi, veçanërisht për ato vende të Evropës të cilat kanë kaluar nëpër disa faza zhvillimi pas ndryshimit të regjimeve të mëparshme ekonomike e politike. Niveli i kreditimit varet edhe nga niveli i zhvillimit ose fazat nëpër të cilat ekonomitë e këtyre vendeve kanë kaluar.

Deri në fundin e vitit 2000, Banka e Shqipërisë përdori instrumente direkte të kontrollit monetar nëpërmjet imponimit të kufijve të kredititit, duke mos i lejuar bankat tregtare të ofronin kredi përtej një niveli të paracaktuar. Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme e kredive të dhëna gjatë regjimit të mëparshëm por edhe kredive të reja, u kthyen në kredi me probleme. Rrjedhimisht, institucionet bankare nuk po ndiheshin të sigurta për aftësinë paguese të klientëve të tyre potencialë, duke u detyruar ta investonin shumicën e fondeve të tyre në letra me vlerë të qeverisë, pa risk. Në vitin 2001, raporti i kredive me probleme ra në mënyrë të ndjeshme. Ky fenomen ka ardhur si rezultat i vendimit administrativ, të kalimit të kredive me probleme të Bankës së Kursimeve, pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive (ATK). Si rezultat, u vu re një pakësim i këtyre kredive për sistemin bankar[23].

[23] Çeliku, E., dhe Luçi E., (2004), "Ndikimi i qëndrueshmërise së situatës makroekonomike në nivelin e kredive me probleme", Banka e Shqipërisë.

Pas kësaj periudhe, përgjatë vitit 2004, ekonomia shqiptare u karakterizua nga rritje e shpejtë e kreditimit, veçanërisht pas vitit 2004 që përkoi edhe me privatizimin e bankës më të madhe, nga hyrja e grupeve të njohura bankare të huaja dhe nga bashkimi i dy bankave, duke rritur konkurrencën dhe nxitur kreditimin, sidomos atë në valutë të huaj. Megjithëse ritmi i rritjes së kreditimit ishte shumë i lartë, bankat kishin ende hapësira dhe fonde për kredidhënie, tregues ky i karakterizuar nga vlera të ulëta të raportit kredi të dhëna mbi depozitat bankare.

Pas shpërthimit të krizës globale financiare në vitin 2007-2008, ekonomia u përball me një rritje të ngadaltë të kredisë, rritje kjo në nivele tepër të ulëta që u vunë re pas vitit 2009. Ajo ende vazhdon të rritet tepër ngadalë. Kërkesa për kredi nga bizneset dhe individët si dhe oferta për kredi nga ana e institucioneve bankare u ndikuan nga zhvillimet e sipërpërmendura. Përsa i përket ofertës, bankat i kanë shtrënguar standardet e kreditimit, por vihet re edhe një rënie e kërkesës së sektorit privat për kredi.

Vendet në tranzicion, në menyrë të vecantë, u karakterizuan nga rritja e shpejtë e kreditimit veçanërisht pas viteve 2000. Pas fillimit të krizës financiare, u vu re ulja e ritmeve të rritjes së kreditimit. Në Shqipëri, kredia për sektorin privat u rrit me ritme më të larta sesa në vendet e rajonit apo ato të Evropës Qendrore e Lindore. Kjo ishte kryesisht pasojë e normave të larta të rritjes ekonomike, por kjo periudhë u karakterizua nga një nivel i ulët i raportit të kredive të sektorit privat mbi prodhimin e përgjithshem bruto. Në Shqipëri kreditimi është ende nën nivelin potencial, por hendeku është duke u ngushtuar, që tregon se ka ende vend për një rritje të mëtejshme të kreditimit[24].

3.1 Aktiviteti kreditues për sektorin e SME-ve dhe ekonominë në tërësi

Kalluci I. (2013), "Përcaktuesit e kredisë bankare për sektorin privat: rasti i Shqipërisë", Banka e Shqipërisë

Nga vrojtimi i aktivitetit kreditues pranë bankave në tremujorin e katërt të vitit 2013, vihet re një shtrëngim i standardeve të kredisë dhënë bizneseve, por kërkesa për kredi mbetet e dobët. Nga ana tjetër, standardet e kredisë dhënë për individë u lehtësuan gjatë tremujorit të katërt. Faktorët kryesorë që ndikuan në shtrëngimin e standardeve të kredisë për biznese vazhdojnë të jenë:

- perceptimi mbi pasigurinë rreth situatës makroekonomike;
- borxhi publik;
- problemet specifike me të cilat përballet sektori ku biznesi operon;
- zhvillimet e pafavorshme në tregun e pasurive të paluajtshme;
- dhe reduktimi i nevojave për financimin e investimeve të reja;
- burimet alternative të financimit;
- ndikimi negativ i financimit të kapitalit qarkullues.

Sistemi financiar është truri i ekonomisë së tregut. Rritja e profesionalizmit dhe transparencës së bankave në vendin tonë, është një kusht i rëndësishëm në zhvillimin e kësaj ekonomie. E parë në këtë dritë, trajtimi i diferencuar i biznesevе-klientëve të bankave, bazuar në një histori krediti dhe stabilitet transaksionesh, shihet si një domosdoshmëri. Kalimi i 90% të transaksioneve financiare të biznesit përmes bankave, është nga njëra anë një mbështetje e mëtejshme ligjore dhe morale për zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit bankar, dhe nga ana tjeter paraqet një detyrim për bankat që të bëjnë të mundur rishikimin e tarifave të shërbimit, që për pasojë sjell lehtësimin e kostove në marrëdhëniet me bankat, duke aplikuar një trajtim të diferencuar të këtyre klientëve. Ky trajtim i diferencuar do të arrihet përmes një analize të përditësuar të bazës së të dhënave të strukturuar mbi kritere të sakta, e cila do t'i paraprijë një analize potenciale risku. Në këtë mënyrë do të prezantoheshin në treg të paketa të diferencuara të produkteve bankare dhe të kritereve të kreditimit, dhënë bizneseve të vogla dhe të mesme, për qëllime investimi, apo financimi të kapitalit qarkullues.

Sipas madhësisë së ndërmarrjeve, standardet e kredidhënies ndryshuan me të njëjtën masë si për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, standardet u shtrënguan vetëm për kreditë me qëllim investimet, ndërsa u lehtësuan pak për kreditë me qëllim financimin e kapitalit qarkullues (balancat përkatëse rezultuan, -5.1% dhe 1.8%). Faktorët që ndikuan në kahun shtrëngues të standardeve të kredisë për bizneset, gjatë tremujorit të katërt, vijojnë të jenë: problemet specifike të sektorit ku zhvillon aktivitetin ndërmarrja, gjendja e huave me probleme në sistemin bankar dhe situata makroekonomike në vend. Vendimet e Bankës së Shqipërisë kanë ndikuar në kahun lehtësues të standardeve të kredidhënies për bizneset.

Grafiku 9. Ndryshimet në standartet e zbatuara në kreditë për bizneset në total, sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe qëllimit të përdorimit të kredisë (Balanca neto, përqindja e bankave që kanë lëhtësuar standardet)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Balanca pozitive tregon për lehtësimin e standarteve, ndërsa balanca negative tregon për shtrëngim të tyre.

Banka e ka realizuar politikën shtrënguese kryesisht nëpërmjet zgjerimit të marzhit për kreditë me risk dhe rritjes së kërkesës për kolateral. Nga ana tjetër, ndihmë në zbutjen e standarteve të kredisë kanë vijuar të jenë: ngushtimi i marzhit mesatar, ulja e komisioneve dhe rritja e maturitetit maksimal të kredisë.

Kërkesa e bizneseve për kredi në tremujorin e katërt të vitit 2013, ka vazhduar të jetë negative. Rreth 29% e bankave kanë perceptuar rënie të kërkesës për kredi. Rënia e kërkesës është më e fortë për ndërmarrjet e mëdha, se sa për ndërmarrjet e

vogla dhe të mesme, dhe kryesisht për kërkesën për investime, në krahasim me kërkesën për financimin e kapitalit qarkullues.

Grafiku 10. Ndryshimi i kushteve për miratimin e kredive të bizneseve (Balanca neto, përqindje neto e bankave që janë shprehur për lehtësimin e kushteve.)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar negativisht në kërkesën gjatë kësaj periudhe janë: situata aktuale dhe e pritshme makroekonomike në vend, përdorimi i burimeve alternative, financimi i investimeve dhe financimi i kapitalit qarkullues.

Vendimet e Bankës së Shqipërisë për ndryshimin e kushteve për miratimin e kredive të bizneseve kanë dhënë një ndikim të vogël pozitiv në kërkesën për kredi gjatë kësaj periudhe[25].

Grafiku 11. Ecuria e kërkesës së bizneseve për kredi, sipas madhësisë së biznesit dhe qëllimit të përdorimit të kredisë (balanca neto, përqindje neto e bankave që janë shprehur për rritje të kërkesës)

[25] Banka e Shqipërisë, Departamenti i Politikës Monetare, (Janar 2012), "Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për Tremujorin e e katërt, 2012 "



Burimi: Banka e Shqipërisë

3.2 Risqet ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar

3.2.1 Risku i tregut

Sektori bankar shqiptar, në fund të gjashtë mujorit të vitit 2013, rezulton relativisht i mbrojtur ndaj riskut të drejtpërdrejtë të lëvizjeve të pafavorshme në dy përbërësit e riskut të tregut:

- risku i kursit të këmbimit;
- risku i normës së interesit.

Pozicionet e hapura valutore të sektorit bankar ndaj kapitalit rregullator tregojnë për një mbrojtje të mirë dhe janë brenda niveleve historike, duke iu referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, për të njëjtën periudhë. Ndërkohë, diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit në raport me totalin e aktiveve është në nivele të papërfillëshme. Ecuria e *spread*-eve për monedhat kryesore, rezulton të jetë zgjeruar lehtësisht për lekun dhe euron duke ekspozuar sistemin ndaj riskut të tërthortë të normës së interesit për këto dy monedha.

Pesha e aktiveve dhe e detyrimeve në valutë kundrejt totalit të aktiveve në qershor 2013, rezultuan përkatësisht 55.7% dhe 51.8%, krahasuar me 56% dhe 52.6% që rezultonin në fund të vitit 2012.

Edhe pse vihet re një rritje e peshës së diferencës së aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit në raport me totalin e aktiveve, përsëri mund thuhet se ekspozimi i sektorit bankar ndaj luhatjeve të normës së interesit paraqitet në nivele të kufizuara. Në rast se normat e interesit do të rriten, sektori bankar do të ekspozohet më pak ndaj riskut të të ardhurave. Për asnjë nga maturitetet 1 muaj, 3 muaj dhe një vit, *gap*-i mes aktiveve dhe detyrimeve nuk rezulton pozitiv. Gjatë

gjashtëmujorit të parë të vitit 2013, ecuria e *spread*-eve në monedhat kryesore paraqitet në rritje për lekun dhe euron krahasuar me fundin e vitit 2012, duke e ekspozuar sistemin më ndjeshëm ndaj riskut të tërthortë të normës së interesit për këto dy monedha. Konkretisht, *spread*-i i llogaritur për këto dy monedha arriti në nivelet 6.9% dhe 5.3%, nga 6.2% dhe 4.7% që shënonte në fund të vitit 2012. *Spread*-i në dollarin amerikan është ngushtuar si rrjedhojë e rënies më të madhe të normës së kredisë për këtë monedhë për periudhën.

3.2.2 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit për sektorin bankar vlerësohet të jetë në nivele të moderuara. Treguesit e likuiditetit të sektorit bankar pasqyrojnë stabilizim në nivele të qëndrueshme. Depozitat vijojnë të mbeten burimi kryesor i financimit edhe pse me rritje më të ngadalshme. Aktivet likuide të sektorit bankar në monedhën vendase dhe në monedhë të huaj janë mbi nivelet minimale rregullative. Mospërputhja e maturimit midis aktiveve dhe detyrimeve është zgjeruar, por gjendet brenda vlerave historike. Aktiviteti i sektorit bankar shqiptar financohet në mënyrë të konsiderueshme nga depozitat e klientëve, të cilat mbulojnë mbi 1.7 herë vlerën e kredive.

Në fund të muajit qershor 2013, bankat paraqiten likuide duke siguruar respektimin e normave rregullative për treguesin "aktive likuide/detyrime afatshkurtra", si në monedhën vendase, ashtu dhe atë në valutat euro dhe dollarë amerikanë. Në fund gjashtëmujorit të parë 2013, aktivet likuide përfaqësonin 33.8% të totalit të detyrimeve afatshkurtra dhe 27.4% të totalit të aktiveve krahasuar me 36% dhe 29% që rezultonin një vit më parë. Në grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit, vlen të përmendet fakti se vetëm bankat e grupit të dytë shfaqin rritje për këta dy tregues. Të ndara sipas origjinës, vërehet se bankat me kapital italian shfaqin rënie të konsiderueshme në të dy treguesit, duke qenë shkak thuajse ekskluziv në rënien e këtyre treguesve për sistemin bankar vendas në tërësi.

Në gjysmën e parë të vitit 2013, diferenca në maturim midis aktiveve dhe detyrimeve është zgjeruar krahasuar me një gjashtëmujor më parë. Ky zhvillim ka ardhur si rezultat i rritjes së maturitetit të mbetur të aktiveve, ndërkohë që maturiteti i mbetur i detyrimeve ka shënuar rënie. Në gjysmën e parë të vitit 2013, aktivet e sektorit bankar kishin një afat maturimi mesatar të mbetur prej 28.4 muajsh,

krahasuar me 27.6 muaj që llogaritej në fundin e vitit 2012. Ndërkohë, detyrimet e sektorit bankar paraqitën një afat maturimi mesatar të mbetur prej 11.9 muajsh, nga 12.5 muaj në dhjetor 2012.

3.2.3 Risku i kredisë

Risku i kredisë mbetet risku kryesor për qëndrueshmërinë e sektorit bankar. Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e riskut të kredisë në bilancet e bankave përmendim:

- zhvillimin e ngadaltë të ekonomisë;
- pasigurinë për zhvillimet ekonomike;
- kushtet e dobëta në tregun e punës;
- paqëndrueshmërinë e të ardhurave dhe remitancave;
- probleme të natyrës strukturore.

Gjatë vitit 2013, është shënuar një ecuri e dobët e portofolit të kredisë, si pasojë e shtrëngimit të standarteve të kreditimit nga ana e bankave, të cilat i kanë investuar burimet e tyre në aktive më pak riskoze. Në krahun lehtësues të ofertës kanë ndikuar faktorë të tillë si niveli i lartë i likuiditetit dhe ulja e marzheve të fitimit nga ana e bankave.

3.3 Ecuria e riskut të kredisë për SME-të dhe ekonominë në tërësi

Aktivet e ponderuara me risk pësuan rënie me një vlerë prej 21.4 miliardë lekë ose 3.3% krahasuar me fundin e vitit 2012.

Në mbyllje të vitit financiar 2012, përpjekjet e bankave për të përmirësuar nivelin e arkëtimit të detyrimeve të prapambetura të huamarrësve rezultuan në një përmirësim të lehtë të stokut të kredive me probleme. Megjithatë, huatë me probleme të sektorit bankar u rritën gjatë gjashtëmujorit të parë 2013 me 7.8%, në nivelin 140.1 miliardë lekë.

Risku i kredisë në bilancet e bankave, i shprehur me raportin e huave me probleme ndaj totalit të huave, ka vazhduar trendin rritës dhe në mes të vitit 2013, arriti në nivelin 24.2% nga 22.5% në fund të vitit 2012 dhe 21.1% në të njëjtën periudhë të vitit 2011. Pesha e kredisë me probleme të sektorit privat u rrit me 2.5

pikë përqindje duke arritur në nivelin 28.4%. Për individët, pesha e kredisë me probleme ruajti nivelin e një periudhe më parë, 17.2%.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013, vihet re ky klasifikim brenda kredisë me probleme:

- Kredia e klasifikuar "standarde" është tkurrur me rreth 15.6 miliardë lekë ose 4% në nivelin 384.1 miliardë lekë, duke humbur 2.9 pikë përqindje peshë në klasifikimin total, përkatësisht në nivelin 66.3%.
- Kredia e klasifikuar "në ndjekje" është rritur me 7.1 miliardë lekë ose 14.8%, duke sygjeruar nevojën për një monitorim të kujdesshëm të mundësisë që një pjesë e saj të shndërrohet në kredi me probleme.
- Në grupin e kredive me probleme, është evidentuar një rritje e kredisë së klasifikuar në klasën "e humbur", me 9.3 miliardë lekë ose 21.1%.

Zgjerimi i kategorisë së kredive me vonesë në pagesë, rrit mundësinë e kalimit të tyre në kredi me probleme. Tranzicioni i kredive në klasat me cilësi më të ulët, është shoqëruar me rritje të mbulimit me fonde rezervë (provigjione). Sektori bankar, ka shtuar provigjionet me 11.6% gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013, duke bërë që raportet "provigjion / teprica e kredisë" dhe "provigjion / kredi me probleme" të arrijnë nivelet maksimale të tyre që prej vitit 2008, përkatësisht 13.9% dhe 57.4%[26].

Grafiku 12. Ecuria e klasave të portofolit të kredisë me probleme, në përqindje

[26] Banka e Shqipërisë, (2013), "Monitorimi i rreziqeve ndaj të cilëve ekspozohet sektori bankar - Raporti i Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013"



Burimi: Banka e Shqipërisë

Bankat janë më të ekspozuara ndaj riskut të kredisë për portofolin e kredisë afatmesme, kredisë së akorduar në valutë dhe kredisë për subjektet private, ku pesha e kredive me probleme në këto portofole, në gjashtemujorin e parë të vitit 2013 ishte përkatësisht 31.4%, 26.5% dhe 28.4%.

Sipas qëllimit të përdorimit, kredia në formën "Overdraft", që mbizotëron në përdorim nga biznesi, është kategoria me rritjen më të madhe gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2013, me rreth 5 miliardë lekë ose 4.2%. Kredia për kapital qarkullues dhënë bizneseve ka shënuar rritje në vlerën 3.4 miliardë lekë ose 4.3% më pak se në periudhën e mëparshme. Ndërkohë për individët, rritja e kredisë është orientuar në investime për pasuri të paluajtshme duke shënuar një rritje me 1.4 miliardë lekë ose 1.4%. Grafiku numër 11 paraqet ndryshimet strukturore të ndodhura në shpërndarjen e kredisë sipas qëllimit të përdorimit gjatë periudhës 2006-2013.

Grafiku 13. Rritja vjetore e kredisë për biznesin dhe individët sipas qëllimit të përdorimit, në milionë lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Sektorët më përfaqësues të ekonomisë kanë pësuar rënie të konsiderueshme të cilësisë së kredisë. Sektorët që kryesojnë në përkeqësimin e raportit të kredive me probleme janë ai i "ndërtimit", "industrisë përpunuese" dhe "tregtisë", ku në qershor 2013 pesha e kredisë me probleme arriti respektivisht në 53.2%, 44.6% dhe 46.2%, krahasuar me 32.3%, 27.7% dhe 29.2% që shënonin një gjashtëmujor më parë. Sipas sektorëve të ekonomisë, prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit, vijon të mbështetet me kredi nga sektori bankar, kjo edhe për shkak të prioritetit dhe mbështetjes që institucionet qeveritare i kanë dhënë potencialeve hidroenergjetike të vendit. Gjithashtu, në përgjigje të përgatitjes për sezonin veror, sektori i hoteleve dhe restoranteve është mbështetur me kreditim duke shënuar një rritje me 2.3 miliardë lekë ose 13.3%. Tregtia si sektori me peshën më të madhe të kredisë ndaj totalit shënon një rritje modeste. Kontributi i sektorëve kryesorë në ecurinë e kredisë paraqitet në grafikun 14.

Grafiku 14. Ecuria e kredisë për bizneset dhe sektorët me kontributin në rritje.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Aktiviteti kreditues u ngadalësua më tej gjatë gjysmës së parë të vitit 2013, duke u rritur në terma vjetorë me 1.3%, niveli më i ulët në 11 vitet e fundit. Një vit më parë, kjo normë rritjeje ishte 9.3%. Kjo ecuri reflekton kërkesën e dobët për kredi si edhe shtrëngimin e kushteve të kreditimit nga bankat pas rritjes së riskut të kreditit. Më tej, disponueshmëria e alternativave të investimit me risk të ulët gjatë kësaj periudhe, mund të ketë ndikuar vendimmarrjen e bankave në ecurinë e kredisë drejt sektorit privat. Raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredisë u rrit në 24.2% në qershor 2013 nga 22.5% në dhjetor të vitit 2012 dhe 21.1% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në mënyrë të veçantë, kredia për biznesin e cila zë 69.3% të totalit të kredive dhe që ka qenë motori i aktivitetit kreditor gjatë 3 viteve të kaluara, pësoi rënie me 0.2% në terma vjetorë nga 1.5% rritje në dhjetor 2012. Ndërkohë, kredia për individët u përmirësua me 3.1% në terma vjetorë, kundrejt një rritjeje prej 0.4% në dhjetor 2012.

Grafiku 15. Struktura e portofolit të kredisë për ekonominë vendase



Burimi: Banka e Shqipërisë

3.4 Analizë e situatës aktuale të kredive me probleme për sektorin e SME-ve

Risku më i rëndësishëm dhe më i prekshëm, me të cilin përballen bankat gjatë veprimtarisë së tyre, është risku i kredisë. Huaja me probleme ka ardhur në rritje prej vitit 2008, dhe kjo përbën një ndër problemet më kritike me të cilat përballet sot ekonomia shqiptare. Ndër faktorët që sjellin evidentimin e këtij fenomeni përmendim:

- cilësinë e menaxhimit të rreziqeve;
- krijimin e strukturave të përshtatshme;
- kohën dhe mënyrën e kryerjes së ristrukturimeve të huave;
- kryerjen e analizave së provës së rezistencës (*stress-test*) dhe rritjen e burimeve kapitale, në përputhje me rezultatet e analizave.

Janë vënë re ndërhyrje ligjore e rregullative për trajtimin e hershëm të këtij fenomeni, si për bankat ashtu edhe për institucionet e tjera, ndër të cilat mund të përmendim: ndryshimin e ligjit për bankat, lehtësimin e kërkesave rregullative për ristrukturimin e huave dhe ndryshimin e rregullores: "Për administrimin e riskut të huasë".

Në fillim të vitit 2014 Banka e Shqipërisë ndërmorri një paketë masash për nxitjen e huadhënies në vend nëpërmjet lehtësimit të kërkesave rregullative, duke synuar kështu dhënien e stimujve në mjedisin ekonomik dhe atë financiar. Inisiativat për ndryshime rregullative kanë qenë të lidhura me uljen e nivelit të huave me probleme, me qëllim krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për rritjen e ndikimit, në kahun pozitiv. Ndryshimet rregullative të Bankës së Shqipërisë për lehtësimin e kritereve rregullative, në drejtim të klasifikimit dhe provigjionimit të huave të ristrukturuara, kanë krijuar gjithashtu kushte të përshtatshme për nxitjen e këtij proçesi. Gjithashtu, po nga i njëjti insitucion vijnë edhe publikimi i dy udhëzuesve për ristrukturimin e huave, një për biznesin dhe një për individët, të cilët synojnë të orientojnë palët që hyjnë në një marrëdhënie ristrukturimi, si dhe është synuar të rritet ndërgjegjësimi i sistemit bankar për kryerjen e hershme të ristrukturimeve të huave, si një ndër instrumentet më të rëndësishëm për të ndihmuar në vazhdimësinë e veprimtarisë së biznesit dhe asaj ekonomike në tërësi. Praktika të ngjashme janë ato të ndjekura nga shtete si Anglia, të Korea e Jugut dhe Turqisë që janë ndeshur me kriza të forta financiare dhe që kanë ndërmarrë ristrukturime në shkallë të gjerë ekonomie.

3.5 Ecuria e kredidhënies ndaj biznesit në Komunitetin Evropian

Ekonomitë në vështirësi financiare të Eurozonës janë nën ndikimin e disa faktorëve, të cilët janë përgjegjës për këtë situatë. Këtu përmendim:

- risku i lartë në borxhin qeveritar;
- gjendje jo e mirë financiare e pasqyruar në bilancet e bankave të nivelit të dytë;
- risku i kredisë sidomos kundrejt koorporatave;
- mjedisi ekonomik dhe politik.

Rëndësia e këtyre faktorëve vlerësohet ekonometrikisht duke përdorur të dhënat financiare mujore për periudhën 2003-2013 për Francën, Italinë, Spanjën dhe normat e interesit për kreditë e vogla, shumica e të cilave janë aprovuar për sektorin e SME-

ve[27]. Rezultatet tregojnë që ashtu siç pritej, forcat kryesore të cilat kanë shkaktuar këtë situatë të vështirë kanë lidhje me borxhet e qeverive, dobësitë e sistemit bankar, si dhe normat e larta të interesit për kreditë e vogla në Itali dhe Spanjë, veçanërisht prej mesit të vitit 2011 e në vazhdim. Gjithashtu, edhe risku i kredisë për koorporatat është një faktor i rëndësishëm për rritjen e normave të interesit për kredidhënien në Itali, Portugali e Spanjë. Megjithatë, politika monetare ka qenë e pamjaftueshme për të kompensuar presionet e tjera, të cilat kanë sjellë rritjen e normave të interesit për kreditë në dispozicion të SME-ve. Përveç kësaj, reçensioni i thellë dhe i zgjatur në Itali dhe Spanjë kanë tkurrur kërkesën për kredi të koorporatave.

Fragmentimi financiar në kuadër të zonës euro ka vazhduar në mënyrë intensive, duke përforcuar reagime të kundërta midis bankave të dobëta[28], koorporatave, dhe borxheve tepër të larta të qeverive. Si rezultat, së bashku me kërkesën e ulët për kredi, kredidhënia bankare për koorporatat vazhdon të tkurret. Bankat e dobëta kanë rënduar më shumë problemet e koorporatave në gjendje jo të mirë financiare, sepse insititucionet e bankave qëndrore i kanë shtrënguar kushtet e kredidhënies me anë të mekanizimit të renditjes së kreditit, duke rritur interesat për kreditë e reja. Evidencat nga bankat e dobëta tregojnë së edhe në ekonomitë e stresuara në zonën euro, këto të fundit kanë me shumë gjasa që të ulin kredidhënien. Risqet sovrane janë pakësuar, por spredet e titujve të qeverive mbeten të diferencuar brenda eurozonës.

Divergjenca në spredin e titujve qeveritarë ka rritur koston e financimit për bankat në ekonimitë e stresuara, duke rënduar barrën e presionit për interesat e kredidhënies. Bankat e nivelit të dytë të përmasave të vogla në ekonomitë e stresuara janë përballur me presione të mëdha për financim dhe janë pikërisht këto banka që tentojnë të jenë ofruesit kyresorë të kredisë për ndërmarrjet e vogla e të mesme.

Në të njëjtën kohë, koorporatat në vështirësi financiare kanë përkeqësuar problemet e bankave të dobëta. Ky është veçanërisht rasti për SME-të, të cilat kanë

[27] Llogaritjet dhe vleresimet nga stafi i Fondit Monetar Nderkombëtar

[28] Termi "banka te dobëta" i referohet bankave të nivelit të dytë me gjendje jo të mirë financiare të pasqyruar në bilancet e tyre.

tendencë të kenë një raport borxhi më të madh se sa firmat më të mëdha. Në përgjithësi, më shumë se tre të katërtat e borxhit të koorporatave në Portugali dhe Spanjë dhe rreth gjysma e borxhit të koorporatave në Itali është borxh i zotëruar nga kompanitë me raport borxhi më të lartë se 40%. Raportet e larta të borxhit kanë bashkëvepruar me raportet e ulëta të rentabilitetit, (veçanërisht për shkak të vështirësive të qeverive dhe të bankave), duke kontribuar në fragmetnimin financiar dhe në rritjen e kostove të financimit e koorporatave në ekonomitë e stresuara.

Në përgjithësi, pothuajse 50% e borxhit në Portugali, 40% e borxhit në Spanjë, si dhe 30% e borxhit në Itali është borxh nga firmat me raport të mbulimit të interesave më të vogël se 1. Këto firma nuk do të jenë në gjendje të shlyejnë interesat e borxheve të tyre në afat mesëm, nëse ato nuk do te marrin masa për të kryer ndryshime të tilla si reduktimin e borxhit e të shpenzimeve operative, si dhe të shpenzimeve kapitale. Këto presione me origjinë nga nivele të larta të raportit të borxhit, së bashku me kushtet e vështira të mjedisit ekonomik, kanë sjellë një rritje të kredive të këqija, duke përkeqësuar cilësinë e aseteve të bankave. Bankat kanë rritur normat e interesit në përgjigje të rritjes së riskut të kredisë për koorporata, duke filluar ciklin përsëri.

Grafiku 16 tregon se normat e interesit bankar janë më të larta në ekonomitë në të cilat risqet e koorporatave janë më të larta, siç janë parashikuar nga Moody's për frekuencat e pritshme të probabilitetit për dështim të kompanive të kuotuara në bursë. Për më tepër, sa më të larta të jenë raportet e borxhit për sektorin e SME-ve, aq më të larta do të jenë interesat e kredive të bankave të vogla.

Grafiku 16. Kreditë me probleme në Euro-zonë



Burimi: Bankat Qëndrore të shteteve dhe llogaritjet e stafit të FMN

Bankat me gjendje të dobët financiare do të jetë më pak të afta dhe të gatshme të njohin humbjen, e si rrjedhoje të tregohen tolerante dhe të duruara në arkëtimin e kredive të dhëna. Edhe pse disa toleranca mund të ndihmojnë për të zbutur presionet në proçesin e kredidhënies për individë, një tendencë e tillë mund të sjellë riskun që bankat të investojnë burimet e tyre të pakta në biznese jo të shëndetshme, duke rënduar kreditimin e firmave më produktive dhe në gjendje më të mirë financiare. Në vitin 2012, pagesat e dividentëve u reduktuan ndjeshëm nga kompani spanjolle dhe italiane, dhe firmat e mëdha ndërkombëtare kanë shitur asetet e tyre. Përveç kësaj, kompanitë aksionere publikisht të kuotuara në bursë në Portugali dhe Spanjë, kanë reduktuar shpenzimet kapitale me mbi 15% (Grafiku 13) . Edhe pse pakësimi i borxhit brenda kompanive është i nevojshëm, shkurtimet e tepërta në shpenzimet kapitale, mund të dëmtojnë më tej perspektivat e rritjes ekonomike.

3.6 Kuadri ligjor në lidhje me riskun e kredisë në sistemin bankar shqiptar

Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikëqyrës i subjekteve që me ligj liçencohen prej saj. Aktet rregullative të miratuara janë akte rregullative mbikëqyrëse dhe akte rregullative të përgjithshme. Tërësia e tyre përbën kuadrin

rregullativ të mbikëqyrjes, nëpërmjet të cilit kufizohet risku që ndërmarrin bankat dhe subjektet e liçencuara nga Banka e Shqipërisë, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Kjo sanksionohet në nenin 12 të ligjit nr.8269, datë 23.12.97, "Për Bankën e Shqipërisë", i cili i jep asaj autoritetin e organit që ka të drejtën eskluzive të japë miratimin për fillimin e aktivitetit bankar nëpërmjet dhënies së liçencës, si dhe të mbikëqyrë aktivitetin e çdo subjekti, i cili ka marrë liçencë për ushtrimin e veprimtarisë bankare në Republikën e Shqipërisë.

Si autoritet mbikëqyrës Banka e Shqipërisë në bazë të këtij neni, ka për mision të hartoje, në përputhje me qëllimet e saj, akte nënligjore: vendime, rregullore, udhëzime dhe urdhra, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha bankat e subjektet e tjera të liçencuara nga Banka e Shqipërisë, me qëllim që respektimi i tyre të sigurojë qëndrueshmërinë e sistemit bankar. Si udhëzues kryesor për hartimin e këtij kuadri rregullativ shërbejnë "Parimet bazë për një mbikëqyrje efektive" të Komitetit të Bazelit, si dhe të gjithë udhëzuesit që Komiteti i Bazelit nxjerr në vazhdimësi për mbikëqyrjen bankare. Sistemi bankar në Republikën e Shqipërisë është i organizuar në dy nivele. Në nivelin e parë bën pjesë Banka e Shqipërisë, ndërsa në nivelin e dytë bëjnë pjesë bankat dhe degët e bankave të huaja si dhe subjektet financiare jobankare që liçencohen prej saj.

Rregullorja “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” ka për objekt të saj:

- përcaktimin e kritereve dhe rregullave për llogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit;
- përcaktimin e nivelit minimal të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat e liçencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me liçencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Bankat llogarisin mjaftueshmërinë e kapitalit si raport ndërmjet shumës së kapitalit rregullator me shumën e ekspozimeve të ponderuara me riskun, e shprehur në përqindje, në baza individuale dhe të konsoliduara. Bankat sigurojnë që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit i llogaritur të jetë jo më i vogël se 12%.

Bankat llogarisin kërkesën për kapital për riskun e kredisë dhe riskun e kredisë së kundërpartisë, sipas metodës standarde. Kërkesa për kapital për riskun e kredisë dhe riskun e kredisë së kundërpartisë, sipas metodës standarde, është e barabartë me 12% të totalit të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me peshat e riskut, në përputhje me përcaktimet e rregullores.

Vlera e ekspozimit është vlera e kredisë në bilanc, ndërsa vlera e ekspozimit të mundshëm, siç përcaktohet në aneksin 2 të kësaj rregulloreje, do të jetë një përqindje e vlerës se ekspozimit, sipas klasifikimit në kategoritë e riskut, si më poshtë:

- 100% e vlerës së tij, për kategorinë me risk të lartë;
- 50% të vlerës së tij, për kategorinë me risk të mesëm;
- 20% të vlerës së tij, për kategorinë me risk të ulët;
- 0% të vlerës së tij, për kategorinë pa risk.

Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit përkatës, pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit, në rastet kur ky ekspozim është subjekt i mbrojtjes së financuar të kredisë, duke konsideruar teknikat e zbutjes së riskut të kredisë, në përputhje me këtë rregullore.

Këshilli Drejtues i Bankës miraton dhe rishikon periodikisht strategjitë dhe politikat e administrimit, monitorimit dhe zbutjes së rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet apo mund të jetë e ekspozuar banka, duke përfshirë edhe ato që vijnë nga mjedisi makroekonomik në të cilin vepron banka.

Objekt i rregullores Nr. 05, datë 11.02.2009, "për miratimin e rregullores për kreditë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët" është përcaktimi i kërkesave mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së informacionit parakontraktor dhe kontraktor për kredimarrësin, përpara lidhjes dhe gjatë ekzekutimit të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare për individin, si dhe rregullimi i kredisë konsumatore. Qëllimi i kësaj rregulloreje është mbrojtja e interesave të kredimarrësve të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare për individin, nëpërmjet sigurimit të transparencës dhe pajisjes së tyre me informacionin e nevojshëm, për të kryer krahasueshmërinë e ofertave në treg.

3.7 Teknikat e zbutjes se riskut të kredisë

Parime të përgjithshme mbi teknikat e zbutjes së riskut të kredisë paraqiten qartazi

në ligj[29]. Bankat përdorin teknika të mbrojtjes së kredisë, të cilat së bashku me masat e ndërmarra prej tyre, procedurat dhe politikat që zbatojnë, rezultojnë në marrëveshje të mbrojtjes së kredisë, që janë ligjërisht efektive dhe të zbatueshme në të gjitha juridiksionet përkatëse. Bankat ndërmarrin të gjithë hapat e duhur për të siguruar efektivitetin e marrëveshjeve të mbrojtjes së kredisë dhe për të adresuar rreziqet e lidhura me to.

Bankat modifikojnë llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuara me riskun, duke zbatuar format e pranueshme të mbrojtjes së kredisë vetëm nëse plotësohen kërkesat e këtij kreu. Zbatimi i teknikave të zbutjes së riskut të kredisë në rastin e llojeve të ndryshme të mbrojtjes së kredisë merr parasysh që bankat mund të përdorin më shumë se një lloj mbrojtje kredie për të mbuluar një ekspozim. Gjithashtu, për llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuara me riskun, për riskun e kredisë, bankat do të ndajnë ekspozimin në pjesë të veçanta, ku secila mbulohet nga një lloj mbrojtje kredie, dhe do të llogarisin shumën e ekspozimit të ponderuar me riskun për secilën pjesë në mënyrë të veçantë, siç përcaktohet në këtë kre[30].

Ligji. 67, datë 13.10.2010, për miratimin e rregullores "Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e regjistrit të kredive në Bankën e Shqipërisë" ka si

[29] Vendim nr. 62, datë 14.09.2011, Për miratimin e rregullores "për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja", në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të neneve 57, 58, 61 dhe 68 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"

[30] Për një informacion të hollësishëm dhe të përditësuar, i referohemi Fletores Zyrtare Nr. 39, dt. 27 Mars 2014, në lidhje me vendimet e BSH. Vendimi nr. 10 Për miratimin e rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave", dhe vendimi 22, për Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja".

objekt përcaktimin e përmbajtjes së informacionit, parimeve dhe rregullave për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë, si dhe kushteve dhe kritereve për njohjen dhe përdorimin e informacionit që administrohet në të.

Kreditë e regjistruara kanë të dhëna për kredimarrësit, personat e lidhur dhe kolateralet e vëna si garanci për kthimin e kredisë. Aktualisht, bankat kanë hedhur në regjistër portofolin aktiv të kredive, si dhe regjistrojnë çdo ditë të dhëna për kreditë e reja. Regjistri përmban informacione pozitive dhe negative për kredimarrësin. Historiku i shlyerjes së kredive nga kredimarrësit do t'iu shërbejë bankave në proçesin e vendimmarrjes për dhënien ose jo të kredive të reja, duke reduktuar riskun e dhënies së kredive të këqija. Duke shërbyer si depozitues të dhënash mbi kredimarrësit, Regjistri i Kredive mundëson dhënien e informacionit të detajuar bankave ose institucioneve të tjera kredidhënëse dhe i ndihmon ato të marrin vendime më të mira në lidhje me kredidhënien. Në sajë të këtij regjistri, çdo bankë apo institucion tjetër kredidhënës është në gjendje të vlerësojë më mirë klientët, bazuar në aftësitë e tyre për të shlyer detyrime financiare, si dhe të gjykojë mbi besueshmërinë e tyre. Gjithashtu, regjistri ndikon në uljen e informalitetit në ekonomi, në rritjen e vëllimit të kredive, duke reduktuar koston dhe kohën e proçesit të kreditimit, si edhe në rritjen ekonomike të vendit.

Në momentin e paraqitjes së një kërkese për kredi, bankat përdorin informacionin e Regjistrit të Kredive për të verifikuar besueshmërinë dhe nivelin aktual të kreditimit të klientit të mundshëm, për ta financuar ose jo atë, si dhe për të përcaktuar kushtet e shlyerjes së kredisë. Regjistri i Kredive nuk merr vendime për kreditë dhe as nuk jep kredi për huamarrësit. Ai vetëm grumbullon dhe sistemon të dhënat, si dhe rinxjerr informacionin demografik dhe të kreditit mbi aplikuesit për kredi, kur i kërkohet një gjë e tillë nga përdoruesit e autorizuar. Regjistri i kredive ndihmon në reduktimin e kohës që bankave u nevojitet për marrjen e vendimit për dhënien e kredive dhe ndikon në rritjen e cilësisë së kredisë. Gjithashtu, kredidhënësit përfitojnë nga ulja e kostove të kredive dhe si rezultat, kanë në dispozicion më shumë fonde të vlefshme për kredi.

Banka e Shqipërisë synon përmirësim në punën e saj nëpërmjet analizave "stres-test" mbështetur edhe nga një bashkëpunim në rritje me FMN-në, Bankën

Botërore, Bankën Qëndrore Evropiane dhe me bankat qëndrore të huaja. Në kuadër të forcimit të proçesit të mbikëqyrjes së subjekteve bankare, Banka e Shqipërisë ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me bankat qëndrore të rajonit dhe ato evropiane ku bankat mëma kanë selitë qëndrore. Proçesi i shkëmbimit të informacionit si gjatë proçesit të liçensimit të institucioneve bankare, ashtu edhe në lidhje me rreziqe të mundshme ndaj stabilitetit financiar të institucioneve bankare që ato mbikëqyrin dhe bashkëpunimi në kryerjen e kontrolleve të subjekteve financiare që operojnë si brenda dhe jashtë vendit, do të ndihmojë Bankën e Shqipërisë në ushtrimin e rolit të saj në garantimin e stabilitetit të sistemit bankar në vend. Në tërësi aktiviteti i tyre financiar dhe ai kredidhënës kanë pasqyruar ecuri të mirë dhe kryesisht në përputhje me kuadrin rregullativ të vendosur nga Banka e Shqipërisë.

3.8 Përkufizimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme

Në një këndvështrim ndërkombëtar nuk ka një përcaktim të saktë kur një firmë është SME, pasi ky përcaktim ndryshon nga një shtet në një tjetër, sipas variablave cilësorë dhe sasiorë mbi të cilat bazohet kjo ndarje. Duke u nisur nga qëllimi i këtij shkrimi, në do të fokusohemi në punimin tonë në dy zona të rëndësishme ekonomike: Sh.B.A. dhe Evropa Perëndimore në funksion të studimit të SME-ve në Shqipëri.

Në Sh.B.A. vepron një organizatë e vecantë që shkurt emërtohet “SBA” (Small Business Administration), e cila merret me politikat në lidhje me SME-të, ku përcaktimi i sektorit të SME-ve është bazuar në sistemin Naics (North American Industry Classification System). Kriteret më të përdorshme për të identifikuar bizneset e vogla e të mesme janë numri maksimal i punëmarrësve jo më shumë se 500 dhe qarkullim vjetor me një vlerë jo më shumë se 28.5 milionë Usd. Këto kritere variojnë sipas industrive të ndryshme.

Komuniteti Evropian ka përdorur një përcaktim të përgjithshëm prej vitit 1996, që u ndryshua në 2003, ndoshta për të marrë parasysh edhe rregullat e Marrëveshjes se Basel-it. Numri i punonjësve jo më shumë se 250 dhe totali i qarkullimit vjetor jo më shumë se 50 milion Euro.

Duke u përballur me gjithë këto kritere, Komiteti i Basel-it është mbështetur kryesisht në të dhënat nga qarkullimi total vjetor, duke vendosur një rregull të

përgjithshëm për kapitalin e kërkuar për të gjitha firmat, (të mëdha, të mesme e të vogla), por duke siguruar një trajtim më të lehtë për firmat më të vogla (me një qarkullim vjetor total jo më të madh se 50 milion Euro). Ky vendim është bazuar mbi supozimin se firmat e vogla kanë një korrelim të dështimit më të vogël, jo sepse këto janë konsideruar më pak riskoze se koorporatat, por sepse mund të shkaktojnë humbje më të vogla. Gjithashtu një pjesë e SME-ve, mund të konsiderohen dhe si "Retail", por në këtë rast nuk ka aspak rëndësi se çfarë përcaktimi bëhet, i vetmi kriter i marrë në konsideratë është ekspozimi kundrejt bankës, i cili duhet të jetë jo më shumë se 1 milion Euro. Si konkluzion, me qëlllim rritjen e efiçiencës së tyre, bankat mund të përdorin më mirë sisteme automatike për vendimmarrjen e kredidhënieve për sektorin e SME-ve, të cilat karakterizohen nga ekspozime të vogla, pavarësisht nëse janë individë apo firma private.

Përkufizimi kombëtar i SME-ve jepet në ligjin Nr. 10042, datë 22.12.2008, "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin Nr. 8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar", fletore zyrtare 199, datë 14.01.2009. Përveç kritereve për frymë stafi në përkufizim u shtuan edhe treguesit financiarë, si ato të bilancit, xhiros, dhe pronësisë. Kategoria e ndërmarrjeve të vogla e të mesme përfshin ato ndërmarrje ku punësohen më pak se 250 veta dhe që realizojnë një shifër afarizmi dhe/ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë. Ndërmarrje e vogël quhet një ndërmarrje ku punësohen më pak se 50 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë. Për qëllime statistikore ndërmarrjet do të klasifikohen në: ndërmarrje të voglame numër punonjësish 10 deri 49 persona; ndërmarrje të mesme me 50 deri 249 persona.

KAPITULLI IV - MODELI I PARASHIKIMIT TË PERFORMANCËS SË SME-VE PËR SHLYERJEN E KREDISË BANKARE

Në bankat e nivelit të dytë, kredidhënia për biznesin e vogël gradualisht po merr përmasa të rëndësishme për shumicën e këtyre bankave. Parimet e marrëveshjes "Basel II" në kuadrin rregullator të pamjaftueshmërisë së kapitalit, ka kontribuar në njohjen e sektorit të biznesit të mesëm e të vogël si një sektor të veçantë dhe shumë të ndryshëm nga ai i koporatave të mëdha. Disa ekonomistë argumentojnë se ky segment duhet të trajtohet si klientët e vegjël dhe individët përsa i përket këndvështrimit të menaxhimit të riskut, me qëllim që të ulen kërkesat e kapitalit dhe të kuptohet saktësisht efiçienca dhe kapacitetet e realizimit të fitimeve. Në këtë kuptim, është e rëndësishme të zhvillojmë modele të përshtatshme risku për këtë pjesë të aseteve të bankave që po merr përmasa gjithmonë e më të mëdha. Me sa duket, nga një masë e gjerë studimesh të kryera për riskun e kredive, shumë pak janë fokusuar në zhvillimin e një modeli vecanërisht për sektorin e biznesit të mesëm e të vogël, dhe prej tyre akoma më pak kanë përfshirë informacion cilësor si parashikues të mbarëvajtjes së kredidhënies së SME-ve.

Në këtë studim disponohen të dhëna jo financiare që mbështesin ato të dhëna financiare të limituara, që kufizohen nga vetë volumi dhe forma e raportimit të aktivitetit të një biznesi të mesëm ose të vogël. Janë marrë në analizë të dhënat financiare të 130 bilanceve, të përbëra nga 2860 raporte financiare dhe 650 të dhëna jo financiare, të mbledhura këto nga viti 2008 deri në 2011. Nga 130 bilancet e shqyrtuara, u kategorizuan si kompani të pasuksesshme në huamarrjen bankare 58 raste dhe të suksesshme 72 raste. Nga të dhënat jo financiare, në studim u përfshinë këta tregues: vitet e jetës së biznesit, sektori dhe vendodhja gjeografike. Në përfundim u arrit në konkluzionin që pikërisht përdorimi i këtyre treguesve në modelin tonë të parashikimit, rrit fuqinë parashikuese të modelit të ndërtuar specifikisht për sektorin e biznesit të mesëm e të vogël.

Marrëveshja e kapitalit rregullator sipas Basel II si dhe kriza financiare, nxorrën në pah nevojën që institucionet huadhënëse të bëjnë përshtatjet e duhura në modelet e menaxhimit të riskut, për sektorët e koorporatave dhe biznesit të vogël e të mesëm, për të patur një përbërje me cilësore të portofolit të tyre të kredive të dhëna.

Duke u mbështetur në përcaktimet e Basel II, bankat konsiderojnë një kompani në vështirësi financiare nëse kjo kompani ka vonesa në pagesën e këstit të kredisë mbi 90 ditë.

Në rastin e menaxhimit të riskut për biznesin e mesëm e të vogël, modeli bazohet në një numër të madh të dhënash historike, duke kombinuar të dhënat brenda institucionit bankar, me ato të marra nga agjencitë e vleresimit të kredive apo nga regjistri i kredive nga banka qëndrore.

Më së fundmi, duke ndjekur kuadrin rregullator sipas Basel II, një numër gjithmonë e më i madh bankash po riklasifikojnë klientët e tyre duke i transferuar ata nga grupimi korporate në biznese të mesme e të vogla. Bankat kanë arritur në përfundimin se bizneset me përmasa të mesme e të vogla kanë karateristika dhe nevoja të veçanta, të cilat kërkojnë mjete të menaxhimit të riskut dhe metodologji specifike të krijuara posaçërisht për to. Mënyra më e mirë për të përmirësuar financimin e SME-ve është të përmirësohet cilësia e informacionit dhe të zhvillohen modele të përshtatshme risku për këtë sektor.[31]

4.1 Të dhënat dhe metodologjia.

4.1.1 Të dhënat

Në këtë studim jemi bazuar mbi të dhëna jo financiare të cilat plotësojnë raportet financiare që kufizohen nga vetë volumi i aktivitetit të një biznesi të mesëm ose të vogël. Fillimisht u shpërndanë pyetësorë dhe u morën në analizë të dhënat financiare nga 130 bilance, të përbëra nga 2860 raporte financiare dhe 650 të dhëna jo financiare, të mbledhura këto nga viti 2008 deri në 2011. Nga 130 bilancet e shqyrtuara, u kategorizuan si kompani me probleme në huamarrjen bankare 58 raste dhe të suksesshme 72 raste. Më pas, nga ky kampion të dhënash u eliminuan kompanitë me raportet financiare me vlera ekstreme, si dhe ato kompani që nuk i përkasin limiteve të vendosura nga klasifikimi i bërë sipas ligjit Nr. 10042, datë

[31] Basel Committee on banking and supervision, (2006), "International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards", nga *BIS*: Bank of International Settlements.

Basel Committee on banking and supervision (1999a), *Credit Risk Modeling: Current Practices and Applications*, Document No. 49, April.

22.12.2008, për biznesin e vogël e të mesëm, bazuar në qarkullimin vjetor, numrin e punonjësve dhe totalin e aktiveve. U arrit kështu në një kampion prej 119 bilancesh, të përbëra 1428 raporte financiare dhe 357 të dhëna jo financiare. Nga totali i prej 119 bilance, 57 raste klasifikohen si të suksesshme dhe 62 janë klasifikuar si raste me probleme.

Nga pikëpamja financiare, një përcaktim i përgjithshëm i dështimit për një SME, është trajtuar nga shumë autorë. Karels dhe Prakash (1987)[32] përdorën vlerën neto të kompanisë si një indeks për dështimin, ndërsa Lau (1987) përdori si tregues të dështimit, rënien në çmimin e aksionit, apo mospagesat e dividendëve, dështimin në pagesën e kredisë, aplikimin për falimentim, mungesën e likuiditetit. Në vazhdim Neaver (1996)[33] përdori mungesën e likuiditetit dhe dështimin në pagesat e detyrimeve. Në këtë studim, SME-të janë përcaktuar si firma të përfshira të paktën në një nga këto situata:

- vonesë në pagesë të kështit të kredisë bankare mbi 90 ditë;
- një histori jo e mirë krediti në Regjistrin e Kredive në Bankën e Shqipërisë;
- një raport i pavarësisë financiare më i vogël se 50%.

Me qëllim që të rritet besueshmëria e informacionit financiar, është konsultuar dhe opinioni i ekspertit kontabël për bilancet e shoqërive.

Janë marrë në konsideratë në konsideratë 12 raporte financiare, që i përkasin raporteve të rentabilitetit, aktivitetit, likuiditetit, strukturës.

[32] Karels, G.V. and A.J.Prakash. 1987. "Multivariate Normality and Forecasting of Corporate Bankruptcy." Journal of Business Finance and Accounting, Vol. 14 no. 4, 573-592.

[33] Narver, J.C. and Slater, S.F. (1996) The effect of a market orientation on business pro®tability. Journal ofMarketing 54, 20±35.

Tabela 7. Tabela e raporteve financiare

1	struktura	STR1=kapital aksioner/pasivet totale
2	struktura	STR2=detyrime totale/pasive totale
3	struktura	STR3=fitim operativ/detyrime totale
4	rentabiliteti	REN1=fitim operativ/aktive totale
5	rentabiliteti	REN2=fitime netot/aktive totale
6	rentabiliteti	REN4=fitim neto/shitje
7	rentabiliteti	REN5=kapital punues/aktive totale
8	likuiditeti	LIK1=aktive afatshkurtër/detyrim afatshkurtër
9	likuiditeti	LIK2=(aktive afatshkurtër-inventar)/detyrime afatshkurtër
10	aktiviteti	AKT1=shitje/aktive fikse
11	aktiviteti	AKT2=shitje/aktive totale
12	aktiviteti	AKT4=shitje/klient

Burimi: Autori

Në plotësim të informacionit nga raportet financiare, janë përzgjedhur edhe 3 të dhëna jo financiare:

Tabela 8. Tabela e të dhënave cilësore

1	VITET E JETËS SË BIZNESIT
2	SEKTORI
3	QYTETI I KRYERJES SË AKTIVITETIT

Në popullatën e SME-ve të marra në studim, ndër kompanitë e suksesshme 81% e tyre operojnë në zonat Tiranë Durës, ndërsa midis kompanive me probleme shumica e tyre operojnë jashtë kësaj zone, pikërisht 68% e tyre. Ndërmarrjet që janë marrë në studim kanë një shpërndarje siç paraqitet në grafikun 17.

Grafiku17: SME të suksesshme dhe me probleme sipas zonave gjeografike



Burimi: Autori

Në tabelën 9 janë pasqyruar të dhënat statistikore deskriptive në lidhje me kompanitë e përfshira në studim.

Tabela 9. Tabela e të dhënave statistikore deskriptive

		KOMPANI TË SUKSES SHME	
		MESATARJA	DEVIJIMI
1	STR1=KAPITAL AKSIONER/PASIVET TOTALE	0.66	0.19
2	STR2=DETYRIME TOTALE/PASIVE TOTALE	0.33	0.17
3	STR3=FITIM OPERATIV/DETYRIME TOTALE	5.27	21.73
4	REN1=FITIM OPERATIV/AKTIVE TOTALE	0.47	0.47
5	REN2=FITIME NETO/AKTIVE TOTALE	0.22	0.17
6	REN4=FITIM NETO/SHITJE	0.19	0.11
7	REN5=KAPITAL PUNUES/AKTIVE TOTALE	0.4	0.22
8	LIK1=AKTIVE AFATSHKURTER/DETYRIME AFATSHKURTER	7.47	14.03
9	LIK2=(AKTIVE AFATSHKURTER-INVENTAR)/DETYRIME AFATSHKURTER	3.61	7.04
10	AKT1=SHITJE/AKTIVE FIKSE	8.18	10.77
11	AKT2=SHITJE/AKTIVE TOTALE	1.21	0.73
12	AKT4=SHITJE/KLIENT	30.24	98.86

	KOMPANI ME PROBLEME	
	MESATARJA	DEVIJIMI

1	STR1=KAPITAL AKSIONER/PASIVET TOTALE	0.28	0.2
2	STR2=DETYRIME TOTALE/PASIVE TOTALE	0.72	0.2
3	STR3=FITIM OPERATIV/DETYRIME TOTALE	0.45	0.92
4	REN1=FITIM OPERATIV/AKTIVE TOTALE	0.2	0.11
5	REN2=FITIME NETOT/AKTIVE TOTALE	0.08	0.06
6	REN4=FITIM NETO/SHITJE	0.12	0.1
7	REN5=KAPITAL PUNUES/AKTIVE TOTALE	0.24	0.24
8	LIK1=AKTIVE AFATSHKURTER/DETYRIM AFATSHKURTER	2.44	2.07
9	LIK2=(AKTIVE AFATSHKURTER-INVENTAR)/DETYRIME AFATSHKURTER	1.56	1.88
10	AKT1=SHITJE/AKTIVE FIKSE	4.07	4.42
11	AKT2=SHITJE/AKTIVE TOTALE	0.73	0.4
12	AKT4=SHITJE/KLIENT	3.49	3.73

Burimi: Autori

4.2 Hipotezat

Është e nevojshme që të bëjmë një krahasim nëse ka difenreca midis dy grupimeve të SME-ve, për 12 raportet financiare të sipërpërmendura.

Hipoteza H1: Ka dallime të rëndësishme midis vlerave të raporteve financiare të një SME-je të suksesshme dhe asaj me probleme.

Hipoteza H2: Për një SME të krediturar nga bankat, modeli i parashikimit të performancës që përfshin raportet STR3, REN2, AKT4, është një model që ka kapacitet vlerësimi të rëndësishëm statistikisht.

Vërtetimi i hipotezës së dytë lidhet me vërtetimin e tre nënhipotezave:

> ***H2a****: Raporti i strukturës që mat aftësinë e një kompanie të shlyejë këstet mujore të kredisë së marrë, i cili matet nga raporti fitime operative mbi detyrimet totale, është një raport statistikisht i rëndësishëm për parashikimin e performancës.*
>
> ***H2b****: Raporti "Kthimi nga aktivet", i cili shprehet si raport i fitimit neto mbi aktivet totale, është një raport statistikisht i rëndësishëm për parashikimin e performancës.*

***H2c**: Raporti i qarkullimit të klientëve brenda një periudhe prej një viti kontabël, është një raport statistikisht i rëndësishëm për parashikimin e performancës.*

Hipoteza H3: Për një SME të kredituar nga bankat, një model parashikimi performance që përfshin raportet financiare STR3, RENT2, AKT4, dhe të dhënat jo financiare Z dhe V, ka kapacitet vlerësimi të rëndësishëm statistikisht.

Vërtetimi i kësaj hipoteze, lidhet me vërtetimin e këtyre nënhipotezave:

***H3a**: Performanca e një kompanie ndikohet pozitivisht nga rritja e viteve të jetës së ushtrimit të aktivitetit të biznesit.*

***H3b**: Performanca e një kompanie ka ndikime pozitive nga fakti nëse kompania operon në zonën më të zhvilluar ekonomikisht që i përket rajonit Tiranë-Durrës, në krahasim me zonat e shtrira jashtë këtij rajoni.*

Hipoteza H4: Për një SME të kredituar nga bankat, një model parashikimi që bazohet jo vetëm në raporte financiare, por edhe në të dhëna jo financiare, ka një kapacitet parashikimi më të madh se një model që bazohet vetëm në raporte financiare.

Në kapitujt e mëparshëm theksuam se ekziston mundësia të manipulohen të dhënat e bilanceve, dhe ky fenomen është më serioz në një fimë në kushtet e një krize financiare. Lussier (1985) dhe Keasey & Watson (1987) sygjeruan se përdorimi i variablave jo financiare mund të rrisë mundësinë që modeli të masë më mirë probabilitetin që një firmë të jetë e suksesshme ose jo. Pikërisht, ky testim do të kryhet me këtë bazë të dhënash në studim, pra, duke përdorur si të dhënat financiare dhe ato jo financiare, do të tentojmë të ndërtojmë një model vlerësimi.

4.2.3 Metodologjia

Fillimisht, bëhet testi Mann-Whitney-Wilcoxon për të gjitha kompanitë, për të parë dallimet midis performancës financiare të kompanive me probleme dhe atyre të suksesshme.

Më pas, bazuar në hipotezat, për variablat e pavarur zbatohet në programin statistikor testi Omnibus i cili ka shpërndarje Chi - Katror, për të parë nëse modeli që kemi ndërtuar mund të përdoret për analizë apo për të bërë vlerësime ose parashikime të treguesit të varur. Vlerat e p-së më të vogla se 0.05 tregojnë se hipoteza vërtetohet.

Kapacitetit të përgjithshëm vlerësues të modelit që kemi ndërtuar, vlerësohet duke krahasuar vlerën e -2 logaritmin e mundësive (log likelihood) e cila krahasohet me vlerën kritike të chi - katrorit.

Në vazhdim llogarisim dy vlera të R^2, atë të Cox & Snell dhe Nagelkerke. Në modelet logjistike më i përdorshëm për cilësinë e përgjithshme të modelit duhet të përdoret Nagelkerke R^2.

Në hapin pasardhës testojmë modelin edhe mbi cilësinë e tij duke u mbështetur në metodën Hosmer dhe Lemeshow e cila është një mënyrë testimi që ka një shpërndarje chi-katror dhe është e vlefshme vetëm për rastin e variablave vetëm me dy kategori. Në këtë rast presim që vlera e p-së të jetë më e madhe se 0.05 që modeli ynë të jetë i mirë.

Konkludojmë zbatimin e modelit me testin Wald, i cili ka një shpërndarje Z dhe vlerësohet si raport i koefiçientit të një variabli me devijimin standard përkatës, duke arritur kështu në formën finale të ekuacionit që do të na paraqesë modelin e matjes së performancës së kompanive që i përkasin sektorit të SME-ve të financuara me kredi bankare.

4.3 Rezultatet empirike

Rezultati i testit Mann - Whitney - Wilcoxon për Hipotezen H1 është paraqitur në tabelën 9. Siç shihet, 3 raporte nga 12 të aplikuarat në model, janë tregues jo të

rëndësishëm, ndërsa të tjerët janë sipas rastit * të rëndësishëm deri në vlerën 0.01, ** të rëndësishëm deri në me vlerën 0.05.

Pra, arrijmë në përfundimin se ka dallime të rëndësishme midis vlerave të raporteve financiare të një firme të suksesshme dhe asaj me probleme, duke i dhënë përgjigje kështu hipotezës së parë.

Tabela 10. Rezultati i testit MWW

Nr.	Përshkrimi	3 vjet para	2 vjet para	1 vit para
1	STR1=kapital aksioner/pasivet totale	**	**	**
2	STR 2=detyrime totale/pasive totale	**	**	**
3	STR 3=fitim netot/detyrime totale	*	**	**
4	REN1=fitim operativ/aktive totale	--	**	**
5	REN 2=fitime netot/aktive totale	**	**	**
6	REN 4=fitim neto/shitje	--	--	--
7	REN 5=kapital punues/aktive totale	**	**	**
8	REN 1=aktive afatshkurtra/detyrim afatshkurtra	*	**	**
9	REN2=(aktive afatshkurtra-inventar)/detyrime afatshkurtra	--	--	**
10	AKT1=shitje/aktive fikse	**	*	--
11	AKT 2=shitje/aktive totale	--	--	-
	AKT 4=shitje/klient	**	**	*

12				

Nga tabela 10, – janë shënuar treguesit jo të rëndësishëm, * të rëndësishëm deri në vlerën 0.01, ** të rëndësishëm deri në me vlerën 0.05.

4.3.1 Modeli 1

Zgjedhja e raporteve financiare që do të testohen për cilësinë e tyre për të parashikuar performancën është bërë duke marrë parasysh rekomandimet e literaturës, si dhe kufizimet e të dhënave në dispozicion. Në modelin tonë, të dhënat janë analizuar me programin Statistical Program for Social Studies (SPSS). Në model kemi marrë variablin (S) sukses si variabël të varur i cili merr vlerat 1 nëse ndërmarrja ka pasur sukses dhe 0 në të kundërt. Si variabla të pavarur janë konsideruar:

- AKT4, Raporti financiar Shitje / Klientë
- STR3, Raporti financiar Fitimi operativ / Detyrime totale
- REN2, Raporti financiar Fitim neto / Aktive totale

Ajo që ka rëndësi është të dimë nëse modeli që kemi ndërtuar mund të përdoret për analizë apo për të bërë vlerësime ose parashikime të treguesit të varur. Për këtë qëllim mund të përdorim Omnibus test i cili ka shpërndarje Chi-katror dhe është i mbështetur mbi ndërtimin e hipotezave.

H_0 - të paktën ka disa kapacitete vlerësimi

H_a - nuk ka disa kapacitete vlerësimi

Tabela 11: Tabela Omnibus Test për koeficentët e Modelit 1

		Chi-katror	Sh.L.	Rëndësia
Hapi 1	Hapi	63.108	3	.000
	Bllok	63.108	3	.000
	Modeli	63.108	3	.000

Nga tabela 11 shohim se vlerat e p-së janë shumë të vogla, pra që hipoteza zero qëndron, pra që modeli i ndërtuar ka kapacitet vlerësimi të rëndësishëm statistikisht.

Në tabelën 12 kemi një përmbledhje të rezultatit të modelit tonë. Kjo tabelë jep një pamje të kapacitetit të përgjithshëm vlerësues të modelit që kemi ndërtuar. Në kolonën e parë kemi vlerën e -2 logaritmin e mundësive (log likelihood) e cila përdoret për testet e tjera. Përcaktimi i logaritmit të mundësive shprehet për të dy kategoritë e variabëlit të varur dhe ka formën si më poshtë:

Ekuacioni 5. Logaritmi i mundësive për dy kategoritë e variablit të varur

$$\log - m = \sum_{i=1}^{N} [Y_i \ln(\widehat{Y}_i) + (1 - Y_i) \ln(1 - \widehat{Y}_i)]$$

Ky vlerësim ka një shpërndarje chi-katror e cila shprehet si në ekuacionin 6.

Ekuacioni 6. Ekuacioni i shpërndarjes Chi-Katror

$$\chi^2 = 2[(\text{log-m për modelin e madh}) - (\text{log-për modelin e vogël})]$$

Kjo vlerë mund të krahasohet me një vlerë kritike të chi-katrorit.

Po ashtu kemi edhe dy vlera të R^2, atë të Cox & Snell dhe Nagelkerke. Këto vlera nuk janë të ngjashme me vlerën e R^2 që jemi mësuar të përdorim në modelet e tjera regresive dhe për më tepër nuk kanë të njëjtin kuptim. Gjithsesi këto vlera mund të kenë një përdorim të përafërt si në rastin e përgjithshëm të përdorimit të R^2. Ndryshe nga rasti i OLS-ve ku interesohemi për të pasur minimumin e shumës së katrorit të gabimeve në modelet logjistike interesohemi për të maksimizuar mundësitë e ndodhjes së kategorisë.

Në rastin e Cox & Snell R^2 është i mbështetur përsëri mbi logaritmin e mundësive. Në këtë rast kemi që raporti i mundësive reflekton përmirësimet e të gjithë modelit kundrejt modelit të pjesshëm. Sa më i vogël të jetë ky raport aq më i madh është ky përmirësim. R^2 në këtë rast mund të shprehet si në ekuacionin 7.

Ekuacioni 7. Raporti R^2 në rastin Cox & Snell

$$R_{CS}^2 = \left(\frac{LogM_{pjesshëm})}{LogM_{Plot})} \right)^{2/N}$$

Ku:

L(M) është probabiliteti me kusht i variablit të varur i nxjerr nga variablat e pavarur.

Problemi i këtij treguesi është se nuk arrin vlerën 1 si do të preferonim për të interpretuar kuptimin e këtij treguesi, prandaj një formë e modifikuar e tij është R^2 i Nagelkerke i cili mund të shprehet si në ekuacionin 8.

Ekuacioni 8. Forma e modifikuar R^2 i Nagelkerke

$$R_N^2 = \frac{1 - \left(\frac{LogM_{pjesshëm}}{LogM_{Plot}} \right)^{2/N}}{1 - (LogM_{pjesshëm})^{2/N}}$$

Ky koefiçient është një formë e modifikuar e R^2 Cox & Snell i cili mund të marrë vlerat nga 0 në 1 duke na mundësuar një përafrim më të saktë të këtij treguesi me R^2 që përdorim në përgjithësi. Pra në modelet logjistike për të treguar mbi cilësinë e përgjithshme të modelit duhet të përdoret Nagelkerke R^2. Në modelin tonë Nagelkerke R^2 i cili shërben për të parë shpjegueshmërinë e modelit ka një vlerë prej 55.3 %. Pra kapaciteti shpjegues i modelit tonë është në këto nivele.

Tabela 12: Përmbledhja e Modelit 1

Hapi	-2 Logaritmi i mundësive	Cox & Snell R Katror	Nagelkerke R Katror
1	100.339(a)	.414	.553

Modelin që kemi ndërtuar është e nevojshme që ta testojmë edhe mbi cilësinë e tij. Shumica e testeve për të parë sesa mirë performon një model janë të mbështetur mbi analizën e mbetjeve. Por një metodë e tillë nuk është efiçiente për rastin e modeleve logjistike.

Për këtë qëllim Hosmer dhe Lemeshow në 1989 propozuan një mënyrë të re testimi e cila ka një shpërndarje chi-katror dhe është e vlefshme vetëm për rastin e variablave vetëm me dy kategori. Testi Hosmer-Lemeshow përdoret për të parë cilësinë e përgjithshme të modelit. Ai është një test i modifikuar i testit chi-katror. Në këtë rast presim që vlera e p-së të jetë më e madhe se 0.05 që modeli ynë të jetë i mirë.

Tabela 13: Testi Hosmer dhe Lemoshow

Hapi	Chi-Katror	Shkallë lirie	Rëndësia
1	8.467	8	.389

Në rastin e modelit tonë shohim se vlera e p-së ka një vlerë prej 0.389, e cila është me madhe se 0.05, duke na lënë të kuptojmë se modeli ynë është i mirë. Për të vlerësuar këtë test vlerat e vrojtuara grupohen në 10 grupe kryesore në rendin rritës, siç paraqiten në tabelën 14.

Tabela 14. Tabela e detajuar testit Hosmer and Lemeshow

	S = 0		S = 1		Totali
	Vlerat e vëzhguara	Vlerat e pritura	Vlerat e vëzhguara	Vlerat e pritura	Vlerat e vëzhguara
Hapi 1	12	10.782	0	1.218	12

2	11	10.371	1	1.629	12
3	10	9.981	2	2.019	12
4	9	9.200	3	2.800	12
5	6	7.424	6	4.576	12
6	5	6.552	7	5.448	12
7	4	4.940	8	7.060	12
8	4	1.505	8	10.495	12
9	0	.244	12	11.756	12
10	0	.001	10	9.999	10

Koefiçienti llogaritet duke u mbështetur mbi vlerat e vrojtuara dhe ato të pritura të 10 grupeve përkatëse, siç paraqitet në ekuacionin 9.

Ekuacioni 9. Koefiçienti i llogaritur nga vlerat e pritura

$$G_{HL}^2 = \sum_{j=1}^{10} \frac{V_j - P_j^{\ 2}}{P_j(1 - P_j / n_j)} \square \chi^2$$

Ku:

n_j – numri i vrojtimeve në grupin j

$V_j = \sum y_{ij}$ = numrin e rasteve të vrojtuara në grupin j

$P_j = \sum p_{ij}$ = numrin e rasteve të pritshme në grupin j

Ky koefiçient është i krahasueshëm me një shpërndarje chi-katror e cila në këtë rast ka 8 shkallë lirie. Rezultatet përmbledhëse të këtij testi janë paraqitur në tabelën 13.

Pasi folëm për modelet logjistike, si dhe për testet që përdoren për këto modele, pamë modeli që kemi ndërtuar është i rëndësishëm statistikisht e mund të përdoret për të bërë vlerësime apo parashikime të variablit të varur. Nga tabela 15 shohim që vlerat e p-së janë ë gjitha më të vogla se 0.05 duke na lënë të kuptojmë që variablat e përfshirë në model janë të rëndësishëm statistikisht. Këtë gjë mund ta konkludojmë edhe nga vlerat e testi Wald i cili ka një shpërndarje z dhe vlerësohet si raport i koefiçientit të një variabli me devijimin standard përkatës.

$$W_j = \frac{\beta_j}{SE_{\beta_j}}$$

Vlerat e testit Wald tregojnë se koefiçentët janë të rëndësishëm statistikisht me një nivel besueshmërie 95 %.

Tabela 15: Rezultatet e Modelit 1

		B	S.E.	Wald	Sh.L.	Rëndësia	Eksponenti (B)
Step 1(a)	AKT4	.209	.066	10.171	1	.001	1.233
	STR3	.406	.278	2.125	1	.045	1.500

REN2	9.777	3.295	8.805	1	.003	17620.419
Constant	-2.817	.553	25.976	1	.000	.060

I kemi dhënë kështu përgjigje hipotezës H2 dhe nënhipotezave H2a, H2b, e H2c, se raportet AKT4, STR3, REN2 janë të rëndësishëm statistikisht për matjen e performancës. Ndërkohë analiza vazhdon me modelin 2 që përfshin, përveç të dhënave financiare të mësipërme, edhe të dhëna cilësore.

4.3.2 Modeli 2

Modeli i mësipërm, do të trajtohet duke përfshirë edhe variablat Dummy ose të dhënat jo financiare. Faktorët cilësorë shpesh herë vijnë në formën e informacionit binar. Në shembullin tonë, gjithë informacioni i rëndësishëm në lidhje me zonën ku operon kompania dhe moshën e aktivitetit, mund të përmblidhet në një variabël binar ose ndryshe në një variabël që merr vetëm dy vlera, në rastin tonë, vlerat një ose zero. Në ekonometri këto variabla quhen ndryshe dhe "variabla dummy". Në modelin tonë, të dhënat janë analizuar me programin Statistical Program for Social Studies (SPSS). Në model kemi marrë variablin (S) sukses si variabël të varur i cili merr vlerat 1 nëse ndërmarrja ka pasur sukses dhe 0 në të kundërt. Si variabla të pavarur janë konsideruar:

Pra, të dhënat e përfshira në model janë:

Z- zona ku operon firma, merr vlerën 1 nëse është Tiranë e Durrës; merr vlerën 0 në të kundërt;

V- vjetërsia 0 nëse është më pak se tre vjet dhe 1 nëse është mbi tre vjet;

AKT4, Raporti financiar Shitje / Klientë;

STR3, Raporti financiar Fitimi operativ / Detyrime totale;

REN2, Raporti financiar Fitim neto / Aktive totale;

Duke ndjekur hapat e analizës për modelin 1, përdorim Omnibus test, i cili ka shpërndarje Chi-katror dhe është i mbështetur mbi ndërtimin e hipotezave, për të mësuar nëse modeli që po ndërtojme mund të përdoret për analizë apo për të kryer vlerësime ose parashikime të treguesit të varur.

H_0 - të paktën ka disa kapacitete vlerësimi

H_a - nuk ka kapacitete vlerësimi

Tabela 16: Tabela Omnibus Test për koeficentët e Modelit 2

		Chi-Katror	Shkallë Lirie	Rëndësia
Hapi 1	Hapi	81.169	5	.000
	Bllok	81.169	5	.000
